

Lëvizja BESA

Gashi dhe Kasami në garë për lider

Fq.3



REAGIME PËR LIGJIN

Arbitrariteti i maqedonishtes, i papranueshëm

Fq.6



Të vizatosh lavdinë e të parëve tanë

Bashkim Mexhiti

Fq.12-13



Koha

www.koha.mk



Nëse nuk ndalohet Rusia...

Fq.15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3292 · e mërkurë 14 shkurt, 2018

1°C | 8°C

15 DEN

EDITORIAL

Çka janë këto kritere skandalozë të Ministrisë së Kulturës?!



Nuk besojmë që Ministria e Kulturës të ketë punësuar ndonjë druvarë kokëshkretë në radhët e saja, ose ndonjë dashakeq të vlerave shpirtërore e krijuese të shqiptarëve, mirëpo nga mënyra se si është vendosur për ndarjen e mjeteve buxhetore, rezultojnë pikërisht logjika e drurit, e jo kriteri profesional, të ketë qenë fryma që ka përshkuar metodologjinë e kësaj ndarjeje. Kjo hajgare kaq

Fq.2

RAJON

Nga Shqipëria janë larguar rreth 330 mijë persona

Fq.14

KULTURË

Mungesa e shqiptarëve në krijimtarinë serbe

Fq.17



PARADOKSET E PROGRAMIT 2018

300 MIJË PËR CD, 80 MIJË PËR FESTIVAL!

Gafat gjatë përzgjedhjes së projekteve fituese edhe në sektorin e muzikës ndjekin njëra-tjetrën. Para që derdhen pa kursyer për koncerte, promovime, emra dhe shoqata që konkurrojnë për herë të parë dhe nga ana tjetër - manifestimet tradicionale, emra të njohur të skenës janë përkrahur në nivelet më ekstreme minimale. Kjo është edhe një prej arsyeve që këto rezultate nuk mbajnë as miratimin e anëtarit shqiptar, Rami Mustafa, i cili shton se me këto projektet fituese - nevojitet decentralizimi i kulturës shqiptare nga Tetova drejt qyteteve të tjera

Fq.8

Robëri bastoresh

Shkup, 13 shkurt - Qytetarët e Maqedonisë brenda një ditë nëpër bastoret paguajnë mbi 500.000 euro që nënkupton se mesatarisht çdo qytetar shpenzon 17 denarë në ditë në bastore. Kështu tregojnë të dhënat e fundit të Drejtorisë për të Hyra Publike ku thuhet se vitin e kaluar në bastore janë paguar rreth 200 milion euro gjegjësisht nëse këtë shifër e përpjesëtojmë me zmilion banorë sa ka Maqedonia i

bie se çdo vit një banorë shpenzon 100 euro në bastore. Këto të dhëna për fenomenin e përhapjes së lojërave të fatit gjegjësisht bastoreve që tani më i gjen në çdo cep të qyteteve në gjithë territorin e Maqedonisë, sipas sociologëve është pasojë e varfërisë dhe papunësisë së madhe që ka bërë të të gjithë qytetarët sidomos të rinjtë të gjitha rrugët t'i dërgojnë në bastore, duke shpresuar...

Fq.7



EDITORIAL

ÇKA JANË KËTO KRITERE SKANDALOZE TË MINISTRISË SË KULTURËS?!



Emin AZEMI

Nuk besojmë që Ministria e Kulturës të ketë punësuar ndonjë druvarë kokëshkretë në radhët e saja, ose ndonjë dashakeq të vlerave shpirtërore e krijuese të shqiptarëve, mirëpo nga mënyra se si është vendosur për ndarjen e mjeteve buxhetore, rezultojnë pikërisht logjika e drurit, e jo kriteri profesional, të ketë qenë fryma që ka përshkuar metodologjinë e kësaj ndarjeje. Kjo hajgare kaq transparente me paratë publike, të cilat nuk e gjejnë adresën adekuate të alokimit, flet për një inercion të kamotshëm të institucioneve shtetërore, nëpër të cilat dominon logjika partizane e vendimmarjes, ku aparatçikët dërgohen për t'u rehatuar e jo për të qenë kreativ në punët e tyre zyrtare.

Ajo çka bie në sy në këtë ndarje buxhetore është mungesa totale e kriterëve mbi të cilat bazohet çdo institucion para se të vendos për dedikimet e posaçme. Pra, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë, sipas gjendjes që ka pasqyruar në faqen e saj elektronike, ka dashur të na thotë se në Tetovë jetojnë nja 95 për qind shqiptarë të Maqedonisë (!) dhe nja 5 për qind shqiptarë nëpër qytet e katundet tjera. Pastaj, sipas kësaj gjendje, del që më llogari ke të jesh debutant adoleshent, se sa festival me traditë, më llogari ke të jesh shtypshkronjë se sa shtëpi botuese dhe, në instancë të fundit, më llogari ke të jesh muzikant, aktor, shkrimtar maqedonas se sa shqiptar.

Sipas cilës logjikë idiotike financon koncerte, promovime, emra dhe shoqata që konkurrojnë për herë të parë në dem të manifestimeve tradicionale dhe emrave të njohur të krijimtarisë dhe skenës shqiptare? Një festival tradicional që promovon krijimtarinë muzikore të fëmijëve siç është "Ylberi" financon me 80 mijë denarë qesharakë, dhe një duo artistësh - me 20 mijë denarë qesharakë (!), ndërkohë që CD-ja e një debutanti adoleshent financon me plot 300 mijë denarë.

Nuk besojmë që në shoqërinë shqiptare mungojnë emra krijuesish e veprimtarësh, të cilët po të angazhoheshin në ndarjen e mjeteve buxhetore, do të tregonin sens më të lartë përgjegjësie. Por, ajo çka është për t'u vajtuar është fakti se drejtuesit e Ministrisë së Kulturës, duke filluar nga ministri që ka qëlluar të jetë maqedonas, mendojnë se ky është niveli intelektual i shoqërisë shqiptare dhe ata me të drejtë gishtin e akuzës e drejtojnë kah vet shqiptarët. Ne kot bëhemi nervoz me ministra maqedonas kur nëpër ministri kemi funksionarë të lartë shqiptar, të cilët mungesën e kriterëve në punë e zëvendësojnë me njëfarë lojaliteti partiak, duke dashur të na bindin se nuk kanë qenë ata, por dikush tjetër mbi ta ka vendosur këto kritere katastrofale në ndarjet buxhetore.

Kultura shqiptare në Maqedoni, edhe si gjeografi, edhe si traditë, edhe si vlera, edhe si emra të përveçëm, nuk është as për së afërmi kjo që shihet në grafikonët buxhetorë të Ministrisë së Kulturës. Edhe sikur të donim ta amnistionim këtë neglizhencë totale që vie si pasojë e mungesës së përvojës dhe dijes profesionale, sërish mendja na shkon të një sherr i qëllimshëm që këtu instalohet, jo për të vendosur rend, por për të prishur edhe atë pak rend që ka ekzistuar në këtë Ministri. Se prishja e rendit ka filluar së brendshmi flet edhe reagimi i një anëtari shqiptar të Komisionit për financim në këtë ministri, i cili kishte refuzuar të jap pëlqim për shumë projekte, fakt ky që ilustron inkoherencën në mes të kriterëve dhe vlerave.

SFIDAT E BRENDSHME REFLEKTUAN PROFILIN E JASHTËM

"20 vite pas vetë-flijimit të Jasharajve dhe 10 vite pas vetë-vendosjes së dekluaruar, Kosova po fillon numërimin dyshifor të shtetë-ndërtimit. Sfidat e brendshme, reflektuan profilin e jashtëm: me njohje të rralluara dhe ca- të rikonisderuara. Arti dhe sporti, valonin flamurin shtetëror në botë, derisa shteti i lindur në luftë, merrej me pasojat e saj. Dëbimi i pushtuesit të huaj, nuk e çliroi shtetin edhe nga kapja e brendshme. Fundi i dekadës post-konfliktuale, nuk solli edhe fillimin e fazës post- korruptive. Një lindje e rëndë shtetërore, nuk krijoi shtetë-formim të lehtë. Megjithatë, arsyeja- dorëzohet para ndjenjave; sa herë që afrohet 17 shkurti. Urime Kosovë: të dua edhe kur më zhgënjën!", shkruan prof. Blerim Reka në profilin e tij në FB



PËRGËZIME PËR NJË MINISTËR

"Nga zemra e përgëzoj Ministrin e Shëndetësisë Uran Ismajli për punën dhe qëndrimet e tij të gjerëtanishme. Jo pse është gjilanas (!), por sepse, siç po shihet, me punën e tij po na bënë të shpresojmë se ky shtet do ta fitoj betejën përballë kategorisë së mjekëve dhe stafit medicinal që po e konsiderojnë trupin dhe shëndetin tonë djerrinë nga ku mund të përfitojnë si të donë, paligjshëm, pandershëm e si të ishim të hedhur gjithandej e të askujt. Ministër!

Qëndro i palëkundur dhe vazhdo në misionin tënd të shenjt. Mos na zhgënjë! Dije se po vazhdove kështu, Zotin do ta kesh pranë e mbështetja dhe lutjet tona për Ju nuk do të mungojnë....!", shkruan në ptofilin e tij, Mustafa Bajrami.



PËRGJEGJËSIA DHE TIFOZERIA

"Mund të jesh edhe njeri i mirë pavarisist perceptimeve që ke mbi zhvillimet shoqërore dhe politike por kjo asesi nuk të jep të drejtën të më mveshësh mua epitetin e të qenit i keq vetëm pse unë mendoj dhe vepro ndryshe nga ti. Kjo vjen si rrjedhojë e faktit që unë kam përgjegjësi të tjera shoqërore dhe profesionale deri sa ty të jepet e drejta të jeshë vetëm një tifoz i kënaqur apo i pa kënaqur nga ajo që sheh dhe këtu nuk ka asgjë të keqe. Kjo është ekuivalente me situatën e të shikuarit një ndeshje futbolli në të cilën deri sa shikuesit e rëndomtë që gjithmonë janë shumicë arrinë të shohin vetëm ngjarjen aty ku në moment është topi, profesionistët shohin pozitën e çdo lojtari të ekipit të tyre dhe të kundërshtarit si SHKAK për të parë në fund pozitën e topit si PASOJË. Në këtë rast as unë dhe ti nuk kemi të drejtë të gjykojmë për të keq profesionistin pse e sheh ashtu lojën dhe as ai ka të drejtë të na gjykojë ne pse nuk arrimë ta shohim si ai, thjeshtë secili e percepton nga mënyra me të cilën obligohet nga përvoja dhe profesioni. Besoj që mjafton secili të kuptojë tjetrin nëse duam që të kenë efekt pozitiv edhe kundërshtimet edhe lëvdatat që bëjmë në drejtim të zhvillimeve shoqërore dhe politike por edhe në drejtim të njëri-tjetrit, në të kundërtën mund të bëjmë vetëm zhurmuesin e keq i cili pas një kohe nuk arrin të kuptojë më as vehten", ka shkruar në profilin e tij në FB, Remzi Memedi



MEDIA Citate

Në dokumentin e cilësuar si strategjia e BE-së për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk ka fjalë të shkuara dem e me idealizma. Tashmë BE ka vendosur qëllimin për zgjerim, ashtu siç bëri në vitin 2004 me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore.

Por ka një rrugë të gjatë përpara, pasi ndikimi i BE-së atje është pakësuar dhe këtë e tregoi një sondazh ku vetëm 26% e serbëve mendojnë se anëtarësimi në BE do ishte një gjë e mirë. Nëse BE-ja kthehet prapa, vendet si Rusia dhe Turqia janë gati të mbushin boshllëkun. Ndikimi i tyre është sda më e madhe për cilindo nga gjashtë vendet që të kualifikohen në anëtarësim. BE bën mirë që thekson se përparimi drejt anëtarësimit do vlerësohet objektivisht dhe se në teori, çdo shtet mund të arrijë përparësitë e tanishme. BE gjithashtu këmbëngul se asnjë vend nuk do anëtarësohet nëse nuk zgjidhen mosmarrëveshjet me fqinjët, si në rastin e Serbisë që refuzon të njohë Kosovën si shtet i pavarur apo Maqedoninë për çështjen e emrit me Greqinë.

(Financial Times, 13 shkurt)

Eksperti për Ballkanin, Daniel Serwer, ka thënë se teknikisht është i mundur formimi i Forcave të Armatosura, madje edhe pa amendamente kushtetuese, por për këtë do të ishte mirë të keni edhe përkrahjen e serbëve. Ai gjithashtu ka komentuar rreth integritetit të veriut të Kosovës dhe ambicijet serbe që ajo pjesë t'i takojë Serbisë. Serwer ka thënë se veriu i Kosovës nuk është i integruar mirë. "Mendoj se do të ishte mirë edhe për shqiptarët edhe për serbët nëse veriu do të integrohej në kuadër të Planit të Ahtisaarit, i cil parasheh formimin e Asociacionit të Komunave Serbe", tha analisti amerikan Daniel Serwer, në një intervistë ekskluzive për RTK-në. Më tej ai tha se nuk beson se Qeveria e Serbisë ka shpresë se veriu i Kosovës mund t'i bashkohet formalisht Serbisë. "U është thënë nga amerikanët dhe evropianët që kjo s'do të ndodhë. Megjithatë ka njerëz në veri të Kosovës që nuk e duan integrimin me pjesën tjetër të Kosovës. Nëse rusët do të paraqisnin problem atje, s'do të isha i befusuar, por nuk e di nëse kjo do të ndodhë", tha ai.

(RTK, 13 shkurt)

NËSE NUK E KENI DITUR...

ÇFARË ISHTE SHUFADAJA?

E përmendur si një nga zotërimet e familjes së Kastriotëve, Shufadaja ka qenë një port i vogël në grykëderdhje të lumit të Matit. Duhet të ketë qenë një pikë shumë nevalgjike sepse funksiononte edhe si pikë doganore duke siguruar mjaft të ardhura. Nga kjo pikë, zotërimet e Gjon Kastriotit, babait të Skënderbeut, zgjatoheshin drejt lindjes duke arritur deri në Prizren. Në këtë mënyrë, sigurohej



përgjatë gjurmës së Matit komunikimi dhe tregtia nga bregdeti me viset e thella dhe prapatokën e veriut shqiptar. Rëndësia e Shufadasë ra me kalimin e kohës.

BESA NË PRAG TË DY KONGRESEVE ZGJEDHORE

GASHI DHE KASAMI NË GARË PËR LIDER

Kur jemi tek kandidaturat, përderisa ajo e Bilall Kasamit dihej që kur u mbajtën dy mbledhjet e paralele të Kuvendit Qendror, kandidatura e sekretarit të përgjithshëm të BESËS, Afrim Gashi vjen pas zhvillimeve fundit në parti kur Gjykata Themelore në Shkup refuzoi të vlerësojë vendimin e mëhershëm për shkarkimin e Kasamit dhe zgjedhjen e Nexhmedin Kahremanit për ushtrues detyre të kryetarit të LB-së deri në Kongres

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 13 shkurt - Bilall Kasami dhe Afrim Gashi pritet të jenë dy kandidataturat për të marr timonin e Lëvizje(ve) BESA, me gjasa të dy të zgjidhen kryetar partie por në dy Kongrese partiake, njëri më 18 shkurt e tjetri më 24 shkurt. Se cilit do ti bie ti nënshtrohet përsëri një procesi zgjedhor partiak me gjasë në një parti tjetër me emër të ndryshëm nga "Lëvizja BESA", këtë do ta thonë organet kompetente gjyqësore pas të mbarojë proceset zgjedhore në të dyja grupet e kësaj partie. Këto ditë lufta mes të dyja grupeve po bëhet për të përfutuar sa më shumë anëtar të Këshillit themelues kjo për të pasur argumente më të forta legjitimiteti rreth organeve të rregullta partiake që do të dalin nga Kongreset zgjedhore. Kjo pasi për tre vite që kur u themelua ky subjekt politik, të gjitha organet partiake në nivel degësh dhe ato në nivel qendror përfshirë dhe koordinatorin (kryetarin) e partisë deri në Kongresin e parë zgjedhor, ishin të përkohshme por që ushtronin veprimtarinë në bazë të statutit të partisë që u miratuar nga Kuvendi Themelues e i cili nuk parasheh funksionimin e organeve të përkohshme. Nga prononcimet e zyrtarëve të të dyja grupeve në këtë fazë nuk mund të flitet për prurje të reja në parti, pro kjo do të ndodhë më vonë përmes kooptimit të cilin e lejon statuti i Lëvizjes BESA ndërsa më shumë do të theksohet në departamente që do të formohen nga Kryesia e re partiake.

PRITET KANDIDATURA E GASHIT

Kur jemi tek kandidaturat, përderisa ajo e Bilall Kasamit dihej që kur u mbajtën dy mbledhjet e para-

le të Kuvendit Qendror, kandidatura e sekretarit të përgjithshëm të LB-së Afrim Gashi vjen pas zhvillimeve fundit në parti kur Gjykata Themelore në Shkup, refuzoi të vlerësojë vendimin e mëhershëm për shkarkimin e Bilall Kasamit dhe zgjedhjen e Nexhmedin Kahremanit për ushtrues detyre të kryetarit të LB-së deri në Kongres. "Zyrtarisht Afrim Gashi ende nuk ka dorëzuar kandidaturën për kryetar deri tek Komisioni zgjedhor, por në strukturat partiake flitet tashmë një kohë se ai do të jetë kandidati i vetëm për kryetar i Lëvizjes BESA. Deri më tani zgjedhja nëpër dege ka mbaruar mbi 90 % ka mbetur vetëm dega e Kumanovës. Presim të mbarojë përzgjedhja e delegatëve për Kongres dhe më pas deputeti Afrim Gashi të shpallë kandidaturën", thonë zyrtarë të Lëvizjes BESA që deshëm të mbeten anonim për momentin. Në Pyetjen nëse kryetari i komunës së Zhelina Blerim Sejdiu do të jetë pjesëmarrës në kongres këta zyrtarë thonë se për momentin ai do të mbetet neutral ndërsa janë të sigurt për pjesëmarrjen e Amir Elezit ish kandidatit të kësaj partie për komunë e Tearcës. Gjithashtu në Kongresin që po organizon Grupi i Nexhmedin Kahremanit në anën e tyre do të jetë edhe Arben Llabunishi gjë që konfirmohet edhe nga grupi Bilall Kasamit. "komplet dega e Strugës është me neve, përveç Arben Llabunishtit, ajo dhe do të delegojë së shpejti njerëzit e tyre në Kongresin vetëm legal dhe legjitim të lëvizjes BESA që do të mbahet sipas datës së paraparë të vendosur nga Kuvendi më 24 shkurt. Përveç Strugës zgjedhjet në nivel degësh do të mbarojnë këto ditë edhe në Gostivar dhe në Tetovë dhe deri më

20 shkurt do të përfundojë tërë procesi zgjedhor", thonë për gazetën KOHA zyrtarë të lartë partiak nga grupi i Bilall Kasamit. Të njëjtit thonë se kryetari i Zhelina sipas informatave të fundit që kanë do të jetë pjesëmarrës në Kongres. "Sipas statutit funksionarë të lartë shtetëror, ministra, deputetë dhe kryetar komunash automatikisht do të jenë pjesë Kongresit dhe pjesë e Kuvendit Qendror. Është e vërtetë se Blerim Sejdiu ka qenë neutral deri më tani, por sipas informatave të fundit që i kemi edhe do të jetë marrë pjesë në Kongres.

ZENDELI NË KRAHUN E KASAMIT

Sa i përket pozicionit të Fadil Zendeli dhe të gjitha ish strukturat e RDK-së që ishin në krah të Zendelit do të vazhdojnë të jenë pjesë e organeve partiake nga më të ulëtat deri tek pozitave më të larta në parti, thonë zyrtarë të lartë të Lëvizjes BESA, grupi i Bilall Kasamit.

"Prurje të reja nuk do të kemi për momentin por se kjo do të ndodhë më pas qoftë përmes kooptimit qoftë përmes departamenteve të Lëvizjes BESA që do të formohen më pas nga kryesia e partisë. Po ajo që do të shihet në Kongres është se kush do të zgjidhet kryetar dhe kryesia jo me diktat siç kanë bërë më herët grupi që u vetëlargua, por të gjithë funksionarët e lartë partiak do ti nënshtrohen votës së lirë të delegatëve. Pa diktat personal por me konsensus kolektiv Lëvizja BESA do të vendosë edhe për hapat e ardhshëm politik ndaj proceseve euronitegruese në vend, si dhe ndaj pjesëmarrjes eventuale në qeveri, nëse do të kemi ftesë natyrisht nga kryeministri Zaev", thonë zyrtarë nga grupi i Kasamit. Vetë taktika e grupit tjetër, thonë më tej këta zyr-

tarë, që të ndryshojnë datën e Kongresit flet për diktat dhe frikë nga Lëvizja BESA legjitime që e përfaqësojnë ne. Ndryshe grupi i Bilall Kasamit flitet se ka një afri më të madhe me partitë në pushtet BDI dhe LSDM, kjo u pa dhe kur pas situatës dramatike të mbajtjes së dy mbledhjeve të anëtarëve të Kuvendit Qendror, kryetari Kasami dhe deputeti Fadil Zendeli u pritën në takim në qeveri nga kryeministri Zaev.

Ndërkaq grupi i Nexhmedin Kahremanit flitet që kanë afri me PDSH-në e Menduh Thaçit. Këto ditë kishte zëra se PDSH me dy deputetë e saj mund të bashkohet në një grup parlamentar me tre deputet të tjerë Afrim Gashi, Nexhmedin Kahremani dhe Rexhep Mededi dhe të negociojnë së bashku hyrjen në Qeveri. Nga ana tjetër indikacionet për hyrje në Qeveri flasin në favor të grupit të Bilall Kasamit. Dy deputetë Fadil Zendeli dhe Teuta Bilalli qëndrojnë bashkë me BDI dhe LSDM duke i bërë kuorumin atyre në komisionet parlamentare ndërsa edhe për afrim mes këtyre subjekteve edhe më shumë len të kuptohet rasti i Komunës së Çairit kur anëtarja e grupit të Kasamit u zgjodh kryesuese e Këshillit Komunal në koalicion me BDI-në. Deri në fund të marsit do të dihet se për cilin grup do të vendosë gjykata t'i jep vazhdimësinë e Lëvizjes BESA, ndërsa deri atëherë flitet dhe për rikonstrumim të mundshëm të Qeverisë. Por në aspekt të përkrahjes së reformave të gjitha partitë përfshirë edhe VMRO-në e Hristijan Mickovskit do ti japin përkrahje Qeverisë së kryeministrit Zoran Zev së paku deri në zgjedhjen e çështjes së me Greqinë

Strategjia për Ballkanin, në kohë të duhur dhe e drejtë

Sofje, 13 shkurt - Strategjia për zgjerimin e BE-së drejt Ballkanit Perëndimor është në kohë të duhur, deklaroi zëvendëskryeministrja dhe ministre e Punëve të Jashtme e Bullgarisë, Ekaterina Zaharieva, e cila ishte pjesëmarrëse në diskutimin "E ardhmja e Ballkanit Perëndimor dhe strategjia e re për zgjerimin e BE-së". "Në strategji shohim shumë anë pozitive", tha Zaharieva. Ajo vlerësoi se Strategjia është në kohën e duhur, gjithëpërfshirëse dhe frymëzuese. Sipas saj, Strategjia është dokument shumë i drejtë, sepse i thekson qartë sfidat para secilit vend. "Ai është dokument afatgjatë, jep datë mjaftë ambicioze - vitin 2025", deklaroi ajo dhe shtoi se gjithashtu strategjia tregon qartë se nuk do të ketë kompromise me kriteret. "Dokument i është stimulues, frymëzues, por gjithashtu edhe real, tregon qartë cilat janë sfidat dhe çfarë duhet të ndodhë", deklaroi Zaharieva. Theksimi i një date indikative mund të jetë nxitje, konsideron Zaharieva dhe Strategjinë e quajti dokument i hapur dhe i ndershëm. Ajo u shpreh e kënaqur që Strategjia gjithashtu është e fokusuar tek të rinjtë, në krijimin e vendeve të punës, në zhvillimin e aftësive sipërmarrëse dhe digjitale. Zaharieva theksoi se perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor do-methënë siguri, stabilitet dhe prosperitet të BE-së. Ministrja gjithashtu, komentoi se ekzistojnë dy lloj lodhesh - lodhje nga zgjerimi midis numrit të madh të qytetarëve dhe elitave politike të vendeve anëtare të BE-së, që është si rezultat i problemeve të shumta me të cilat përballet BE-ja vitet e fundit dhe lodhja nga reformat dhe nënvlerësimi i disa prej vendeve-kandidate. Ajo theksoi se Bullgarinë e ka vendosur shumë lartë, si një nga prioritetet themelore në presidencën e saj, perspektivën evropiane dhe lidhjen e Ballkanit Perëndimor dhe shprehu bindje, se ai fokus ndaj Ballkanit Perëndimor nuk do të përfundojë me gjashtë muajt e presidencës bullgare.

DIMITROV DHE KOXIAS NEGOCIOJNË ME NDËRMJETËSIM TË NIMICIT

KOKË MË KOKË PËR EMRIN



Nuk ka informacione nëse në takimin e djeshëm është shqyrtuar draft-marrëveshja, të cilën për në mes të shkurtit e paralajmëroi Koxias. Shefi i diplomacisë greke muajin e kaluar deklaroi se përgatit, draft-marrëveshje prej katër pikave që, nëse pranohet, do të paraqesë bazë për zgjidhjen e kontestit

Vjenë, 13 shkurt - Më shumë se tri orë zgjat takimi i ministrave të punëve të jashtme të Maqedonisë dhe të Greqisë Nikolla Dimitrov dhe Nikos Koxias me ndërmjetësin Methju Nimic në Vjenë. Tani për tani nuk ka informacione nëse pas negociatave ministrat dhe Nimic do të japin deklarata apo do të publikohet komunikatë e Ministrive të Punëve të Jashtme. Ky është raundi i tretë i negociatave të ripërtëritura midis dy vendeve për zgjidhjen e pothuajse kontestit tridhjetëvjeçar për emrin e Maqedonisë. Negociatat për herë të parë pas ripërtëritjes zhvillohen në nivel të ministrave të punëve të jashtme, pasi për këtë i daakorduan kryeministrat Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras në takimin në Davos muajin e kaluar. Dimitrov dhe

Koxias dje patëm takim në Vjenë, ku i harmonizuan pozicionet para takimit të djeshëm me Nimicin. Nuk ka informacione nëse në takimin e djeshëm është shqyrtuar draft-marrëveshja, të cilën për në mes të shkurtit e paralajmëroi Koxias.

Shefi i diplomacisë greke muajin e kaluar deklaroi se përgatit, draft-marrëveshje prej katër pikave që, nëse pranohet, do të paraqesë

bazë për zgjidhjen e kontestit.

Ministritë e punëve të jashtme të të dy vendeve dhe pres shërbimi i KB-së, dje njëkohësisht e paralajmëruan takimin mes dy ministrave me Nimicin. Raundin e ri të bisedimeve që nga java e kaluar e paralajmëroi kryeministri Zoran Zaev, i cili theksoi se Maqedonia bën gjithçka që të dëshmohej se nuk ka kurrfarë motivesh irredentiste. Zaev e shprehi edhe gati-

shmërinë e palës së Maqedonisë që të pranohet përcaktimi gjeografik, por përmendi se nuk sheh nevojë për ndryshim të Kushtetutës së vendit. Emër i përbërë edhe për përdorim të jashtëm edhe për të brendshëm, për të cilin duhet ndryshim kushtetues dhe tërheqje e të gjitha dyshimeve për qëndrime irredentiste, është korniza që garanton mbylljen e problemit, paralajmëroi sot Cipras në takimin e grupit parlamentar të SYRIZA-s.

Negociatat mes Maqedonisë dhe Greqisë u ripërtëritën më 12 dhjetor të vitin e kaluar në Bruksel, kur me ndërmjetësuësin Nimic u takuan negociatorët Vasko Naumovski dhe Adamantios Vasilakis. Në raundin e fundit të bisedimeve për emrin i cili u mbajt më 17 janar në Nju-Jork ndërmjetësuësi Nimic doli me një seri sugjerimesh dhe propozimesh dhe vlerësimesh se në shesh është zgjidhje e kontesti shumëvjeçar mes Greqisë dhe Maqedonisë. Ndërmjetësi kah fundi i muajit të kaluar i vizitoi Athinën, më pas edhe Shkupin, ku kishte takime të ndara me krerët më të lartë të shtetit dhe politikës së Greqisë dhe Maqedonisë.

ZAHARIEVA: GËZOHEM QË KA PROGRES MES ATHINËS DHE SHKUPIT

Sofje, 13 shkurt - I gëzohem faktit që ka progres në bisedimet mes Athinës dhe Shkupit, deklaroi zëvendëskryeministria bullgare dhe ministre e Punëve të Jashtme, Ekaterina Zaharieva, duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve për kontestin rreth emrit mes Maqedonisë dhe Greqisë. "Kjo është çështje dypalëshe dhe le t'i lëmë Athinën dhe Shkupin t'i zhvillojnë bisedimet me ndërmjetësim të KB-së", theksoi Zaharieva dhe dëshiroi sukses në bisedimet, njoftoi BTA, transmeton MIA. Në Bullgari, e cila është kryesuese aktuale me Bashkimin Evropian më 15 dhe 16 mbahet mbledhje joformale e Këshillit për punë të jashtme (Gimnih), në të cilën do të marrë pjesë edhe shefi i diplomacisë së Maqedonisë, Nikolla Dimitrov.

TAKIM DONATORË SH NË SÇE

Na duhet ndihmë

Shkup, 13 shkurt - Në kohën e ndryshimeve të shpejta kemi nevojë për gjithë ndihmën të cilën e kemi në dispozicion, deklaroi zëvendëskryetari i Qeverisë për Çështje Evropiane, Bujar Osmani në takimin e sotëm të mbajtur me donatorë në të cilën pjesëmarrës ishin ambasadorë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, nga komuniteti i donatorëve në vend. Siç informojnë nga SÇE-ja, qëllimi i takimit ishte të arrihet marrëveshje dhe mirëkuptim për kontributin e donatorëve në procesin e krijimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave nacionale sektoriale dhe integrimin evropian të vendit.

Në fjalën e tij para të pranishmëve zëvendëskryeministri Osmani shprehu falënderim edhe mirënjohje për përkushtimin e madh të komunitetit të donatorëve në Republikën e Maqedonisë, e cila kontribuon mbështetje në zh-

villimin politik, demokratik dhe ekonomik të vendit. "Në kohën e ndryshimeve të shpejta kemi nevojë për gjithë ndihmën të cilën e kemi në dispozicion dhe prandaj për ne nuk ka donator të madh apo të vogël, por secili donator është i rëndësishëm në kushte të agjendës ambicioze të Qeverisë së RM-së", deklaroi Osmani gjatë fjalës së tij.

Osmani iu referua edhe potenciale të reja në përputhje me mesazhet e përfshira në Strategjinë e re të Komisionit Evropian për Zgjerim me vendet e Ballkanit Perëndimor deri në vitin 2025, respektivisht përfitimet nga e njëjta që i takojnë Republikës së Maqedonisë, gjatë periudhës para-ade-ruese. Ai shprehu bindje se administrata e përgatitur do t'i presë rritje e mjeteve për shëndetësinë, arsimin, infrastrukturën, agjendën digjitale, mbështetjen për biznes



etj. dhe do ta adaptojë kapacitetin e absorbimit në përputhje me potencialet e reja, si segment i rëndësishëm për konvergencën e të gjitha shtresave në Republikën e Maqedonisë me ata të vendeve – anëtare të Bashkimit Evropian. Zëvendëskryeministri Osmani shtoi se reformat janë prioriteti më i madh i Qeverisë reformuese dhe rikujtoi se gjashtëmujorin e kaluar, gjithsesi me ndihmë të konsiderueshme të komunitetit të donatorëve, në mënyrë aktive u zbatuan reforma në më shumë sfera: në sferën e drejtësisë, menaxhimin

me financat publike; më pas reforma në administratën publike dhe në arsim; reforma në avancimin e punësimin dhe përmirësimin e transportit; reforma në drejtim të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe menaxhimit me pasojat nga ndryshimet klimatike, etj. Në periudhën e ardhshme, theksoi Osmani, nga donatorët pret të japin kontributin e tyre drejt zbatimit të politikave sektoriale, ndryshimin e kulturës institucionale në drejtim të realizimit të rezultateve dhe sigurimin e efektit afatgjatë nga reformat, me të cilën do të si-

gurohej qëndrueshmëria e përfitimeve nga reformat edhe në të ardhmen. Takimi i donatorëve është pjesë e një sërë takimesh me donatorë të nivelit të grupeve punuese sektoriale, si dhe në nivel të lartë politik dhe po ashtu paraqet forum ku institucionet nacionale mund t'i prezantojnë prioritetet e tyre, për të cilat kanë nevojë për donacion, nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër edhe donatorët mund të prezantojnë programet e tyre/strategjitë si potencial për arrijtjen e rezultateve konkrete që janë të interesit të përbashkët.

Çështja e Shkupit është e humbur për Greqinë

Athinë, 13 shkurt - Lideri i partisë Lidhja e Centralistëve, Vasilis Levandis, konsideron se Greqia e ka humbur kontestin me emrin, me vetë atë që bisedon për emrin e kontestuar me termin e kyçur Maqedonia. Levandis, i cili është kundër emrit Maqedonia, dje u takua me ambasadorin amerikan në Athinë, Xhefri Pajat, ndërsa sot, në intervistë për radion Real Fm, e ka komentuar takimin. Në takimin e djeshëm, sipas kumtesës partiake, Levandis dhe Pajat kanë biseduar për rastin Novartis dhe çështjen e emrit, lajmëron korrespondenti i MIA-s nga Athina. Lideri i Lidhjes së Centralistëve, ambasadorit amerikan ia ka përsëritur propozimin e tij, Greqia nga ana e saj t'i japë Maqedonisë integrim në NATO dhe BE, investimet greke dhe lehtësimet për portin e Selanikut, ndërsa në këmbim "Shkupi, në shenjë të vullnetit të mirë të pranojë emër pa fjalën Maqedonia". Ambasadorit i theksua se nëse Qeveria jep vendim me termin Maqedonia, kjo zgjidhje do të jetë në kundërshtim me vullnetin e popullit grek. Në fund, do t'u bëj dëm edhe vetë Shteteve të Bashkuara të Amerikës", kumtojnë nga partia, transmeton MIA.

LËNDA E PSP-SË ZVARRITET PËR NJË VIT E MË TEPËR

SËMURËT AVOKATJA, SHTYHET GJYQI KUNDËR KOÇANIT

Zvarritja e procesit gjyqësor për rastin "Trust" vazhdon të bëhet edhe pas një viti e më tepër, që kur PSP e ka ngritur aktakuzën në GJPSH. Megjithatë, prezantimi i personave ekspertë dhe lëshimit të disa materialeve nga "bombat" në seancat e deritanishme gjyqësore për këtë lëndë, japin shpresë se në javët në vazhdim - ekziston mundësia reale që ky proces gjyqësor të përmbyllet



gjitha instancat gjyqësore të vendit. Refuzimi fillestar i kësaj aktakuzë nga GJPSH, në mars të vitit të kaluar, ishte shkak për ankimmimin e këtij vendimi para Gjykatës së Apelit në Shkup. Paralelisht me këto zhvillime, në rrethana ende të paqartë, Sead Koçani u largua nga vendi, në kohën kur GJPSH i shqiptoi masën e paraburgimit 30 ditor. Për dy muaj e më tepër, policia e vendit gjatë vitit 2017 ishte në kërkim të afaristit të njohur. Vendimin e GJPSH-së dhe asaj të Apelit, për arrestimin e Koçanit, në maj të vitit të kaluar e shfuqizoi Gjykata e Lartë e Maqedonisë. Në një procedurë të pazakontë deri më tani, me propozim të Prokurorisë Publike, atë kohë të drejtuar nga Marko Zverlevski, kryetari aktual i Gjykatës Supreme, nuk i mori parasysh vërejtjet edhe reagimet e PSP-së,

se prokuroria e shtetit nuk ka hapësirë ligjore të përzihet në punën e tyre dhe e shfuqizoi paraburgimin e Koçanit. Zvarritja e procesit gjyqësor për rastin "Trust" vazhdon të bëhet edhe pas një viti e më tepër, që kur PSP-ja e ka ngritur aktakuzën në GJPSH. Megjithatë, prezantimi i personave ekspertë dhe lëshimit të disa materialeve nga "bombat" në seancat e deritanishme gjyqësore për këtë lëndë, japin shpresë se në javët në vazhdim ekziston mundësia reale që ky proces gjyqësor të përmbyllet. Falsifikimi i dokumentacionit për përfitimi i një tenderi milionësh, për gërmimet e thëngjillit në xeheroren e Suvodollit në Manastir, të cilin e administron kompania shtetërore "ELEM", është lëndë kryesore të cilët e heton PSP për një kohë të gjatë.

AMBASADA E SHBA-VE I PËRCJELLË LËNDËT E PSP-SË

Me dëgjimin e dëshmitarit Zharko Milenkovski, të martën në GJPSH, ka vazhduar procesi gjyqësor për lëndë "Tarifa". Në këtë aktakuzë të ngritur nga PSP-ja, si i akuzuar kryesor paditet ish drejtori gjeneral i "ELEM"-it, Dejan Boshkovski dhe dy persona tjerë. Kompania e dëshmitarit Milenkovski, siç njoftojnë nga PSP, ka marrë pjesë në konzorciumin për furnizim me softuerin për sistemin "ERP" për nevojat e "ELEM"-it. Në deklaratën e dhënë para Trupit gjyqësor, dëshmitari Milenkovski ka theksuar se firma e tij është dashur të merr pjesë në zbatimin e modulit për menaxhim të dokumentacionit për sistemin në fjalë. Ky proces gjyqësor udhëhiqet nga gjykatësja Sofçe Gavrilloska-Efremova, dhe i njëjti të martën është mbikëqyrur nga një përfaqësuar i ambasadës së SHBA-ve, në Shkup. Tre të akuzuarit në rastin "Tarifa", ngarkohen për blerje të jashtëligjshme të softuerit për kompaninë shtetërore "ELEM", vlerë e të cilit ka arritur deri në katër milionë euro.

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 13 shkurt - Ndonëse në fazë përfundimtare, procesi gjyqësor ndaj Sead Koçanit dhe dy të akuzuarve tjerë, ende nuk ka epilog. Seanca e radhës, e cila për rastin "Trust", (lëndë kjo e iniciuar nga Prokuroria Speciale Publike) duhehe të mbahej të martën (13 shkurt) është anuluar për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të njërit prej avokatëve mbrojtës. Mungesa e avokates Sanja Aleksiq, ka ndikuar që faza e prezantimit të dëshmitëve nga pala mbrojtëse e të akuzuarve Sead Koçan, Vasilije Aviroviq dhe Safet Vatiq, të shtyhet për datë 20 shkurt. Pas prezantimit të dëshmitëve mbrojtëse, avokatët dhe të akuzuarit në rastin "Trust" do të kenë mundësi t'i thonë fjalët përmbyllëse dhe më pas - Trupi gjyqësor do të duhet të shqiptojë aktgjykimin për këtë lëndë. Ndryshe, avokatja Aleksiq, krahas kësaj lëndë ajo si palë mbrojtëse paraqitet edhe në më shumë raste, ku PSP-ja, qëndron si përfaqësues se aktakuzave.

Gjykimi kundër Koçanit dhe dy bashkëpunëtorëve të tij zyrtarisht filloi më 7 nëntor të vitit të kaluar. Paraprakisht, aktakuza për rastin "Trust", e cila dyshohet se peshon rreth 17 milionë euro, ishte lëndë shqyrtimi pothuajse në të

Kërkohet shkarkimi i 110 gjykatësve

Shkup, 13 shkurt - Për 110 parashtresa për shkarkimin e gjykatësve duhet të debatohen anëtarët e Këshillit gjyqësor në seancat e ardhshme, nga të cilat e para është caktuar për të enjten. Më shumë nisma për shkarkim janë paraqitur nga Këshilli për vërtetimin e fakteve, por ka edhe parashtresa tjerë. Tre parashtresa nga Prokuroria specia-

le publike dhe disa nga avokatë dhe palë tjera në procedurat, siç publikon portali sakadmdakazham.mk, ka për gjykatësen Monika Bajçovanovska, ndërsa para Këshillit gjyqësor ndodhen edhe nismat për shkarkimin e pesëshes penale nga Gjykata Supreme në krye me kryetarin Jovo Vangelovski, të Rahilla Stojkovskëls, Risto

Katavenovskit, Faik Allanit dhe Xhemali Saitit. Në paralajmërimin për seancën të enjten të publikuar në uebfaqen e Këshillit gjyqësor si pikë e gjashtë është vendosur debati rreth kërkesës për ngritje të procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë për gjykatës, por më shumë hollësi nuk janë komunikuar.

KRONIKË

Arrestohet tre të rinj, kapen me mariuhanë

Pjesëtarë të Policisë së Gostivarit të hënën mbrëma rreth orës 22 në rrugën Nikolla Teslla, në qytetin e Gostivarit kanë ndaluar veturën BMË me targa të Gostivarit e drejtuar nga 22 vjeçari A.S poashtu nga ky qytet ku kanë qenë edhe A.D 21 vjeçar nga Banjica e Poshme dhe A.S 23 vjeçar nga Gostivari. Gjatë kontrollit të veturës është gjetur materie e panjohur bimore, me siguri mariuhanë ndërsa njëri prej tyre ka refuzuar që të hyjë në veturën e policisë dhe ka tentuar që të ikë dhe i ka shkyer uniformën policit duke i shkaktuar edhe lëndim në dorë. Tre të rinjtë janë arrestuar dhe mbajtur në stacionin policor në Gostivar kurse pas zbardhjes së plotë do të ketë edhe padi adekuate.

24 vjeçari nga Reçica largohet nga shtëpia

46 vjeçarja M.F nga fshati Reçicë e vogël të hënën ka denoncuar se më 10 shkurt rreth orës 15 e 30 minuta djali i saj 24 vjeçari R.F është larguar nga shtëpia dhe nuk është kthyer. Sipas denoncimit 24 vjeçari me vete ka patur edhe dokumentet e udhëtimit ndërsa ka edhe dokumente të Italisë. Pas denoncimit policia është vënë në kërkim të tij.

Grabiten 200 litra naftë nga ambulanca në Haraçinë

Një autor i panjohur nga ambulanca në Haraçinë ka grabitur dyqind litra naftë për amvisëri, njoftoi policia. FA. (58) nga fshati i Haraçinës, e punësuar në ambulancën e këtij fshat si infermiere patronazhi, dje ka raportuar se një autor i panjohur ka kryer grabitje në Stacionin Shëndetësor në Haraçinë. Siç njoftoi MPB, autori me përdorimin e forcës ka hyrë në hapësirat e podrumit, ka çmontuar një zorrë të rezervuarit dhe ka marrë rreth 200 litra naftë për amvisëri dhe më pas është larguar në drejtim të panjohur. Merren masa për gjetjen e autorit dhe për zbardhjen e plotë të rastit.

Grabitet "Stopanska Banka" në Aerodrom

Një kryerës i panjohur me kërcënim me pistoletë në mëngjesin e sotëm në Aerodrom të Shkupit ka grabitur ekspoziturën e "Stopanska Bankës" dhe ka marrë 320.000 denarë. Policia njofton se në SPB Shkup në orën 08:45 është denoncuar se në bulevardin "Jane sandaski" në ekspoziturën e "Stopanska Bankës" një kryerës i panjohur me kërcënim me pistoletë nga të punësuarit ka marrë para prej rreth 320.000 denarë, pas çfarë e ka braktisur vendin e ngjarjes. Policia po ndërmerr masa për ndriçimin e plotë të rastit.

Vidhen 21 lap-top nga një dyqan në Gjoçe Petrov

Nga një dyqan për mall teknik në rr. "Gjoçe Petrov" një person i panjohur ka vjedhur 21 kompjuterë lap top dhe ka shkaktuar dëm prej rreth 900.000 denarë. MPB kumtoi se në periudhën prej ora 15:00 më 11 shkurt deri në ora 14:30 dje një person i panjohur ka kryer vjedhje të rëndë në një dyqan për teknikë në rr. "Gjoçe Petrov" në Shkup. Kryerësi, siç theksohet, me copë betoni e ka thyer xhamin e derës hyrëse, është futur brenda dhe ka marrë 21 kompjuterë lap top, pas së cilës ka ikur në drejtim të panjohur. Në atë mënyrë kryerësi ka vjedhur rreth 900.000 denarë. Policia ndërmerr masa për gjetjen e kryerësit dhe për zbardhjen e plotë të rastit. (O.XH.)

Për kohën e sotme kur bota shkon drejt gjetjes së mënyrave se si t'ju bëjë studentëve më të lehtë procesin e studimeve dhe kur ekonomia e tregut lëviz me ritme të paparashikueshme, është jashtë çdo logjike tu vendosësh universiteteve kushtëzime të këtitilla, vlerësojnë numër i konsiderueshëm profesorësh universitar

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 13 shkurt - Profesorët universitar kërkojnë largimin ose ndryshimin e nenit 132 të Propozim-ligjit për arsim të lartë, me të cilin kërkohet që në çdo program studimor i cili zhvillohet në gjuhën shqipe, të paktën tre lëndë të mësohen në gjuhën maqedonase. Për kohën e sotme kur bota shkon drejt gjetjes së mënyrave se si t'ju bëjë studentëve më të lehtë procesin e studimeve dhe kur ekonomia e tregut lëviz me ritme të paparashikueshme, është jashtë çdo logjike tu vendosësh universiteteve kushtëzime të këtitilla, vlerësojnë numër i konsiderueshëm profesorësh universitar.

Prof. dr. Murtezan Ismaili, nga Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë, thotë se ai nen duhet të ndryshohet patjetër dhe këtë duhet ta kërkojnë vetë universiteteve. "Nuk më duket aspak e logjikshme që në universitetet në gjuhën shqipe studentët të mësojnë të paktën tre lëndë në gjuhën maqedonase. Nuk kam asgjë kundër maqedonishtes si gjuhë, mirëpo me detyrimin që tre lëndë të mësohen në këtë gjuhë nuk arrihet asgjë pozitive sa i takon cilësisë së studimeve. Është absurde", pohon ai. Nëse është e nevojshme, në cilësinë e ekspertëve Universitete mund të marrin profesorë maqedonas dhe këtu nuk ka asnjë problem. "Por ta detyrosh universitetin që të mbajë tre lëndë në gjuhën maqedonase, në kohën kur është në miratim e sipër edhe ligji për përdorimin e gjuhëve nuk është komtemporane, nuk është e kohës", shprehet profesor Ismaili. Prandaj, universitete në gjuhën shqipe, plotëson ai duhet të vihen në shërbim të detyrës. "Sigurisht që ndryshimin e neneve që rregullojnë përdorimin e gjuhëve duhet ta kërkojnë universitetet. Është në obligimin e universiteteve ta bëjnë këtë, normal duke kërkuar

ABSURDET E NENIT 131 PËR ARSIMIN E LARTË

ARBITRARITETI I MAQEDONISHTES, I PAPRANUESHËM



PROF. DR. MURTEZAN ISMAILI

Nuk më duket aspak e logjikshme që në universitetet në gjuhën shqipe studentët të mësojnë të paktën tre lëndë në gjuhën maqedonase. Nuk kam asgjë kundër maqedonishtes si gjuhë, mirëpo me detyrimin që tre lëndë të mësohen në këtë gjuhë nuk arrihet asgjë pozitive sa i takon cilësisë së studimeve. Është absurde

edhe mbështetjen e politikës".

Klasa politike jo rrallë herë ka ditur të pajtohet edhe me detyrime të këtitilla ligjore e, çështje e vërteta edhe neni 132 i Propozim-ligjit është i trashëguar nga Ligji i përparshëm. Rektori i Universitetit "Nënë Tereza" prof. dr. Aziz Pollozhani, shpjegon se çështja e përdorimit të gjuhëve në universitetet publike "është diçka që tërhiqet prej shumë vitesh". Pra, është një predispozitë e trashëguar në ligjin për arsim të lartë, por për të cilën Pollozhani beson se mund të hapet si çështje për diskutim edhe tani ose "më së shumti në fazën që vjen", siç shprehet rektori i UNT-së. "Mund të diskutohet, pse jo, sigurisht nëse është në funksion të përmirësimit të cilësisë apo edhe të krijimit të hapësirës më të madhe të gjuhën angleze si për studimet në gjuhën shqipe ashtu edhe maqedonase", shprehet ai.

Për prof. dr. Bashkim Ziberin nga Universiteti i Tetovës nuk ka diskutim që mësimi i lëndëve në gjuhë të



PROF. DR. BASHKIM ZIBERI

Neni 132 që kërkon tri lëndë të mësohen në gjuhën maqedonase, nuk duhet të vlejë për kohën e sotme. Pra imagjinoni, ata që do të studiojnë fizikë, duhet ti detyrojmë që tre lëndë ti zhvillojnë në gjuhën maqedonase, gjë që nuk shkon, pasi neve jemi që të aftësojmë fizicent dhe jo tu mësojmë atyre gjuhë

ndryshme dëmton cilësinë e mësimin dhe vështirëson shkallën studimeve. Mes shumë vërejtjeve që ai ka për Propozim-ligjin e arsimit të lartë, gjuha thotë se është element të cilit duhet ti kushtohet vëmendje e veçantë. "Neni 132 që kërkon tri lëndë të mësohen në gjuhën maqedonase, nuk duhet të vlejë për kohën e sotme. Pra imagjinoni, ata që do të studiojnë fizikë, duhet ti detyrojmë që tre lëndë ti zhvillojnë në gjuhën maqedonase, gjë që nuk shkon, pasi neve jemi që të aftësojmë fizicent dhe jo tu mësojmë atyre gjuhë", shprehet Ziberi.

Kundërshtimin e këtij neni ai e argumenton me ngarkesën negative që do të sjell zbatimi eventuali i atij neni. "Sepse, në bazë të atij neni neve duhet të punësojmë profesor maqedonas i cili do të ligjërojë për shembull lëndën 'Fizika e trupit të ngurtë', ndërkohë që lënda 'Hyrja në fizikën e materialeve' me gjithë terminologjinë e profesionit është mësuuar në gjuhën shqipe. Nuk ka



PROF. DR. AZIZ POLLOZHANI

Mund të diskutohet, pse jo, sigurisht nëse është në funksion të përmirësimit të cilësisë apo edhe të krijimit të hapësirës më të madhe të gjuhën angleze si për studimet në gjuhën shqipe ashtu edhe maqedonase

logjikë kjo punë, sepse ne jemi që tja bëjmë studentëve më të lehtë pjesën e studimit dhe jo më të vështirë". Ky nen, plotëson më tej Ziberi duhet të largohet, sepse është thjeshtë demode.

Megjithatë, në rrugë zyrtare as Universiteti i Tetovës (UT), as Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup (UNT) dhe as Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) nuk kanë kërkuar një gjë të tillë. Në komunikimin që kanë pasur me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH) as njëra dhe as tjetra nuk e kanë prekur çështjen e gjuhëve në të cilën zhvillohet mësimi në institucionet e arsimit të lartë.

Në vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet që i kanë dërguar në MASH lidhur me Propozim-ligjin për arsim të lartë asnjëri prej universiteteve në gjuhën shqipe nuk ka përfshirë në kundërshtimet e veta neni 132 i cili obligon ata që përveç gjuhës maqedonase si lëndë e veçantë të mësohen në maqedonisht minimum edhe dy lëndë të tjera, për çdo program studimor.

Alpinistët detyrimisht t'i paraqesin turet për ngjitje

Tetovë, 13 shkurt - Adhuresit e sporteve të bardha dhe alpinizmit dhe para së gjithash shtetasit e huaj, nëse planifikojnë ngjitje në majat malore ose skijim, të paraqiten në stacionet ose sektorët më të afërt policore, apelojnë nga SPB Tetovë, njofton MIA. Apeli vjen pas paralajmërimeve për reshjet intensive të borës dhe përqesimit të kushteve të motit në zonat malore. "Gjatë paraqitjes, përfrohet të theksojnë dhe të informojnë ku do të lëvizin dhe sa mendojnë se do të qëndrojnë. Në këtë mënyrë mundet më shpejt të locohen dhe nëse ka nevojë, t'ju ndihmohet. Në situata të caktuara shumë e rëndësishme është çdo minutë, veçanërisht gjatë situatave të pavolitshme të motit dhe të terrenit vështirë të depërtueshëm, në të cilat nuk ka mundësi për vendosjen e kontaktit telefonik ose komunikimit tjetër me personat e humbur", thotë Marjan Josifovski, zëdhënësi i SPB Tetovë. Josifovski përkujtoi se muajin e kaluar dhe këtë muaj janë paraqitur disa humbje të individëve, të cilët për shkak të mosnjohjes së terrenit ose kushteve të pavolitshme të motit, janë humbur dhe nuk kanë mundur të kthehen mbropa. Fundjavën e kaluar në Kodrën e Diellit ka pasur dy raste të humbjes pas çka u vendos aksion për gjetjen e tetë personave të humbur. Me reagim në kohë, të mërkurën e kaluar (7 shkurt) nga rruga e bllokuar Mavrovë-Galiçnik janë nxjerrë edhe dy turistë amerikanë. Pas hetimeve të vendosura, të realizuara nga nëpunësit policorë nga ky sektor, të koordinuar me shërbimet malore dhe të tjera, personat e humbur u locuan, u gjetën dhe u kthyen të sigurt.



Shkup, 13 shkurt - Ish-shefat e DSK-së, Goran Grujevski dhe Nikolla Boshkovski, për dy ditë, më 15 shkurt,

Grujevski dhe Boshkovski me deklaratë para Komitetit për azil në Selanik

para Komitetit për azil në Selanik do t'i japin arsyet për të cilat kërkojnë azil në Greqi, konfirmuan për MIA-n nga ekipi i avokatëve. Paraprakisht seanca dëgjimore fillestare në Komitet është anuluar pasi ka pasur problem me sigurimin e

përkthyesit në gjuhën maqedonase. Grujevski dhe Boshkovski kërkesë për të fituar azilin politik në Greqi dorëzuan më 29 nëntor vitin e kaluar. Ky hap, siç njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina, ishte i pritshëm, duke e pasur parasysh atë se

në raste të tilla, që të prolongohet ekstradimi hapi i parë është të kërkuarit azil. Me kërkesën e dorëzuar për azil politik, u hap një proces i ri paralel dhe plotësues. Grujevski dhe Boshkovski, në Greqi, tashmë i kanë tri procese të ndryshme dhe të

cilat nuk lidhen njëri me tjetrin, njëri për ekstradim pas fletëarrestimit ndërkombëtar nga ana e Maqedonisë, tjetri për falsifikimin e pasaportave me të cilat janë kapur në aeroportin e Selanikut dhe i treti për kërkesën për azil.

Sociologët kërkojnë që shteti të të ushtrij me shumë kontroll ndaj lojërave të fatit dhe të ndalojë hapjen e bastoreve në çdo rrugicë të qyteteve dhe me këtë të parandalojë të gjitha mekanizmat që i dërgojnë qytetarët e varfër e sidomos të rinjtë në bastore, duke shpresuar se do të fitojnë para apo duke pritur me ankth që të dalin fituese skedinat që kanë në dorë

ALARMI I NJË DUKURIE DEVIJANTE

ROBËRI BASTORESH



Koha ZEJNULLA VESELI

Shkup, 13 shkurt - Qytetarët e Maqedonisë brenda një ditë nëpër bastoret paguajnë mbi 500.000 euro që nënkupton se mesatarisht çdo qytetar shpenzon 17 denarë në ditë në bastore. Kështu tregojnë të dhënat e fundit të Drejtorisë për të Hyra Publike ku thuhet se vitin e kaluar në bastore janë paguar rreth 200 milion euro gjegjësisht nëse këtë shifër e përpjesëtojmë me 2 milion banorë sa ka Maqedonia i bie se çdo vit një banorë shpenzon 100 euro në bastore.

Këto të dhëna për fenomenin e përhapjes së lojërave të fatit gjegjësisht bastoreve që tani më i gjen në çdo cep të qyteteve në gjithë territorin e Maqedonisë, sipas sociologëve është pasojë e varfërisë dhe papunësisë së madhe që ka bërë të të gjithë qytetarët sidomos të rinjtë të gjitha rrugët t'i dërgojnë në bastore, duke shpresuar se do të fitojnë para dhe duke pritur me ankth që të dalin fituese skedinat që kanë në dorë.

Sociologu Ilija Acevski thotë se tani më në Maqedoni nuk ke rrugë ku nuk ka një bastore dhe se bastoret tani më janë bërë përditshmeri jo vetëm në qytete por edhe nëpër fshatra për shkak se organet kompetente kanë humbur arsyen dhe kontrollin mbi këto lojëra të fatit.

"Kur në çdo rrugë sheh se si hapet brenda natës një bastore kjo

tregon qartë jo vetëm se shteti ka humbur kontrollin dhe nuk merr masa për parandalimin e hapjes së bastoreve por se kjo është shenjë se njerëzit ëndërrojnë për pasurim të shpejtë dhe të lehtë. Kjo flet për një situatë të mjerueshme sociale dhe ekonomike të qytetarëve dhe se bastoret për të gjithë grup moshat janë bërë një virus i keq. Tek ne, bastoret kane punë shumë, sepse nëse një qytetar fiton njëherë ai mendon se prapë do të fiton edhe herët tjetër për 1 here fitim 1000 here do të humb. Mendoj se varësia e tepërt nga lojrat e fatit sjell edhe shume dukuri tjera negative jo vetëm për qytetarët por edhe për vetë shtetin në përgjithësi. Këtë shifër fantastike prej 200 milion euro të paguara në bastoret tregon se qytetarët e Maqedonisë kënaqen me lojrat e fatit edhe pse janë të vetëdijshëm se më shuam humbin para se sa fitojnë", thotë Ilija Acevski, profesor i sociologjisë.

Ndërkohë edhe sociologu Ali Pajaziti thotë se fenomeni i lojërave të fatit, pra i bastoreve si formë më ligj dhe si një version më kataklizmatik, paraqet një dukuri patologjike të një shoqërie me parametra ekonomike deprimuese, ku cilësia e jetesës është e nivelit të varfërisë relative, me ishuj edhe të asaj absolute, dhe ku sërish popullata e shtyrë nga shumë faktorë si mjerimi, shoqëria desocializuese,

ALI PAJAZITI

Linja e zhvillimeve është kjo: bosat e bastoreve rriten, lojtarët e mjerë mjerohen e shkretohen, por s'e diktojnë. Duhet një mobilizim i madh gjithë shoqëror, nga instancat zyrtare shtetërore deri te mediet, intelektualët, klerikë, që të ndalet në veçanti rinia, sepse nëse vazhdohet me këtë ritëm, do kemi një ardhmëri rinore totalisht pasive, ëndërrimtare, pa perspektivë, pa shkollë, pa vlera

vizualiteti i shtettrrethimit vazhdon të zhytet në rërën e gjallë.

"Këto trende janë jashtëzakonisht shqetësuese duke e marrë parasysh faktin se nuk luajnë vetëm njerëzit që jetojnë në mjedise urbane, por edhe fshatarët, ata që para dite fitojnë nga sallatat jeshile e spinaqi dhe në mbrëmje i bëjnë "rrush e kumbulla", i tretin sikur nuk ishin, duke ngrënë kështu nafakën e familjeve të veta, duke shkuar drejt një humnere ekonomike e sociale", thotë sociologu Pajaziti. Ky fenomen për Pajazitin paraqet një psikologji masovike që po përhapet i robëron edhe ata që jetojnë në një gjendje të mirë ekonomike. "Rastisim edhe njerëz që jetojnë në shtresën e mesme dhe të lartë që

shkojnë sa më larg vendbanimit të tyre për të provuar fatin, dhe dita ditës bëhen të varur nga kjo sëmundje moderne", thotë Pajaziti. Me keqja e gjithë kësaj, sipas tij, është se qytetari i thjeshtë apo të rinjtë edhe pse të vetëdijshëm se nuk fitojnë nga lojrat e fatit ata edhe më shumë vazhdojnë të luajnë me shpresë se një ditë do të del fitues. "Linja e zhvillimeve është kjo: bosat e bastoreve rriten, lojtarët e mjerë mjerohen e shkretohen, por s'e diktojnë. Duhet një mobilizim i madh gjithë shoqëror, nga instancat zyrtare shtetërore deri te mediet, intelektualët, klerikë, që të ndalet në veçanti rinia, sepse nëse vazhdohet me këtë ritëm, do kemi një ardhmëri rinore totalisht pasive, ëndërrimtare, pa perspektivë, pa shkollë, pa vlera. Edhe liria e zhvillimit të ekonomisë duhet të ketë një kufi; nuk ka mundësi që virusi të përhapet në mënyrë kaq transparente, para syve tanë. Këto shtëpi të mbytyjes së ngadalshme të shumë personave për sa i përket ardhmërisë duhet që të futen nën kontroll, të zhvillojnë veprimtari të kufizuar dhe në numër të kufizuar. 200 milionë dollarë është një shumë marramendëse e harxhuar në iluzione. Kjo shifër është alarmante, është sinjal i kuq për prijësit e kësaj shoqërie dhe për gjithë ne", thotë Ali Pajaziti profesor i sociologjisë.

Kundër rritjes së kufirit të moshës për pensionim

Shkup, 13 shkurt - Konfederata e Sindikatave të Lira të Maqedonisë (KSL) nuk e mbështet propozimin për rritjen e kufirit të moshës për pensionim, pasi që vlerëson se kjo nuk do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme drejt rritjes së fondit pensional, si dhe se në mënyrë negative do të ndikojë ndaj të punësuarve, kompanive dhe ekonomisë. Rritja e kontributeve për dy për qind mund të pranohet nëse ekziston konsensus me organizatat e punëdhënësve përmes shqyrtimit të implikimeve afatshkurtra dhe afatgjata prej reformës. "Maqedonia si vend i cili ndodhet në vendin e fundit në Evropës sipas "cilësisë së qëndrueshme të jetesës", ndërsa si pjesë e indikatorëve të cilët e përcaktojnë cilësinë e jetës janë shpërndarja e sëmundjeve, shkalla e papunësisë, jetëgjatësia e pritur, gjendja e mjedisit jetësor, nuk guxon të lejojë që punëtori në mënyrë plotësuese të mbingarkohet me rritjen e kufirit të moshës për pensionim. Përkundrazi duhet të vendoset stazhi me beneficion për vendet e punës të cilat paguhen pak dhe të vendoset mundësi për pensionim të parakohshëm nën kushte të tjera, thuhet në kumtesën e KSL. Që atje vlerësojnë se nevojitet në mënyrë sistematike të punohet në zhvillimin e qëndrueshmërisë së sistemit pensional edhe atë përmes më shumë politikave siç janë rritja e shkallës së punësimeve përmes masave aktive edhe atë punësim në vendet të punës jashtë atyre që paguhen pak, përmes zvogëlimit të vëllimit të ekonomisë joformale me format e ndryshme të stimulimit dhe mbështetjes së formalizimit të aktiviteteve ekonomike joformale me çka shkalla e të punësuarve kundrejt pensionistëve do të rritet. KSL gjithashtu, vlerëson se rritje të pensioneve duhet pasur, në korniza të qëndrueshme pasi në të kaluarën, ndërsa edhe sot një pjesë e tyre janë kategori sociale. "Në Maqedoni më shumë se gjysma e pensionistëve janë pranues të pensionit minimal, ndërsa vetëm rreth 5 për qind janë pranues të pensionit më të lartë se paga mesatare. Plakja e popullatës nuk duhet të shihet si problem kryesor për qëndrueshmërinë e fondit pensional, duhet të sillen strategji për stimulimin edhe të shtyllës së tretë me qëllim të rritjes së ndikimit të saj ndaj të ardhurave pensionale", thuhet në kumtesë.

ASKUSH NUK MENDOI PËR USHTRINË, POR PËR TENDERE



Tetovë, 13 shkurt - Stevo Pendarovski, koordinator për Integrimin e Maqedonisë në NATO, gjatë qëndrimit të tij në Tetovë, i ftuar nga Këndi Amerikan, theksoi se në të kaluarën - për qytetarët dhe rininë nuk është sqaruar se cilët do të jenë beneficionet pasi Maqedonia

të anëtarësohet në NATO.

"Për fat të keq, gjatë 11 viteve të kaluara Republika e Maqedonisë e dimë se kishte një regjim dhe kjo nuk është vetëm një frazë që nuk ka përmbajtje, përkundrazi - ka një përmbajtje shumë të keqe dhe kjo na ktheu shumë pas, në vitin 2008, atëherë kur Maqedonia kishte gjithçka të plotësuar si në aspektin ushtarak, poashtu edhe politik përveç kontestit me emrin. Më pas, ata na vunë edhe dy tre kushte tjera, institucione të politizuara, nuk ka gjyqësi të pavarur, nuk ka media të lira. Qeveria e re këtë e ka përshpejtuar, sado që të jetë i rëndë Plani 3-6-9, patjetër të

realizohet dhe kjo duhet të realizohet para Samitit të ardhshëm të NATO-së, para them se duhet që të gjitha pjesët tjera të plotësohen përveç emrit", deklaroi Pendarovski. Ai u shpreh se Maqedonia nuk ka asnjë alternativë tjetër. Pendarovski shtoi se edhe në vitin 2008 është provuar varianti që të anëtarësohen në NATO me emrin IJRM, por nuk ka patur sukses. Pendarovski ka pranuar se sa i takon aspektit teknik, ka shumë punë që të realizohen në ushtrinë e Maqedonisë. "Sa i takon standardit të ushtrisë, ka ende shumë për të bërë, sidomos në aspektin material dhe teknik, të mos flasim për

pagat e tyre. Tash kjo ministri përfundimisht ka bërë rritjen e pagave që gjithsesi është sërish shumë larg nga ajo që është e mjaftueshme. Por në anën tjetër, kemi shumë përvojë për pjesëmarrje në misionet të ndryshme paqësore, si në Afganistan, Irak, Liban, Bosnjë dhe kështu me radhë. Pra, në këtë drejtim kemi një ushtri të përgatitur mirë, kurse në aspektin teknik ne jemi në fund. Në të kaluarën askush nuk ka menduar për ushtrinë, por vetëm për tendere", tha Pendarovski. Këto komente Pendarovski i bëri para fillimit të ligjëratës me temë "Beneficionet e të rinjve nën ombrellën e NATO-s". (U.H)



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 22, paragrafi 8 i Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016), ndërsa në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005, 106/2008...119/2016), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural publikon

SHPLLJE PUBLIKE

Për punësim të 28 realizuesve për kohë të caktuar edhe atë:

- Udhëheqës të departamentit për furnizime publike**, departamenti për furnizime publike, sektori për çështje të përgjithshme dhe juridike – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI A sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencave ekonomike, shkencave organizative dhe menaxhim (menaxhment) ose shkencave juridike,
- Së paku **katër vjet** përvojë pune në profesion prej të cilave së paku **dy vjet** përvojë pune me fondet e BE (IPA) dhe së paku **një vit** përvojë pune në vendin e punës në sektor publik dhe
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje aktive të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 45.761,00 denarë.
- Këshilltar për menaxhim me bazë të çmimeve referente**, departamenti për bazë të çmimeve referente, sektori për regjistra – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI A sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e makinerisë, shkenca mbi tokën dhe hidrologjinë (ekonomika e bujqësisë dhe zhvillimit) ose shkencave ekonomike,
- Së paku **tre vjet** përvojë pune në profesion prej të cilave së paku **një vjet** përvojë pune me fondet e BE (IPA) dhe
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje aktive të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 41.313,00 denarë.
- Këshilltar për dizajnim të bazave të dhënave**, departamenti për bazën e të dhënave, sektori për teknologji informatike dhe të komunikimit – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI A sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e informatikës, elektroteknikës ose teknikës kompjuterike dhe informatikës,
- Së paku **tre vjet** përvojë pune në profesion dhe
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje aktive të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 41.313,00 denarë.
- Këshilltar për realizim të furnizimeve publike**, departamenti për furnizime publike, sektori për punë të përgjithshme dhe juridike – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI A sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencave ekonomike, shkencave organizative dhe menaxhim (menaxhment) ose shkencave juridike,
- Së paku **tre vjet** përvojë pune në profesion dhe
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje aktive të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 41.313,00 denarë.
- Këshilltar për kontroll të objekteve ndërtimore**, departamenti për kontroll të masave të financuara nga Buxheti i BE, sektori për kontroll në terren – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI A sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e arkitekturës, urbanizimit dhe planifikimit ose ndërtimitarisë,
- Së paku **tre vjet** përvojë pune në profesion prej të cilave së paku **një vjet** përvojë pune me fondet e BE (IPA) dhe
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje aktive të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 41.313,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i lartë për zhvillim të sistemeve të informacioneve**, departamenti për sisteme të informacioneve, sektori për teknologji informatike dhe të komunikimit – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e informatikës, elektroteknikës ose teknikës kompjuterike dhe informatikës,
- Së paku **dy vjet** përvojë pune në profesion dhe
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje aktive të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 36.201,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i lartë për realizim të kontrollit**, departamenti për kontroll të masave nga programet nacionale për zhvillim rural, peshkatari dhe akuakulturë, sektori për kontroll në terren – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e teknologjisë së prodhimeve ushqimore, prodhimtaria bimore ose medicina veterinare,
- Së paku **dy vjet** përvojë pune në profesion dhe
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje aktive të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 36.201,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për realizim të buxhetit të Agjencisë**, departamenti për koordinim buxhetor, sektori për çështje financiare – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencave ekonomike ose shkencave organizative dhe menaxhim (menaxhment),
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për futjen e të dhënave**, departamenti për regjistër të vetëm të ekonomive bujqësore, sektori për regjistra – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencave ekonomike ose shkencave organizative dhe menaxhim (menaxhment),
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për mbështetje të mirëmbajtjes së bazave të të dhënave**, departamenti për bazë të të dhënave, sektori për teknologji informatike dhe të komunikimit – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencave ekonomike ose shkencave juridike,
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për mbështetje të përdoruesve të bazave të të dhënave**, departamenti për bazë të të dhënave, sektori për teknologji informatike dhe të komunikimit – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencave ekonomike ose shkencave organizative dhe menaxhim (menaxhment) ose shkencave juridike,
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për mbështetje të përdoruesve të bazave të të dhënave**, departamenti për bazë të të dhënave, sektori për teknologji informatike dhe të komunikimit – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencave ekonomike ose shkencave organizative dhe menaxhim (menaxhment) ose shkencave juridike,
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për shënim të dokumentacionit të kontabilitetit**, departamenti për kontabilitet, sektori për çështje financiare – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencave ekonomike ose shkencave organizative dhe menaxhim (menaxhment) financiar ose kontabiliteti,
- Pa përvojë pune në profesion dhe**
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për përgatitje dhe realizim të instalimeve elektrike**, departamenti për kontroll të masave të financuara nga buxheti i BE, sektori për kontroll në terren – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e elektroteknikës ose inxhinierisë së telekomunikacionit,
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për përgatitje dhe kontroll të dokumentacionit**, departamenti për miratim të pagesave nga masat e financuara nga Buxheti i RM, sektori për miratim të pagesës – 2 (dy) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencës mbi tokën dhe hidrologji (ekonomika e bujqësisë dhe zhvillimit), prodhimtaria e blegtorisë (blegtoaria) ose shkenca ekonomike,
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për përgatitje dhe kontroll të dokumentacionit**, departamenti për zhvillim të mjediseve rurale, sektori për miratim të projekteve – 2 (dy) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e teknologjisë së prodhimeve ushqimore, shkencave të tokës dhe hidrologjisë ose shkencave ekonomike,
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për përgatitje dhe kontroll të dokumentacionit**, departamenti për miratim të investimeve në përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore – 2 (dy) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencës së tokës dhe hidrologjisë (ekonomika e bujqësisë dhe zhvillimit), prodhimtaria bimore ose shkencave ekonomike,
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për përgatitje dhe kontroll të dokumentacionit**, departamenti për miratim të investimeve në përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore – 2 (dy) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencës së tokës dhe hidrologjisë (ekonomika e bujqësisë dhe zhvillimit), prodhimtaria bimore ose shkencave ekonomike,
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për përgatitje dhe kontroll të dokumentacionit**, departamenti për përmirësim të konkurrencës së bujqësisë, sektori për miratim të projekteve – 2 (dy) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencës së tokës dhe hidrologjisë (ekonomika e bujqësisë dhe zhvillimit), prodhimtaria blegtoariale (blegtoaria) ose shkencave organizative dhe menaxhim (menaxhment),
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për kontroll të dokumentacionit**, departamenti për pagesa të drejtpërdrejta për prodhimtari bimore, sektori për pagesa të drejtpërdrejta – 2 (dy) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencës së tokës dhe hidrologjisë (ekonomika e bujqësisë dhe zhvillimit), shkencat ekonomike ose shkencat organizative dhe menaxhim (menaxhment),
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për kontroll të dokumentacionit**, departamenti për pagesa të drejtpërdrejta për prodhimtari blegtoariale, sektori për pagesa të drejtpërdrejta – 2 (dy) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencës së tokës dhe hidrologjisë (ekonomika e bujqësisë dhe zhvillimit), shkencat ekonomike ose shkencat organizative dhe menaxhim (menaxhment),
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.
- Bashkëpunëtor i ri për revizion për trajnim**, departamenti për revizion të masave të financuara nga Buxheti i BE, sektori për revizion të brendshëm – 1 (një) realizues.
Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të theksuara në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Niveli i kualifikimit VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga fusha e shkencave ekonomike ose shkencave organizative dhe menaxhim (menaxhment),
- Pa përvojë pune në profesion dhe
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje të gjuhës angleze.
Bruto pagesa mesatare mujore: përafërsisht 32.573,00 denarë.

Secili kandidat për vendet e theksuara të punës, krahas kushteve të theksuara, duhet të përmbushë edhe kushtet e përgjithshme për punësim të theksuara në nenin 31 të Ligjit për nëpunësit administrativ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/2014, 199/2014, 48/2015, 154/2015, 5/2016, 142/2016 dhe 11/2018) edhe atë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Në mënyrë aktive të shfrytëzohet gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës për të cilin konkurron dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Java e punës zgjatë 5 ditë edhe, për ditës së hënë deri ditën e premtë. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, ndërsa gjatë ditës së punës është 8 orë edhe atë me fillim prej ora 08:30 deri në ora 16.30.

Të gjitha vendet e publikuara të punës janë për kohë të caktuar me kohëzgjatje deri më 31.12.2018. Me kandidatët e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të caktuar, me mundësi për vazhdimin e saj.

Para lidhjes së marrëveshjes, kandidatët e zgjedhur do të testohen për njohje të gjuhës angleze dhe punës me programe kompjuterike për punë në zyrë (MS Office).

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Biografi të shkurtër në gjuhën maqedonase (CV),
- Certifikatë për arsim të mbaruar përkatës (kopje) dhe
- Certifikatë të shtetësisë (kopje).

Dokumentet duhet të dërgohen në adresën në vijim:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, bul. 3-ta Makedonska Brigada numër 20 (ndërtesa Makedonija Tabak, bloku C), 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë ose personalisht në Sportelin e Agjencisë.

Afati përfundimtar i parashtrimit të dokumenteve është 23.02.2018.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet. Zgjedhja e personave të cilët do të lidhin marrëdhënie pune për kohë të caktuar me Agjencinë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural do të bëhet në afat prej 45 ditëve nga dita e kalimit të afatit për paraqitje.

Inkurajohen të gjithë kandidatët të cilët konsiderojnë se janë të aftë, të motivuar për punë ekipore dhe i përmbushin kushtet të aplikojnë në këtë shpallje.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet do të shqyrtohen në mënyrë të kujdeshme nga ana e Komisionit të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural. Kandidatët të cilët përmbushin kushtet e nevojshme dhe kanë aplikacion të rregullt do të kontaktohen.

Më shumë informacione për veprimtarinë e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural mund të gjenden në www.ipardpa.gov.mk

PAGESA E BORXHEVE NDAJ BANKAVE

AMVISËRITË MË TË RREGULLTA SE BIZNESET

Kriza politike ka ndikuar që bankat të riorientojnë kreditë e tyre nga kompanitë tek personat privat. Analizat tregojnë se në totalin e kredive prej 6.5 për qind ose shumën prej 325 milion euro, që kanë vështirësi me kthimin e tyre rregullt të borxheve ndaj bankave, dominojnë bizneset ndaj amvisërive, në raportin katër me një.



milion euro.

Për dallim prej viteve të kaluara kur në kreditim kishte përparësi biznesi, tani bankat i kthehen popullatës me arsyetimin se është rritur rreziku tek kompanitë që janë të goditura nga kriza politike. Ndryshimin e trendeve e konfirmojnë edhe të dhënat e Bankës Popullore të Maqedonisë, sipas të cilave në periudhën dhjetor të vitit 2016 deri në muajin tetor të vitit 2017 është rritur borxhi i qytetarëve në banka nga 129 miliardë denarë në afër 140 miliardë denarë apo afër 2.3 miliardë euro. Në të njëjtën periudhë shënon ulje kreditimi i biznesit prej afër 160 miliardë denarë në afër 146 miliardë denarë apo afër 2.4 miliardë euro.

Bankierët thonë se amvisëritë kanë më pak probleme lidhur me pagesën e kredive në raport me kompanitë për shkak se bëhet fjalë për shuma më të vogla të kredive që janë marrë nga numër më i madh i klientëve në raport me bizneset e ndryshme. Gjithashtu kreditë janë të miratuar për qytetarët e punësuar në administratë që kanë

paga të rregullta, ose janë të punësuar në kompanitë private që marrin paga më të mëdha se ato mesatare.

“Bankat deri në muajin shtator të vitit 2017 kanë miratuar kredi për një milion e 135.994 qytetarë. Kjo paraqet një rritje për 213.635 klientë të ri për periudhën shtator 2016 - shtator 2017 të cilët mesatarisht kanë borxh prej 2082 euro apo në total kanë borxh prej afër 2.4 miliardë euro” tregojnë të dhënat e Bankës Popullore të Maqedonisë.

Gjysma e borxhit të qytetarëve (afër 1.2 miliardë euro) kanë të bëjnë me kreditë konsumatore, ndërsa afër 630 milion euro janë kredi banesore.

Në ndërkohë bankierët konfirmojnë trendin e preferencës më të madhe të bankave të kreditojnë amvisëritë në raport me bizneset.

“Nevojitet që përmes masave monetare dhe fiskale të orientohen bankat të plasojnë mjete në biznes. Ngjashëm me veprimtaritë e tjera ekonomike edhe në sektorin e bankave, aktivitetet e investimeve

çdo herë orientohen atje ku me rrezik më të vogël kemi rendimente më të mëdha, ndërsa për momentin aktivitetet kreditore janë më efektive me plasmanet tek amvisëritë”, thotë Vladimir Eftimovski, numri një i Stopanska Banka nga Manastiri.

Ndryshe, bankat në menaxhimin me kreditë problematike që vonohen më shumë se 90 ditë, komunikojnë rregullisht me klientët e tyre përmes paralajmërimeve për vonesat. Gjatë takimeve dhe kontakteve përcaktohen shkaqet e vonesave, si dhe kërkohen mënyrat konkrete për zgjidhjen e problemit dhe rregullimin e obligimeve. Një nga mundësitë është edhe reprogramimi i borxheve me kamata më të ulëta se ato ndëshkuese. Bankat në dispozicion kanë edhe përdorimin e mjeteve për pagesë me ndalesë administrative, apo ngritjen e procedurës për pagesë të dhunshme. Procedura e realizimit të pronës, të vendosur në hipotekë, si sigurim për kredinë e shfrytëzuar, fillohet kur janë harxhuar të gjithë mundësitë e tjera për pagesën e borxhit.

Kosovë, mbyllen 40 biznese të lojërave të fatit

Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se Divizioni i Lojërave të Fatit vetëm gjatë muajit janar dhe shkurt të këtij viti ka mbyllur 40 subjekte të lojërave të fatit, të cilat njëkohësisht janë ndëshkuar me gjoba në vlerë 213,000 euro. ATK njofton se gjatë javës së kaluar ka zhvilluar edhe një aksion në komunën e Prishtinës, Prizrenit, Gjakovës, Gjilanit dhe Ferizajt më qëllim të identifikimit të subjekteve të lojërave të fatit, të cilat jashtëligjshëm ushtrojnë këtë veprimtari. Në komunikatën e ATK-së thuhet se inspektorët kanë vizituar 13 biznese të lojërave të fatit, te të cilat janë konstatuar parregullsi të ndryshme, për sa i përket ushtrimit të kësaj veprimtarie.

“Gjithsej 5 subjekte janë mbyllur, pasi që të njëjtat kanë vepruar pa licencë të ATK-së. Po ashtu janë lëshuar gjoba në vlerë 89,000 euro”, thuhet në komunikatën e ATK-së.

ATK u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të raportojnë përmes linjës pa pagës 0800 800 800, rastet për të cilat dyshohen se ushtrojnë veprimtarinë e lojërave të fatit jashtë ligjshme.



Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 13 shkurt - Amvisëritë janë katër herë më të rregullta se kompanitë në pagesën e borxheve ndaj bankave. Prej shumës së përgjithshme (4.7 miliardë euro) të miratuarra të kredive në Maqedoni, kredi kontestuese apo të dyshimta janë afër 325 milion euro. Analizat tregojnë se në totalin e kredive prej 6.5 për qind që kanë vështirësi me kthimin e rregullt të borxheve ndaj bankave, dominojnë bizneset ndaj amvisërive, në raportin katër me një. Në ndërkohë, kreditë e miratuara për popullatën deri në muajin tetor të vitit 2017, kanë arritur shifrën prej 2 miliardë e 270 milion euro, që si shumë i është afruar kreditimit të biznesit me 2 miliardë euro e 370

Kroacia po bëhet e varur nga turizmi

Industria e turizmit në Kroaci cilësohet si një prej industrive më të fuqishme të BE-së, duke u renditur e treta ndër të tjerat, por ekonomia e saj rrezikon të mbështetet shumë në një sektor të paqëndrueshëm, shprehet një analist.

Edhe pse Kroacia është krenare për industrinë e saj të lulëzuar të turizmit, disa analistë paralajmërojnë se mbështetja vetën në një sektor të ekonomisë është potencialisht e rrezikshme.

Sipas agjencisë së statistikave të BE-së, Eurostat, Kroacia kishte 86.1 milionë vizita njëditore në vitin 2017, duke shënuar një rritje të

turizmit me 10.6% në krahasim me 2016.

Pikërisht kjo rritje e renditi Kroacinë të tretën pas Letonisë me 12% dhe Sllovenisë me 11.3%, rritje kjo e konsiderueshme në krahasim edhe me 5.1% e rritjes mesatare të BE-së.

Shifrat zyrtare konfirmojnë se industria e turizmit në Kroaci shënoi rritje me 18% të PBB-së së saj në 2016, raporti më i lartë në Europë, përpara vendeve tradicionalisht të orientuara nga turistët, si Malta apo edhe Qipro. Raporti për nëntë muajt e vitit 2017 tregon se kjo shifër ka shkuar në 24% të PBB-

së. Analisti ekonomik, Damir Novotny, tha se lidhja midis turizmit dhe tregut të punës në Kroaci është “mjaft e fortë”, duke shtuar se rritja “varet nga konsumi i turizmit, i cili është i ndjeshëm (ndaj luhatjeve)”. Ai tha më tej se një vit ne mund të kemi rezultate të mëdha në industrinë e turizmit ndërsa vitin tjetër, në varësi të kohës e cila mund të mos jetë shumë e mirë, këto rezultate ulen ndjeshëm. Prandaj PBB-ja nuk duhet të varet nga turizmi, duke theksuar se kjo është një prej pengesave më serioze në zhvillimin e mëtejshëm të Kroacisë. Gjithashtu

e gjithë kjo rritje është e kufizuar vetëm në rajonet bregdetare, duke e lënë në harresë Kroacinë kontinentale. Vetëm nëse të gjitha rajonet e Kroacisë do të zhvillohen në mënyrë të barabartë, veçanërisht në pjesët lindore (të Sllavonisë), ekonomia e Kroacisë do të zhvillohet dhe rritet në tërësi”, – paralajmëroi z. Novotny. Ai vuri në dukje se pothuajse të gjitha projektet kryesore infrastrukturore në rajonin bregdetar janë të lidhura me turizmin, duke thelluar hendekun me rajonet lindore të pazhvilluara. Këtu, ai përmendi planifikimin për ndërtimin e urës

së Peljesaçit, që lidh kontinentin me gadishullin jugor të Peljesaçit. Nëse këto para do të përdoren për zhvillimin lokal dhe industrinë përpunuese në Sllavoni, efektet mbi ekonominë do të ishin paksa më të larta, theksoi ai.

Për sa i përket sektorit të turizmit në Kroaci, ai beson se rritja e tij së shpejti mund të kalojë në stanjacion. Industria e turizmit në Kroaci prej kohësh lidhet me rajonet bregdetare me diell të Dubrovnikut, Dalmacisë, Primorjes dhe Istrias. Që nga fillimi i vitit, shifrat në turizëm treguan rritje të mëdha.

Pse nuk do të duhej të shkëmbehen territoret e as popullata?

Nga Refik HASANI



Lufta shqiptaro-serbe, asnjëherë nuk është shpallur nga asnjëra instancë nacionale, por edhe armëpushimi ende nuk është shpallur, prandaj duhet të shpallet ky armëpushim pasi deri sa mos të shpallet lufta shqiptaro-serbe e mbyllur do të vazhdoj në forma e mënyra të kohës. Sa më parë që Serbia do ta njohë Republikën e Kosovës dhe shkëmbehen ambasadorët aq më mirë do të jetë për fillimin e një epoke për „normalizimin e raporteve shqiptaro-serbe”.

Njohja e realitetit të ri nga Serbia do ta lironte vetë këtë shtetë që më së shumti është i ngarkuar nga barrierat e kaluar nga ish-ngrehina artificiale e quajtur Jugosllavi. Këto dy shtete nuk kanë nevojë për shkëmbim të territorit e as të popullatës, por të ulen në tryezën e bisedimeve dhe të njohin njëri tjetrin si shtete të barabarta. Të kërkojmë vënie e marrëdhënieve diplomatike dhe caktimin e kohës për shkëmbim të ambasadorëve. Këto bisedime, pas shpalljes pavarësisë, tani sivjet festohet një dekadë nga shpallja e Republikë së Kosovës do të jenë të nivelit të lartë dhe në nivel të komisioneve të ndryshme. Në këto bisedime do të duhej të afroreshin këto dy shtete, prandaj roli i bashkësisë ndërkombëtare është ta detyroj Serbinë që sa më parë ta njohë Republikën e Kosovës. Pas këtyre bisedimeve praktiko-tekniko, Serbia duhet ta njohë Kosovën dhe asgjë tjetër të mos kërkon faktori ndërkombëtarë, por vetëm të shkëmbehen ambasadorët. Jo shkëmbim i popullatës, ideja e shkëmbimit human të popullatës është e vjetër, prandaj edhe nuk ka rezultate dhe nuk do të realizohet. Në këtë projekt humbës do të jemi ne shqiptarët, kurse serbët do të jenë përfitues më të mëdhenj. Lëvizja e organizuar e popullatës prej një vendi përmes një marrëveshje dhe popullata do të kalojnë dhe do të bëhen banorë të një shteti tjetër. Kjo formë e shkëmbimit kolektiv asnjëherë në rrjedhat historike nuk është treguar e dobishme.

Kur marrim këto parasysh këto, nuk duhet kërkuar, përkrahur se edhe nuk do të ndodhë në mesë të shqiptarëve dhe serbëve. Faktori politik dhe ushtarak i Ndërkombëtar ka përgjegjësin dhe nuk duhet të lejon që të ndodh një shkëmbim në mesë të dy popujve më të mëdhenj të Ballkanit. Jo shkëmbim i territore-



ve sepse ne shqiptarët nuk kemi të japim territore tona, pasi komuna e Medvegjës, Bujanocit dhe Preshevë janë hapësira tona etnike. Për serbët lokal të Kosovës po ashtu do të bisedohet, por pasi këto standarde për pakicat Kosova tashmë i ka plotësuar tërësisht. Kurse Mitrovica nuk është territor i huaj, por është qytet

i trungut shqiptarë. Shkëmbim nuk duhet të kemi, pasi pjesët e trupit tonë Kombëtarë nuk jepen për pjesën tonë. Interes i reciprok i popullit shqiptar dhe atij serbë është normalizimin e raporteve.

Me këto bisedime, Serbia nëse do të fiton dhe të afrohet më afër me NATO-n duhet të pranoj Ko-

Nuk mundë të themi se Kosova dhe Serbia si dy shtete kan apo nuk kanë nevojë për shkëmbim të territorit e as të popullatës, por kemi të bëjm me dy popuj që ka kuptimin raportet Shqiptaro-Serbe. Ne Shqiptarët nuk jemi në territore të huaja, por Serbët jan në territore tona stërgjyshore-kjo është arsyeja kryesore pse nuk duhet të shkëmbehen territore e as popullata. Nuk mundë dhe nuk kemi asnjë të drejtë të japim apo shkëmbejm territorin ton që na përket neve.



sovën si shtet. Interes i dy shteteve është që të shkëmbehen ambasadorët. Kemi parasysh që Serbia shumë vështir e ka të pranoj që në Beograd të jenë dy ambasada të shteteve shqiptare, por ky është rendi dhe rregullimi i ri botëror.

Në këto bisedime duhet të shtrohet drejtë dhe me kompetencë edhe çështja e pazgjidhur e shqiptarëve të Medvegjës, Bujanocit dhe Preshevë të mbetur nënë administrimin e Serbisë. Vetëm pasi Serbia ta njohë Kosovën, atëherë do të fillon faza për një ecje në të gjitha aspektet e jetës, për dy popujt. Shkëmbim i popullatës dhe shkëmbim i territoreve nuk është kurrfarë zgjidhje, dhe do të krijonte probleme zinxhirore në tërë rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. E vetmja është që të kalohet ish-hapësira e ngrehinës së quajtur Jugosllavi të stabilizohet dhe të krijohet së paku një treg unik dhe fillohet të bashkëpunohet në shumë fusha të interesit reciprok.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 13 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 403000802272


Portale që dridhin e shkundin...

Nga Ledi Shamku



Titujt shpesh formulohen kështu: Tronditet Greqia... Alarmohen serbët..., Dridhet Beogradi..., Ngrihet në këmbë Athina..., Shkundet nga themelet historiografia botërore..., Mbeten pa gojë grekët... etj etj etj. Ti thua me vete: ç'bëri vaki? U gjet më në fund antropoidi që fliste pellazgjishtë-ilirishtë-shqip e që banonte njëherazi në Beograd, Athinë dhe Tiranë?! Në të vërtetë jo, asgjë e tillë. Ndonjë aktori i hamendësohet origjina shqiptare, ose historiografisë i është shtuar ndonjë hipotezë (po atë punë ka ajo, të hipotezohet).

Veçse këto tituj janë shenjë e keqe. Janë shenjë e një mendësie që ende nuk ka dalë nga bunkeri i vetërrethimit. Janë shenjë e një stadi ende fëminor të arsyes, dhe stadi fëminor dihet që është ego-centrik, pandeh se bota rrotullohet për të dhe rreth tij.



Këto tituj më kujtojnë një ngjarje që më pati kallxuar dikur Artan Lame: andej nga zonat e

thella të Kolonjës, në kohën e Luftës kishte inkursione ajrore. Një bari sheh një kaçator që fluturon

ulët e i tremb tufën, nxehet, mbush dyfekun edhe bamp - thes e në tokë kaçatorri me gjithë pilot italian. Fshati i bëri këngë bariut, dhe bëmën ia kallxoi gjatë e me breza. Në 1997 dogjëm vendin dhe erdhi bota të na shuante. Erdhën dhe ca ushtarakë të huaj andej nga fshati i bariut të Kolonjës. Bariu kuptohet kish rrojtur sa kish dashur, me famë e me bujë fshatçe dhe dikur kish ndërruar jetë. Por s'kish ndërruar jeta e mbyllur aty, ndaj me të parë ushtarët e huaj, ndonëse pas 60 e kusur vjetësh, dikush u zgjati kutinë e duhanit dhe i pyeti: Pa hë more djema, ç'thotë Evropi tani për bariun tonë?

Të dashura portale, qetësoni titujt. Evropi nuk dridhet as shkundet prej bariut tonë. Jemi komb me fqinjë e me kushërinj, me dashuricë e me hatërë si gjithë të tjerët. Kaq.

Me shkencën ama e kemi disi keq punën



Titujt e portaleve që u referohen lajmeve që kanë lidhje me shqiptarët, shqipen ose shqiptarinë, meritojnë një studim të vërtetë antropologjikokulturor (për të mos thënë edhe psikologjik).

Pse nuk duhet të jemi shumë krenarë me Ermal Metën?

Nga Astrit Patozi

Sanremo ka qenë një mit për Shqipërinë e para vitit 1990. Ishte pothuajse ngjarja më e rëndësishme artistike e vitit, ku shqiptarët përpiqeshin me sa mundeshin të përputhnin shijet e tyre me botën e ndaluar nga regjimi. Italia nuk ishte për ne thjesht vendi më i afërt me perëndimin, por mbi të gjitha ai që rrezatonte më shumë kulturën e vet në anët tona.

Muzika zinte një vend të rëndësishëm në këtë shkëmbim kulturor gjysëm ilegal dhe është jashtë çdo dyshimi që Sanremo ishte kulmi i kësaj marrëdhënieje vetëm me një sens. Ka pasur shumë shqiptarë në atë kohë që italishten e kanë mësuar përmes këngëve të saj.

Falë Ermal Metës, Shqipëria është sot më afër Sanremos dhe padyshim që miti është zbutur, ndoshta po aq sa edhe diferenca mes dy vendeve, që nuk është më ajo e 30 vjetëve më parë.

Por sado krenarë që të ndjehe mi sot, nuk duhet të na gënjejë mendja se kemi "pushtuar" Italinë dhe muzikën e famshme të saj.

Ermal Meta është suksesi indi-



vidual i njeriu të zot, të rritur dhe formuar në perëndim, por që mbi të gjitha ka përfituar nga hapësirat e lirisë që ai ofron, pavarësisht origjinës, racës, fesë apo bindjeve politike.

Ka pasur në të shkuarën dhe do të ketë sërish shqiptarë të tjerë që do të na lumturojnë me arritjet e tyre. E keqja është se ne kemi futbollistë të shquar, por kemi kampionatin më të shpifur dhe më të trukuar në botë. Kemi shkencëtarë të mëdhenj, deri edhe nobelistë,

por Akademinë më të atrofizuar dhe më të paralizuar të planetit.

Ne që prej sot kemi Ermal Metën, një yll të muzikës italiane, por përfytyrojeni pak atë në festivalin e Këngës në Radio Televizion, një eveniment dëshpërues, që degradon vit pas viti. Sa që mund të thuash pa frikë se sot i njëjti aktivitet është më larg Sanremos, se sa ishte në vitet 70-80.

Jam pothuajse i bindur se fati i kantautorit shqiptar, që fitoi dje festivalin më prestigjioz të muzikës

italiane, do të kishte qenë krejt tjetër, nëse nuk do të ishte larguar nga Shqipëria. E pra, është e njejta farë, por që në tokën e vet nuk e lënë të mbijë.

Ndaj edhe nuk na shkon shumë që ta urojmë Ermal Metën, pse po na nderon si shqiptarë, kur ne e turpërojmë atë me atë që i kemi bërë atdheut të tij dhe tonit.

Sepse Shqipëria sot, padyshim, që mund të mburret me Ermalin, por druaj shumë që ai mund të krenohet dot me këtë Shqipëri.



Ka pasur në të shkuarën dhe do të ketë sërish shqiptarë të tjerë që do të na lumturojnë me arritjet e tyre. E keqja është se ne kemi futbollistë të shquar, por kemi kampionatin më të shpifur dhe më të trukuar në botë. Kemi shkencëtarë të mëdhenj, deri edhe nobelistë, por Akademinë më të atrofizuar dhe më të paralizuar të planetit.

NDRYSHE ME BASHKIM MEXHITI - PROFESOR/PIKTOR

TË VIZATOSH LAVDINË E TË PARËVE TANË

Nuk mund tua përshkruaj atë ndjesi të mrekullueshme kur gjendem përpara pëlhurës së bardhë, me ide për të shkaktuar një kaos dhe më pas të arrij në një balancë qetësie, me përmbajtje dramatike, lirike, poetike..., dhe në përfundim të mbretëron lavdia dhe e bukura në pikturë...

Koha

Delvina KËRLUKU

Bashkim Mexhiti ka lindur më 16 korrik të vitit 1965, në Gostivar. Ka kryer shkollën fillore në vendlindje dhe atë të mesme teknike në vitin 1986/87 regjistrohet në Akademinë e Arteve në Prishtinë, në degën e pikturës te klasa e prof. Tahir Emrës, ku edhe diplomoi në vitin 1991. Po në të njëjtin Universitet, në vitin 1998 i kreu me sukses studimet pasdiplomike dhe mori thirrjen: Magjistër i pikturës. Prej vitit 1994 angazhohet si kuadër arsimor në Akademinë e Arteve në Tetovë dhe është njëri ndër themeluesit e Fakultetit të Arteve në Universitetin e Tetovës, ku me sukses vazhdoi të japë kontribut profesional deri në ditët tona. Në vitin 2004 avancohet dhe e merr thirrjen Docent në lëndën Akti i mbrëmjes. Pas përvojës shumëvjeçare, në vitin 2013 merr thirrjen Inordinar në po të njëjtën lëndë. Në krijimtarinë artistike ka realizuar 14 ekspozita brenda dhe jashtë vendit, ku është vlerësuar mjaft kualiteti i tij krijues nga kritika profesionale e artit. Gjithashtu, të shumta janë edhe ekspozitat kolektive, mbi 80 ekspozita ku mori pjesë, si dhe pjesëmarrje në bienale të ndryshme të artit. Bashkim Mexhiti në mënyrë aktive merret me pikturë dhe skulpturë, është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë "Draudacum". Po ashtu, ka qenë si kryetar i parë i të njëjtës shoqatë, duke dhënë kontributin e tij deri në regjistrimin e saj si shoqatë e nivelit republikan gjatë viteve 1999-2000. Është pjesëmarrës gati se në të gjitha ekspozitat dhe kolonitë e artit, të organizuara si në Maqedoni ashtu edhe

jashtë saj. Është fitues i disa çmimeve si në vitin 2004 u nderua për kontribut të veçantë në lëmin e Artit Figurativ, nga Komuna e Gostivarit. Në vitin 2009, ka arritur çmimin e parë "28 Nëntori", nga SHAFM. DRAUDACUM. Më 2011 çmimin e tretë në skulpturë "Pjetër Bogdani" nr.08-54/1, Komuna Qendër, Shkup. Po në këtë vit merr çmimin e parë në skulpturë "Josif Bageri" në bashkëpunim me piktorë të tjerë, nga Komuna Qendër, Shkup. Si dhe në vitin 2015, nderohet për Kontribut të veçantë për memorialin dhe shtatoren e heroit kombëtar "Aqif Reçani".

KOHA: Pasioni, arti, dhe talenti, lind me njeriun, por nganjëherë shpërthen si vullkan, në një moment të jetës. Si nisi karriera juaj si piktor?

MEXHITI: Pasionin e kam nxitës për sfida të reja, që më përqendron në atë çka është më e rëndësishmja në konceptin e krijimtarisë figurative konkretisht në pikturë, duke më ofruar mendime dhe ide pa gjykimet mbi reflektimin e pasqyrimin të ndjenjave shpirtërore në pëlhurë. Më ndihmon që t'i thyej qëllimet afatshkurte në pikturë, duke më inkurajuar në kërkimin dhe procesin e zhvillimit të një pikturë të ngjeshur dhe dinamike.

Sa i përket artit, kjo është një pyetje komplekse, nuk ka ndonjë definicion të prerë, kuptimi i ynë mbi artin ka ndërruar nëpër shekuj. Mendimi apo definicioni tradicional, thotë se arti është prezantim kreativ i njeriut, pavarësisht nga mënyra apo stili i tij.

Përvoja ime në pikturën abstrak-

te ekspresioniste më ka mësuar që artin ta shoh si një nga format e shprehjes së ndjenjave apo mendimeve që e preokupojnë artistin, duke rrugëtuar përmes procesit të kreativitetit shumëdimensional, me veprim që aktiviteti artistik të ketë për qëllim stimulimin e intelektit mbi prezantimin e frymës së brendshme si formë e përkryer komunikimi, duke i kaluar të gjitha barrierat gjuhësore, kohore dhe hapësinore...

Sa i përket talentit, mendoj që për tu arritur suksesi i duhur në krijimtarinë artistike nuk është i mjaftueshëm vetëm talenti. Talenti është vetëm një hap për në botën e artit, kurse lëvizjet e hapave në vazhdim me një punë të përkushtuar me pasion ndaj profesionit, me një ekuilibër dhe pavarësi garanton suksesin. Me mbarimin e studimeve në drejtimin e pikturës, në vitin 1991, në Fakultetin e Arteve Figurative pranë Universitetit të Prishtinës dhe më vonë pas kryerjes së studimeve pas diplomike me sukses në vitin 1998 te klasa e profesorit shumë të respektuar Tahir Emra në Prishtinë, fillon edhe prezantimi im i parë në frymë kreative me ekspozitë personale në pikturë.

Do të theksoja edhe se vitet 1991-1996, kanë qenë vite të vazhdimësisë së punës akademike duke punuar në portrete dhe peizazhe në frymën e realizmit.

Në vitin 1998 në hapësirat e galerisë së atëherëshme "Europe Gallery" në Gostivar, u prezantova me ekspozitën e titulluar "Figuracioni në Hapësirë", një cikël kushtuar nënqiellit tonë, kompozicione me lojë dinamike, kontraste, teksturale, simbo-

like... të gjitha të përfunduara duke i gërshetuar në kuadër të harmonisë.

Në ciklin e radhës, e bëna tërheqjen e figuracionit dhe e lashë vetëm peizazhin të pikturuar në frymë të ekspresionizmit, të ngjeshur me ngjyra pastuoze, me dominim të kolorit arkaik, ku fjalën kryesore e ka simbolika e ngjyrave e cila ka për qëllim rumbullakësimin përfundimtar të idesë mbi mesazhin e peizazhit para dashamirëve të artit pamor.

Rruga e krijimtarisë mbi peizazhin më zgjati deri në vitin 2006. Kjo periudhë e krijimtarisë më hapi shtigje të reja në të shprehurit e kreativitetit artistik në prezantimin e ndjenjave të mia për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen tonë si popull.

Nga viti 2007 fillova ciklin mbi shtresimin e periudhave kohore me përmbajtje frymëzuese nga qendra shumëshekullore e historisë të kombit tonë.

KOHA: Jeni piktor që u kanë vlerësuar, por edhe skulptor, vizatues dhe grafist i spikatur. Çfarë kanë të përbashkët dhe ku dallohen këto arte pamore, që ju i punoni?

MEXHITI: I falënderoj përzemërsisht të gjithë kritikët e artit, dekanin e Fakultetit të Arteve në Tetovë, Prof.Ord. Miftar Memeti, Prof. Dr. Hivzi Muharemi - Prishtinë, Prof. Dr. Fatmir Sulejmani, Prof. Dr. Salajdin Saliu, Prof. Dr. Metin Izetit, Prof. Dr. Mixhait Pollozhani, Prof. Dr. Jëlldës Asani, Aleksandra Zinovski-Viliq..., të gjithë kolegët dhe artdashësit, të cilët me fjalët e tyre mjeshtërore kanë bërë prezantimin dhe vlerësimin e frymës

së krijimtarisë time për çdo ekspozitë.

Të jesh artist dhe të njohësh bazën e shtyllës kryesore të figurativës - vizatimin, është kënaqësia më e madhe. Kjo është lënda kryesore në Fakultetin e Arteve, e cila jep pasaportën që artisti ta ketë si leje kalim, me të cilën lirisht mund të kalojë dhe ta ndjejë forcën dhe madhështinë e çdo drejtimi, si në pikturë, skulpturë, grafikë, apo në ndonjë lloj tjetër të artit konceptual.

Nga përvoja ime në këto drejtime, mund të them se e përbashkëta e tyre, është ajo se të gjitha këto merren me të bukurën dhe të madhërishtmen, edhe pse ato veçohen për nga natyra se në çka prezantohen. E kam fjalën si materiale bartëse se ku prezantohen si pëlhura, letra, bronzi, guri... Por, alfabeti figurativ është i përbashkët, me të cilin përshkruhen ndjenjat, emocionet, mendimet, mesazhet kreative të artistit...

Nuk mund tua përshkruaj atë ndjesi të mrekullueshme kur gjendem përpara pëlhurës së bardhë, me ide për të shkaktuar një kaos dhe më pas të arrij në një balancë qetësie, me përmbajtje dramatike, lirike, poetike..., dhe në përfundim të mbretëron lavdia dhe e bukura në pikturë. Përvoja ime në skulpturë është kryesisht modeli me argjilë. Kjo më jep kënaqësi në modelim, duke kërkuar format e duhura, vendosjen, lëvizjen, karakterin, personalitetin... Skulptura e ka ndjesinë tjetër. Për dallim nga piktura dhe grafika, ajo punohet dhe prezantohet në gurë, dru, argjil, hekur, duke na dhënë mundësinë që ta prekim, ta ndjejmë në formë, madhësi, lartësi, teksturë, me idenë se bukuria dhe madhështia e saj do të përfundojë në hapësirë të dedikuar për të.

Në vitin 2001 kam qenë pjesëmarrës në punëtorinë grafike te klasa e prof. Dimitar Milladinov në Shkup, në teknikën gjilpëra e thatë. Në kuadër të projektit tremujor, sipas programit të paraparë, arrita që të përfundoj tre vepra të ndryshme, të suksesshme. Gjatë realizimit përfundimtar të ideve në pllaka të zinkut, të cilat paraprakisht i kisha përzgjedhur dhe përgatitur në letër. Kjo përvojë e dëshmon atë që e thashë në fillim për vizatimin. Vizatimi është ajo që artistit ia heq drojën duke i dhënë kurajë për kërkime të reja, pavarësisht se me cilin lloj të artit ai do të merret. Kryesore është që kreativiteti artistik të shpërthejë dhe ta zë vendin e merituar në këtë shoqëri.

KOHA: Në veprat tuaja veçohet kontrasti i vijave dhe sipërfaqet në përgjithësi, ndërsa dritë -hija, që krijohet në "imazh", duket si dukuri e natyrës, në veçanti. Si arrini ti harmonizoni vijat dhe cili është simboli?

MEXHITI: Po, në tabllot e mia veçohet kontrasti, thyerja grafike, sipërfaqet me ngjyrat e shtruar lirshëm, tonet, shkronjat. Me një fjalë, shumë nga elementet figurative transmetojnë atmosferën e imazheve si dukuri të natyrës nëpër kohëra, të cilat janë nën kujdesin e dritës dhe hijes. Me anë të ngjyrave, si mjet ele-

likës që përfundojnë në kompozicione duke shprehur lirikën e dhimbjes dhe dashurisë.

KOHA: Keni realizuar edhe shumë skulptura, ndër të cilat shquhen shtatoret e Xhemë Hasës, Haqif Krosit, Komandant Tigris dhe Josif Bagerit. Si nisi puna e skulpturës dhe ç'flet historia e figurave të përmendura?

MEXHITI: Puna e skulpturës nisi më 2004/2005, me konkursin e hapur nga Këshilli iniciativë i fshatit Simnicë të Gostivarit për figurën e shquar të Xhemë Hasë - Gostivarit.

Pasi mu besua konkursi për realizimin e shtatoret, fillova punën rreth realizimit të veprës me lartësi prej 3.30 metra, e cila u shpalo në vitin 2006 në f. Simnicë.

Po në të njëjtin vit, 2005, u shpall edhe konkursi për Aqif Krosi - Reçani, konkurs ky që për mua ishte tepër i mirëseardhur, për arsye se pata bërë një përvojë të mirë me shtatoren e Xhemë Hasës, të cilën e kisha afruar kah përfundimi.

Ka qenë një kënaqësi mbresëlënëse kur ma thanë se e kisha fituar edhe këtë konkurs. E fillova punën pa humbur kohë, kështu që në atelienë ku punoja, u bënë dy shtatore në një hapësirë shumë të vogël. Kjo nuk ishte vetëm dëshira e madhe për të promovuar aftësitë e mia në skulpturë, ishte edhe një sfidë ndaj vetes time. Besoj fortë se kjo do të kishte qenë sfidë për çdo artist, por jo çdokush u hyn këtyre sfidave. Për shkak të problemeve me lokacionin, shtatorja e Aqif Reçanit u shpalo në vitin 2015, me lartësi prej 3.30 me bazament 2.00 metra. Në kuadër të vendit ku u vendos shtatorja, përgatita edhe projektin e plotë të memorialit, shqiponja në prapavijë e realizuar në beton me dimensione 15.00m/3.50m. Kjo përvojë e mirë në skulpturë, më hapi rrugët që lirshëm të marr pjesë në çdo konkurs që shpallehin në vend dhe jashtë vendit...

Komandant Tigri - Fadil Nimani, është shtatore me lartësi 4 m. e vendosur në Vaksincë të Komunës së Likovës, që u shpalo në vitin 2008 në bashkëpunim me kolegun Muamer Sadiku. Pas kësaj, pason konkursi i projekti "Shkupi 2014", ku morëm pjesë bashkërisht me Sadikun, duke konkurruar me tri ide zgjedhore të tre personaliteteve të shquar shqiptarë: Josif Bageri në emër të M. Sadiku, Pjetër Bogdani në emrin tim dhe Nexhat Agolli në emër të Astrit Sadiku. Nga ky konkurs arritëm të korrim sukses duke fituar vendin e parë me idenë zgjedhore të Pjetër Bogdanit. Pas tre muajsh, konkursi u përsërit dhe nga vendi i parë mua ma ndanë vendin e tretë, kurse vendin e parë na e ndanë për Josif Bagerin. Kush, dhe si u prish konkursi, le të mbetet në ndërgjegjen e tyre, gjithkush mund të harrojë, por ndërgjegjja nuk të harron.

Shtatorja e Josif Bagerit me lartësi prej 5.00 metra u vendos në një postament të rrethuar dhe të pasur me libra reliefike të bronzit, në vitin 2016.

KOHA: Si profesor, çfarë flet karriera juaj në Fakultetin e Arteve Fi-



gurative pranë Universitetit të Tetovës? Dhe, si e shihni arsimin shqip sot në krahasim me dekada më parë?

MEXHITI: Karriera ime në kuadër të fakultetit nuk flet shumë, por ia vlen të përmendi dy elemente me të cilat krenohem: e para, mburrem që jam në mesin e kolegëve me të cilët bashkërisht kontribuam në themelimin e Fakultetit të Arteve pranë Universitetit të Tetovës me Prof. Ord. Miftar Memeti, Prof. Meli Zenku, Prof. ord. Xhelil Rufati, Prof. Ord. Nafi Jashari dhe Prof. ord. Nehat Beqiri, me theks të veçantë duke i kujtuar dhe falënderuar profesorët e Prishtinës, Prof. ord Tahir Emra, Prof. Ord. Muslim Mulliqi - i ndjerë, Prof. Ord. Rexhep Ferri dhe Prof. dr. Hivzi Muharemi. E dyta, krenohem me të gjitha gjeneratat e shkëlqyera që i kemi përcjellë, si dhe me studentët që i kemi në vijim të procesit mësimor, të cilët me punën e tyre me përgjegjësi dhe ndërgjegjshëri, janë të përgatitur me cilësi të larta artistike, që sot i kemi edhe kolegë, të cilët përfaqësojnë shoqërinë e dijes dhe të artit.

Sa i përket arsimit shqip, mendoj se tekstet dhe programet shkollorë duhet plotësisht të përfaqësojnë vlerat dhe kulturën kombëtare të nxënësve shqiptarë, duhet të bëhet përmirësimi i infrastrukturës në shumë objekte shkollorë, si dhe mbështetja e plotë financiare institucioneve të arsimit të lartë në gjuhën shqipe.

KOHA: Si mendoni, artistët sot në Maqedoni përkrahen nga institucioni ku punojnë, vetë financim apo Ministria e Kulturës, për të realizuar një vepër - ekspozitë?

MEXHITI: Sa i përket kësaj pyetjeje, mendoj që së pari unë duhet të jem autokritik. Si dhe sa unë në mënyrë të rregullt i kam përcjellë konkurset? A kam konkurruar dhe

proceduralisht a i kam plotësuar kërkesat e dhëna në konkurs..?

Megjithatë, duke parë aktivitetet kulturore shqiptare në Maqedoni, si domos të vitit të kaluar 2017, ka qenë vit që u prezantua dukshëm me aktivitete galerive, teatrale, muzikore... Parë nga ky këndvështrim, fitojmë përshtypje se është gjithçka në rregull, por shtrohet pyetja se me sa mjete buxhetore ato mbulojnë. Në komunikim me kolegët e mi piktorë dhe me kolegët e drejtimeve të tjera, kuptojmë se mjetet që lëshohen nuk janë të mjaftueshme. Pra, në këtë drejtim duhet që përfaqësuesit shqiptarë nëpër komisione të Ministrisë për Kulturë, të jenë më këmbëngulës në plotësimin e kërkesave të artistëve shqiptarë dhe po i njëjti vullnet duhet të përfundojë me firmosjen e fundit nga ana e Ministrisë.

KOHA: Si e përshkruani jetën e fëmijërisë në vendlindje, dhe a është e gërshetuar ajo në veprat tuaja, si shtëpia, kopshti, fusha, malet?

MEXHITI: Fëmijëria është diçka shumë e veçantë, në vete ngërthen shumë kujtime që na bëjnë rob të nostalgjisë, qofshin ato të ëmbla ose të hidhura. Është një periudhë e jetës ku fillojmë të japim dhe t'i shfaqim afinitetet tona për diçka, afinitete që na kanë mbajtur në pafajësinë e pastër të kreativitetit fëmijëror, të cilat, ndonjëherë ndodhën që të prezantojmë ndonjë detaj nga imazhet e kujtimeve fëmijërore, bazuar nga vendlindja dhe tregimet e gjyshërve, duke i gërshetuar ato me njohuritë e fundit.

KOHA: Familja juaj është fuqia dhe dobësia e juaj?

MEXHITI: Për familjen janë të dyja, edhe fuqia edhe dobësia, që barazohet me jetën. Shkurt, familja është jeta.



mentar shprehës, të shtruar mbi sipërfaqen e pëlhurës, demonstroj temperamentin e lëvizjes gjestuale, duke arritur që të fitoj një kolorit mjaft intensive dhe me tinguj tejet lirik. Nëpërmjet lirizmit, pasqyroj raportin esencial metaforik të poetikës së formave abstrakte në pikturë, duke u hapur rrugë imazheve, të cilat janë të udhëhequra nga dimensionin shpirtëror, në ndjeshmëri të barabartë me letërsinë, muzikën simfonike, historinë... Tabllot e mia janë në kërkim të dialogut vizual midis meje dhe spektatorit. Pjesa tjetër mbetet në dorën e tij, të zbulojë kuptimin nëpërmjet këndvështrimit tim mbi përmbajtjen e pikturës.

KOHA: Arti gëzon një rrjet të gjërë studimi, përhapja dhe konservimi i gjithë trashëgimisë artistike të njeriut përgjatë historisë. Si nisi dëshira juaj për të studiuar. Nga kush u përkrahët?

MEXHITI: Vet zhvillimi historik i artit gjatë periudhave të ndryshme të cilave iu është nënshtruar, duke lënë pas vetes vepra nga fusha të ndryshme të veprimtarisë mendore dhe krijuese, shndërrohet në një thesar të njerëzimit, burim, përçues, apo urë lidhëse në mes brezave njerëzore, para dhe pas. Për tu ruajtur ky zinxhir i trashëgimisë artistike të njeriut përgjatë historisë dhe për të vazhduar në kërkim të mëturshëm të artit, janë paraparë përhapja e institucioneve të ndryshme kulturore, muzeve, fondacioneve të ndryshme për investime në kulturë, Galeri... etj. Dëshirën për të studiuar artin figurativ e kam pasur qysh si i ri, qysh në fëmijërinë e hershme vizatimin e kam pasur pasion, për këtë dhunti ndaj vizatimit çdo herë i kam pasur krahar prindërit e mi, duke m'i plotësuar kërkesat e mia për edukatën figurative. Vendimi për të studiuar drejtimin e pikturës u përkrah me shumë kë-

naqësi nga prindërit, sepse ata i kishin parasysh vërtetë e mia mbi figurativen.

KOHA: Keni ekspozuar katërbëdhjetë ekspozita personale. Këto ekspozita pasqyrojnë rrugëtimin e gjatë historik të trojeve tona nëpër kohëra, apo historinë e vetë autorit, në botën që e rrethon?

MEXHITI: Ekspozitat e mëhershme, edhe pse në motive kanë qenë të ndryshme nga kjo e fundit, por në karakter përmbajtësor të idesë së mendimit filozofik janë të ngjashme. Në kuadër të krijimtarisë sime aktive, i kam kaluar dy cikle: e para, figuracioni në hapësirë dhe e dyta peizazhi, pikturat që datojnë nga viti 2007 i takojnë ciklit të tretë, është cikli në të cilën figuracionin e kam tërhequr plotësisht. Pra, vetvetiu nga përvoja, intuïta në krijimtarinë time më kërkoi që të futem në kërkime të reja artistike kreative pa figuracione, thjeshtë vetëm shtrirje ngjyrash, në të cilën punën më të madhe për të drejtuar kahun mbi kuptimin e përmbajtjes thelbësore të mendimit do ta bëjnë elementet dhe parimet figurative. Ekspozita e fundit në QJK - Shkup ishte ekspozita e katërbëdhjetë me titull "Dimensione kohore". Nëpërmjet pikturave të kësaj ekspozite tentoj të përcjelli emocione, ndjesi, mendime, filozofi, poetikë, tregim, mesazh si dhe shpirtin e vet pikturës. Motivi etimologjik i veprave pasqyron rrugëtimin e gjatë historik të trojeve tona nëpër kohëra, qëndresa shumëshekullore të periudhave të ndryshme, hyjnizimi i gjuhës, shkrimi i lashtë si dhe lavdia e të parëve tanë... Të gjitha këto motive të lartpërmendura shtresohen në piktura abstrakte ekspresioniste me tema që bazohet në atë që shihet: ngjyra, forma, vija, shkronja, si dhe vet procesi i veprimit në pikturë ... janë nën ombrellën e simbolikës dhe flasin me gjuhën e simbo-



Presidenti Trump uron 10-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka publikuar urimin që ka marrë për dhjetëvjetorin e Pavarësisë së Kosovës, nga presidenti amerikan Donald Trump. Urimin Thaçi e mori nga ambasadori Greg Delawie, ndërsa tani e ka publikuar atë në Facebook.

Në urim Trump ka thënë se Kosova ka punë për të bërë, por ka shtuar se SHBA-ja duartroket për zhvillimin e deritashëm.

"I nderuar President: Në emër të popullit amerikan, uroj Kosovën në dhjetëvjetorin e pavarësisë së saj. Përgjatë dhjetë viteve, Kosova ka bërë hapa të mëdhenj në forcimin e sovranitetit të vet dhe demokracisë multietnike. Teksa ka punë për t'u bërë, ne duartrokasim progresin tuaj.

Teksa shteti juaj po hyn në dekadën e dytë të shtetësisë, Shtetet e Bashkuara janë të vendosura të ndihmojnë Kosovën në ndërtimin e

themelit të parimeve të përbashkëta demokratike, bashkëpunimit rajonal dhe sundimit të ligjit. Me këtë, Kosova do të bëjë hapa të mëtejshëm për hyrjen në Komunitetin Perëndimor të Kombeve.

E shohim Kosovën si partner të rëndësishëm të SHBA-së. Në këtë rast historik, i uroj më të mirën popullit të Kosovës.

Sinqerisht,
Donald J. Trump"



Në shtatë vitet e fundit (2011-2017), nga Shqipëria janë larguar në total rreth 330 mijë persona, si emigrantë, që i bie një qytet i tërë sa Fieri, ose Durrësi. Të dhënat janë bërë publike të hënën nga një grafik i INSTAT, duke treguar faktin e dhimbshëm se 28 vjet pasi u shënua vala e parë e emigrimit, shqiptarët ende duan të ikin dhe shumë pak duan të kthehen.

Që nga viti 2011 vihet re që ka pasur një rritje të shqiptarëve që braktisin vendin. Në atë vit u shënua dhe numri më i lartë i të ikurve, me rreth 52 mijë. Pasi është zvogëluar gradualisht në vite, një valë e re emigracioni u shënua sërish në 2017, në rreth 40 mijë persona të ikur. Në shtatë vitet e fundit, njerëzit që kanë ikur janë të barabartë, ose më shumë sesa numri i banorëve që ka qarku i dytë më i madh i vendit, Fieri, me 302 mijë banorë. Më pas renditet qarku i Durrësi me 285 mijë.


Emigracioni, së bashku me rënien e lindshmërisë janë arsyt kryesore që po çojnë në tkurrjen e popullsisë. Instat raportoi se më 1 janar 2008 popullsia e Shqipërisë 2018, rezultoi 2.870.324 banorë duke pësuar një rënie me 0,2% krahasuar me 1 Janar 2017.

INSTAT sqaron se Migracioni Neto (Lëvizjet e njerëzve që hyjnë dhe dalin nga vendi) është komponenti më i vështirë për t'u matur, duke qenë se Shqipëria nuk

VALA E EMIGRIMEVE NË SHTATË VITET E FUNDIT

NGA SHQIPËRIA JANË LARGUAR RRETH 330 MIJË PERSONA

Fig. 4 Emigracioni, Imigracioni dhe Migracioni Neto, 2001-2017



ka ende një regjistër popullsie. Në këtë mënyrë INSTAT thotë se përdor të dhënat më të mira 'proxy' për vlerësimin e migracionit, duke u bazuar kryesisht në të dhënat e mbledhura nga moduli i migracionit nëpërmjet anketës së forcave të punës kombinuar me koeficientet e projeksioneve të popullsisë 2011-2031. Emigracioni i trurit është duke dëmtuar rëndë edhe shërbimin shëndetësor në vend. Sipas të dhënave nga Urdhri i Mjekut, në tre vitet e fundit, e kanë lënë vendin më shumë se 600 mjekë, ku vetëm gjatë 2017 kanë kërkuar referencë largimi rreth 167 të tillë, kryesisht kardiologë, ortopedë, pediatër etj. Përgatitja e një mjeku kërkon së paku 20 vjet vetëm arsimim, ndaj zëvendësimi i tyre është i vështirë. Ndërkohë spitalet e Sarandës, Përmetit dhe Dibrës janë

pothuajse pa stafe mjekësore.

Ndryshe nga fillimi i viteve 90, problematike është ikja e forcës së kualifikuar. Forca e aftë e punës ka qenë një problem i hershëm që ka shoqëruar sipërmarrjet shqiptare por, së fundmi, bizneset e sektorit call center, shërbimeve teknologjike dhe teknologjisë së informacionit kanë nisur të ndiejnë mungesën e interesit për të punësuar edhe operatorë të thjeshtë. Lorenc Goga, administrator i Facile.it, që ofron shërbime në eëb marketing pohon se, në momente të caktuara, gjetja e disa profesioneve specifike ka qenë shumë e vështirë, jo vetëm për IT, por edhe për ekonomistë të profilit, menaxherë etj. Sipas të dhënave të Eurostat, gjatë viteve 2015-2017 kanë kërkuar azil në vendet e Bashkimit Europian 132 mijë shqiptarë, por nga ana tjetër,

mijëra të tjerë janë larguar nga vendi me kontrata pune, studime, me Lotarinë Amerikane, me aplikime për në Kanada ose po bashkohen me të afërmit e tyre, teksa emigracioni i paligjshëm po lulëzon deri në Australinë e largët.

Tjetër problem është ikja e moshave të reja, që do të sjellin probleme më vonë në forcën e punës, uljen e produktivitetit dhe skemën e pensionit. Më e keqja është se gjysma e shqiptarëve që jetojnë në Shqipëri po planifikojnë të ikin nga vendi. Sipas anketimit që ka bërë Barometri i Ballkanit, 50% e të anketuarve më 2017 janë përgjigjur se po planifikojnë të largohen nga vendi. Kjo tendencë po vjen në rritje, pasi më 2016 kishin pohuar se po merrnin në konsideratë të largoheshin nga vendi 48% e të anketuarve.

Presidenti sloven me një urim dhe mesazh për Kosovën



Presidenti sloven, Borut Pahor, u ka bërë thirrje ligjvënësve kosovarë që t'i zgjidhin të gjitha marrëveshjet përfshirë edhe ato me kufirin. Ai gjatë fjalimit të tij para deputetëve, u ka premtuar atyre se Sllovenia do të jetë gjithmonë përkrahëse e Kosovës.

"Erdha në Kosovë si mik, si president i një shteti që ka marrëdhënie të mira me shtetin e juaj. Unë erdha në prag të 10-vjetorit të pavarësisë që ne të forcojmë marrëdhëniet e mira. Pranoni urimet e mia më të sinqerta për të ardhmen e juaj të ndritur.

Sllovenët dhe kosovarët e kuptojnë sakrificën e vendeve tona drejt pavarësisë", ka thënë ai.

Ju jeni të vetëdijshëm për përkrahjen e Sllovenisë dhe timen personale për të arritur paqe për të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe në veçanti Kosovën", ka shtuar ai. Presidenti sloven ka thënë se është e rëndësishme që vendi t'i zgjidhë të gjitha mosmarrëveshjet, edhe ato me kufirin. "Unë e kuptoj kompleksitetin e kësaj çështjeje. Unë si një mik i juaj ju rekomandoj që të mos hezitoni ta miratoni marrëveshjen. Unë e di se sa është e vështirë për ju, për Parlamentin, por nuk ka mënyrë tjetër, nëse ne duam të arrijmë stabilitet në rajon", ka përfunduar ai.

VUÇIÇ NË ZAGREB "TRAZON" SERBINË DHE KROACINË

Vizita e Presidentit serb, Aleksandër Vuçiç në Kroaci me ftesë të homologes kroate, Kolinda Grabar Kitarović ka trazuar Zagrebin dhe Beogradin. Në Serbi, Aleksandër Vulin, një aleat i Vuçiçit, që mban edhe postin e ministrit të Mbrojtjes bëri një deklaratë kontraverse.

"Atje ai do të pritë nga Ustashat!", tha ai. Ustashat ishin krahu i armatosur famëkeq kroat që në Luftën e Dytë Botërore u rreshtuan në krah të nazistëve dhe konsiderohen fajtorë nga Beogradi për një

sërë krimesh edhe ndaj serbëve.

Edhe opinionin serb është i ndarë sa i takon kësaj vizite. Në mediat serbe thuhet se pas këtij "afirmiteti të sforcuar" qëndron presioni i perëndimit. Vuçiç u prit me protesta, të cilat në Sheshin e Bane Jellaçiqit u organizuan nga veteranët e luftës dhe nga të vejat e luftës Atdhetare në Kroaci. Protestuesit shpalosën transparentin me mbishkrimin "Serbia duhet të jep përgjegjësi për gjenocid dhe të paguaj dëmshpërblim". Pas takimit,

Grabar-Kitarović dhe Vuçiç mbajtën një konferencë për shtyp. Presidentja kroate tha se gjatë takimit është biseduar për shumë tema dhe çështje të hapura dhe nënvizoi se gjëja më e rëndësishme është që ajo dhe Vuçiç janë pajtuar që të vazhdojnë bisedat. Grabar-Kitarović tha se nuk është biseduar për të kaluarën e përgjakshme mes dy vendeve, por tema të tjera, përfshirë këtu edhe çështjen e përcaktimit të kufijve, me ç'rast qartësoi se nëse dy palët nuk arrijnë të paj-



tohen për kufijtë, atëherë çështja do të bartet në institucionet ndërkombëtare. Vuçiç nga ana e tij theksoi se Serbia dhe Kroacia, pa marrë parasysh se a dëshirojnë apo jo, duhet të kenë marrëdhënie më të mira në të ardhmen, duke qartësuar se dy palët kanë dallime sa i përket kufirit, por shtoi se shpre-

son se kjo çështje do të zgjidhet me dialog mes dy palëve. Ndonëse jo sa në Beograd, edhe në Zagreb kjo vizitë u prit me doza pesimiste. Mediat më të mëdha kroate janë rikthyer në vitet e luftës duke risjellë në kujtesë deklaratat e atëhershme të Vuçiçit, si një radikal anti-kroat dhe anti-shqiptar.

NË PRAG TË KONFERENCËS SË MUNIHUT

SI TË PARANDALOHET RUSIA?

“Në qoftë se ushtria ruse sulmon krahun lindor të NATO-s, aleanca nuk do të kishte asnjë mundësi për të shpëtuar nga Rusia,” njoftojnë mediat gjermane, por në të njëjtën kohë kjo ide është pranuar edhe nga kryetari i konferencës së sigurisë në Muni, Wolfgang Ischinger.

Marrëdhëniet me Rusinë dhe i ashtuquajturit “rreziku rus” do të jenë temat kryesore e Konferencës së 54-të të sigurisë së Muniut që do të mbahet më 16-18 shkurt. Rusia, ashtu si vitet e mëparshme, do të përfaqësohet nga Ministri i Jashtëm Sergei Lavrov.

Gjatë një konference shtypi të enjten e kaluar, Ischinger krahasoi raportin e forcave ruse në perëndim të vendit dhe numrin e forcave të NATO-s pranë kufijve rusë. Kryetari i konferencës së sigurisë këto i përfshiu në “Raportin e Sigurisë së Mynihut 2018”, përgatitur nga qen-



dra analitike e SHBA-së “Rand Corp”. Ky raport u botua në të përditshmen “Frankfurter Allgemeine Zeitung” nën titullin “Në një pakicë dramatike”.

Pika kryesore është “operacioni i mundshëm spontan rus në territorin e rajonit ushtarak perëndimor.” Analistët e gazetës gjermane thonë se që nga viti 2014, NATO ka batalionet e saj në Poloni dhe në shtetet baltike, si dhe brigadën amerikane prej gjithsej 32,000 ushtarëve, raporton “Vesti.net”.

Por, thuhet në të njëjtin tekst, se një ushtri e tillë nuk do të mjaftonte për të kundërshtuar një ushtri shumë më të madhe ruse, e cila në rajon ka 78,000 trupa përgjatë kufirit pa llogaritur forcat ajrore ushtarake. Sipas Ischinger, këto shi-

fra janë për reflektim. I pyetur nga “Sputnik”, sa realiste është pala ruse për të sulmuar krahun lindor të NATO-s, Ischinger u përgjigj se “nuk ka të bëjë me sulmin e parë”, por “numri është një shkak për shqetësim”. “Është një çekuilibër që nuk mund të pengojë rritjen e paqëndrueshmërisë dhe në rast të një konflikti, kjo paqëndrueshmëri do të rritet më tej.” “Pakënaqësia në rritje e Moskës shpërfillet.”

Në shkurt të vitit 2017 autorët kishin paralajmëruar se SHBA-ja mund të hiqte dorë nga roli i saj si garantues i sigurisë ndërkombëtare dhe se politika e saj e jashtme do të kishte orientim unilateral apo madje nacionalist. Këtë vit, raporti i sigurisë thotë vetëm se: SHBA-ja po tërhiqet nga roli i saj udhëhe-

qës. Ajo tregon pak interes në ndërtimin e institucioneve rajonale apo globale që vendosin rregulla për formësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Megjithatë, siç njofton DW, raporti diagnostikon qasje për një konvergencë të mbrojtjes evropiane. Në fund të fundit 25 shtetet kanë vendosur të koordinojnë politikën e tyre të sigurisë dhe mbrojtjes të BE-së brenda të ashtuquajturit Bashkëpunimi i Përherëshëm Strukturor (PESCO). Franca dhe Gjermania dëshirojnë të zhvillojnë së bashku brezin e ardhshme të avionëve luftarakë. Dhe me presidentin e Francës Emmanuel Macron, ideja e një ushtrie të përbashkët evropiane ka fituar një mbështetës të fuqishëm.



Erdogan kërcënon ushtarakisht Greqinë

Presidenti turk Erdogan ka kërcënuar me ndërhyrje ushtarake edhe ndaj Greqisë pas sulmit të ushtrisë turke në Siri.

Duke folur në mbledhjen e Grupit Parlamentar të partisë, Erdogan tha se nuk do të qendrojë duarkryq ndaj kërkimeve që Greqia ka nisur për gaz në detin Egje, shkruan Hurriyet.

“Trimëria e këtyre shkon deri sa të shohin anijet tona ushtarake. Duhet të dinë se zona në detin Egje është po aq e rëndësishme për ne sa ç’është edhe operacioni ushtarak që po kryejmë tani në Afrin të Sirisë. Anijet tona ushtarake dhe avionët tanë do të bëjnë atë që ia kërkon detyra nëse nevojitet”, tha Erdogan duke marrë duartrokitjet e sallës. Greqia dhe Turqia janë në një konflikt të vazhdueshëm për ishujt në Egje, sipas të cilëve përcaktohet edhe zona ekonomike e secilit shtet.

Pajtimi i dy koreve

Rivendosja e marrëdhënieve të afërta diplomatike mes dy Koreve gjatë Olimpiadës Dimërore vijon të jetë në qendër të vëmendjes, teksa lideri verior Kim Jong-un ka vlerësuar “përpjekjet e sinqerta dhe mbresëlënëse” të Jugut në mikpritjen e delegacionit në qytetin e Pyeongyang. Suksesi i vizitës treditore të delegacionit në Olimpiadë ka rikonfirmuar rëndësinë e nxitjes së “një klime të ngrohtë pajtimi dhe dialogu” mes dy palëve, raportohet të ketë thënë lideri Kim sipas medias shtetërore KCNA. Kujtojmë se presidenti koreano-jugor Moon Jae-in mori një ftesë zyrtare për të vizituar Penianin në kuadër të një takimi me liderin Kim Jong-un. Që prej ardhjes në pushtet, presidenti ka inkurajuar gjetjen e një zgjidhjeje diplomatike për krizën

në gadishullin korean. Ndërkohë, Seuli zyrtar duket se do të vijojë me planet për ribashkimin e familjeve të ndara gjatë luftës koreane, për të mbështetur dialogun që nxit vizita e delegacionit verior, raporton ora news. Përpjekjet për të shtuar ndërveprimin mes Koreve duket se kanë edhe mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, pasi një çtensionim i situatës në gadishull mund të sjellë edhe në një dialog mes Penianit dhe Uashingtonit. Megjithatë, zyrtarët amerikanë gjithashtu kanë deklaruar se duhen shtuar sanksionet ndërkombëtare, në mënyrë që Koreja e Veriut të heqë dorë nga programi bërthamor. Vitin e kaluar, vendi i izoluar kreu dhjetëra testime raketash dhe testin e gjashtë bërthamor në kundërshtim me rezolutat e Kombeve të Bashkuara.



SHBA me buxhet kolosal për ushtrinë

Zyrtarë të Pentagonit thanë se sfida kryesore për sigurinë dhe prosperitetin e SHBA-së nuk është më terrorizmi, por konkurrenca mes fuqive të mëdha.

Pentagoni kërkon një rritje të ndjeshme të shpenzimeve ushtarake në vitin 2019, duke cituar për këtë pretendim të tijin rreziqet nga Kina, Rusia dhe Koreja e Veriut. Krerët ushtarakë amerikanë këmbëngulin se vendi i nevojitet një arsenal i përforcuar, e për këtë pretendohet nga Kongresi aproviimi i një buxheti në nivelin e 686 miliardë dollarëve, një prej më të mëdhenjve në historinë e Shteteve të Bashkuara.

Projektbuxheti i Administratës “Trump” parashikon në të njëjtën kohë shkurtime të ndjeshme për diplomacinë ndërkombëtare dhe ndihmat përtej kufijve.

Vet Trump deklaroi të hënën se ushtria e Shteteve të Bashkuara do të jetë më e fuqishme nga sa ka



qenë ndonjëherë, e kjo përfshin – sipas tij, – rritjen praktikisht të arsenalit të çdo arme.

“Gara e madhe e fuqisë, dhe jo terrorizmi, ka dalë sot në pah si sfida kryesore ndaj sigurisë dhe prosperitetit të Amerikës”, deklaroi nënkryetari i Mbrojtjes, David L. Norquist.

“Është gjithmonë e më e qartë, – shtoi ai, – se Kina dhe Rusia dëshirojnë të formojnë një botë, e cila të përputhet me modelin e tyre autoritar të fitores së vetos mbi vendimet ekonomike, diplomatike dhe të sigurisë së vendeve të tjera”, thuhet në dokumentin e buxhetit, ku theksohet se Pekini është duke përdorur politika eko-

nomike grabitqare për të frikësuar fqinjët, ndërsa po militarizon tiparet e detit të Kinës Jugore.

Dokumenti i buxhetit të propozuar thotë se është gjithnjë e më e qartë që Rusia dhe Kina duan të krijojnë një botë sipas modelit të tyre autoritar, duke marrë kontrollin e vendimeve ekonomike, diplomatike dhe të sigurisë të vendeve të tjera, diçka që nuk duhet lejuar. Buxheti i propozuar parashikon raketa, avionë dhe anije të reja që do t’i shtohen ushtrisë, ndërsa Presidenti Trump e justifikoi këtë rritje ushtarake me faktin se SHBA është e detyruar, pasi edhe të tjerët po bëjnë të njëjtën gjë.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015, 27/2016) dhe nenit 5, 7, 8 dhe 9 të Marrëveshjes kolektive të SHA TEC Negotino, në pronësi të shtetit, Negotinë, në lidhje me Vendimin për nevojën për themelimin të marrëdhënies së punës nr. 04-126/1 të datës 13 .02.2018

SHA për prodhim të energjisë elektrike TEC Negotino, Negotinë publikon SHPALLJE PUBLIKE

Për nevojën e themelimit të marrëdhënies së punës në SHA TEC Negotino, Negotinë për realizimin e punëve për kohë të pacaktuar, për vendet e punës në vijim:

- 1 (një) realizues praktikant për vendin e punës **“Zjarrfikës rojtar”** në Departamentin MMJ.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III/IV e arsimit, arsim i mesëm në profesion/arsim i mesëm.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 20.258 denarë.

- 1 (një) realizues praktikant për vendin e punës **“Drejtues i elektro komandës”**, në Prodhim.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla IV e arsimit, shkolla elektroteknike.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 31.032 denarë.

- 1 (një) realizues për vendin e punës **“Ndihmës drejtues i koltës filluese”**, në Prodhim.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III e arsimit, arsim i mesëm në profesion/metales, 1 vjet përvojë pune.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 22.130 denarë.

- 1 (një) realizues praktikant për vendin e punës **“Inxhinier për elektrikë”**, në Prodhim.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla VII/1 e arsimit, Fakulteti elektroteknik.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 39.113 denarë.

- 1 (një) realizues praktikant për vendin e punës **“Inxhinier për procese kimike”**, në Prodhim.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla VII/1 e arsimit, Fakulteti kimik/teknologjik.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 35.599 denarë.

- 2 (dy) realizues praktikant për vendin e punës **“Drejtues i stacionit për ujërat e zeza”** në Prodhim.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III/IV e arsimit, arsim i mesëm në profesion/arsim i mesëm.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 22.483 denarë.

- 1 (një) realizues për vendin e punës **“Ndihmës saldues”**, në Mirëmbajtje të makinerisë.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III e arsimit, arsim i mesëm në profesion/bravapunues.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 20.609 denarë.

- 1 (një) realizues praktikant për vendin e punës **“Punëtor i bravave”**, në Mirëmbajtje të makinerisë.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III/IV e arsimit, arsim i mesëm në profesion – bravapunues/shkolla e makinerisë.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 20.609 denarë.

- 1 (një) realizues praktikant për vendin e punës **“Montues elektrikist”**, në Mirëmbajtje elektrike.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla IV e arsimit, Shkolla elektroteknike.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 20.609 denarë.

- 2 (dy) realizues praktikant për vendin e punës **“Automatizient grupi 2”** në Mirëmbajtje, Rregullim dhe matje.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III/IV e arsimit arsim i mesëm në profesion /shkolla elektroteknike.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 24.239 denarë.

- 1 (një) realizues për vendin e punës **“Vozitës të kategorisë D”**, në Shërbimin për çështje juridike dhe të përgjithshme.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla II/III e arsimit, 1 vjet përvojë pune.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 26.698 denarë.

- 1 (një) realizues praktikant për vendin e punës **“Referent për ISO Standarde”**, në Shërbimin për çështje juridike dhe të përgjithshme.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla IV e arsimit.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 22.718 denarë.

- 1 (një) realizues praktikant për vendin e punës **“Referent për ekologji”**, në Shërbimin për çështje juridike dhe të përgjithshme.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla IV e arsimit.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 22.718 denarë.

- 1 (një) realizues praktikant për vendin e punës **“Inxhinier për ekologji”**, në Shërbimin për çështje juridike dhe të përgjithshme.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla VII/1 e arsimit, Fakulteti për menaxhim të resurseve ekologjike.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 31.149 denarë.

- 1 (një) realizues praktikant për vendin e punës **“Referent për plan dhe analizë”**, në Shërbimin financiar.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla VII/1 e arsimit, Fakulteti ekonomik.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 31.383 denarë.

- 1 (një) realizues praktikant për vendin e punës **“Konter”**, në Shërbimin financiar.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla IV e arsimit, Shkolla ekonomike.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 23.88 denarë.

- 1 (një) realizues për vendin e punës **“Punëtor i përgjithshëm”**, në Shërbimin për çështje juridike dhe të përgjithshme.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: arsim fillor.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 16.861 denarë.

- 1 (një) realizues për vendin e punës **“Ekonomist për furnizime publike”**, në Shërbimin financiar.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla VII/1 e arsimit, Fakulteti ekonomik.

Shuma në të holla e pagesës fillestare është 32.086 denarë.

Java e punës zgjatë 5 ditë pune, prej ditës së hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, ndërsa gjatë ditës së punës është 8 orë edhe atë prej ora 07:00 deri në ora 15:00.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Së bashku me fletëparaqitjen (fletëparaqitje të shkruar me dorë) ku theksohet se për cilin vend pune konkurrohet, kandidatët të parashtrojnë:

- Dëshmi për arsimin e mesëm (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Dëshmi për përvojën e punës (listë nga SPIM);
- Certifikatë të shtetësisë (kopje);
- Biografi të shkurtë në gjuhën maqedonase;
- Kontakt telefon dhe
- Dëshmi të tjera për kushtet e posaçme për vendin e punës për të cilin konkurrohet.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të parashtruara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve pas kalimit të afatit për shpallje.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentet e nevojshme, prej ku shihet se kandidati i përmbushë kushtet e përgjithshme dhe të posaçme, të parashtrohen në adresën:

SHA TEC Negotino, F. P. 95, f. Dubrovë, Negotinë (me shenjë “për shpallje publike”).

SHA TEC NEGOTINO



Në bazë të nenit 54, 63, 64, 125, 127, 131, 132, 133, 134, 135 dhe 142 të Ligjit për arsim sipëror, nenit 3 paragrafi 1 të Ligjit për të punësuarit në Sektorin publik, dhe nenit 22 paragrafi 3 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune

UNIVERSITETI “GOCE DELLÇEV” – SHTP
Publikon
KONKURS

Për zgjedhjen e mësimdhënësve të njësive në kuadër të Universitetit

1. **FAKULTETI FILOLOGJIK**
 - 1.1 Mësimdhënës në titull titullar Docent titullar për sferën mësimore-shkencore:

-Letërsia maqedonase dhe letërsia jugosllave e mesjetës - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet
 - 1.2 Mësimdhënës në titull titullar Docent titullar për sferën mësimore-shkencore:

-Letërsia maqedonase shek. XIV / Letërsia maqedonase shek. XX - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet
 - 1.3 Mësimdhënës në titull titullar Docent titullar për sferën mësimore-shkencore:

-Pedagogji - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet
2. **FAKULTETI I BUJQËSISË**
 - 2.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:

-Fiziologjia e bimëve - (1 realizues) për kohë prej shtatë vjet
 - 2.2 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:

-Gjenetika dhe përzgjedhja e prodhimtarisë bimëre - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet
3. **AKADEMIA MUZIKORE**
 - 3.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:

-Këndimi vokal - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet
 - 3.2 Mësimdhënës në titull titullar Docent titullar për sferën mësimore-shkencore:

-Llojet e instrumenteve – Kanon dhe Makami - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet
 - 3.3 Mësimdhënës në titull titullar Docent titullar për sferën mësimore-shkencore:

-Llojet e instrumenteve – Klarinetë (vegla muzikore) dhe Improvizimi - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

Kriteret për zgjedhje:

- Për docent mund të zgjedhjet personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore në të cilën zgjidhet, sukses mesatar prej së paku tetë në studimet e ciklit të parë dhe të dytë për secilin cikël veç e veç, së paku katër punime shkencore-hulumtuese të publikuara në sferën përkatëse në revistat shkencore ndërkombëtare ose publikime shkencore ndërkombëtare ose dy punime shkencore në revistë shkencore me impakt faktor në pesë vitet e fundit, pjesëmarrje në projekte shkencore-hulumtuese, gjeçësisht arritje të theksuara në aplikimin e rezultateve hulumtuese, kontribut në aftësimin e mësimdhënësve të rinj dhe i cili ka treguar aftësi për realizimin e llojeve të veçanta të veprimtarisë për arsim sipëror dhe notë pozitive nga vetëevaluari. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të caktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit “Goce Dellçev” – Shkup.

-Për profesor me korrespondencë mund të zgjedhjet personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore në të cilën zgjidhet, së paku pesë punime shkencore-hulumtuese të publikuara në sferën përkatëse në revistat shkencore ndërkombëtare ose publikime shkencore ndërkombëtare ose tre punime shkencore në revistë shkencore me impakt faktor në pesë vitet e fundit, pjesëmarrje në projekte shkencore-hulumtuese, gjeçësisht arritje të theksuara në aplikimin e rezultateve hulumtuese, kontribut në aftësimin e mësimdhënësve të rinj dhe i cili ka treguar aftësi për realizimin e llojeve të veçanta të veprimtarisë për arsim sipëror dhe notë pozitive nga vetëevaluari. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të caktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit “Goce Dellçev” – Shkup.

marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit “Goce Dellçev” – Shkup.

-Për zgjedhje të sërishëm për profesor të rregullit mund të zgjedhjet personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore në të cilën zgjidhet, së paku gjashtë punime shkencore-hulumtuese të publikuara në sferën përkatëse në revistat shkencore ndërkombëtare ose publikime shkencore ndërkombëtare ose katër punime shkencore-hulumtuese dhe ka dhënë kontribut në aftësimin e mësimdhënësve të rinj dhe i cili ka treguar aftësi për realizimin e llojeve të veçanta të veprimtarisë për arsim sipëror dhe notë pozitive nga vetëevaluari. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të caktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit “Goce Dellçev” – Shkup.

-Shkencëtarët e afirmuar, profesionistët e praktikës dhe artistët të institucionit për arsim sipëror, të cilët i plotësojnë kushtet për zgjedhje në titull, ndërsa për të cilin nuk ka vend të lirë për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor, gjeçësisht mësimdhënës mund të zgjidhen në titullin docent titullar dhe profesor titullar me korrespondencë, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin për arsim sipëror. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit “Goce Dellçev” – Shkup.

-Për docent, profesor me korrespondencë dhe profesor të rregullit të lëndët profesionale-artistike mund të zgjidhet edhe personi i cili nuk ka shkallë doktor i shkencave, i cili ka të mbaruar arsim të lartë përkatës nga shkalla e dytë, vepra të pranuar artistike dhe profesionale gjeçësisht arritje të cilat janë të rëndësishme për afirmimin e kulturës dhe artit në dhjetë vjetet e fundit dhe aftësi për punë mësimore. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të caktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit “Goce Dellçev” – Shkup.

- Orari i kohës së punës dhe pagesa: - Orari ditor i punës prej 08:30h, deri 16:30h. - Orari javor i punës – 40 orë punë (prej ditës së hënë deri në ditën e premte) - Neto paga themelore për Docent -38.143,00 den.; Profesor me korrespondencë - 43.660,00 den.; Profesor i rregullit - 50.311,00 den; Docent titullar - 700, 00 den./orë; Dokumentet e nevojshme për kandidatët për zgjedhje në titujt mësimor, mësimor – shkencor: - fletëparaqitje; - diplomë për arsim të mbaruar përkatës – për punim të mbrojtur të magistraturës/doktoraturës (një kopje të diplomës në original dhe tre kopje të vërtetuara në noter, diplomat e huaja të jenë të nostrifikuara dhe të plotësuar me ekuivalencë të notave); - certifikatë për provimet e dhëna të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve - biografi të shkurtë (në katër kopje); - listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale - nga një kopje të punimeve - vërtetim se në një prej gjuhëve të huaja - rekomandim prej së paku 2 (dy) profesorëve (me korrespondencë/rregullit) nga sfera përkatëse shkencore për të cilin bëhet zgjedhja - për kandidatët për docent; - rekomandim nga punëdhënësi paraparak (nëse kandidati ka qenë i punësuar) - për kandidatët për zgjedhje docent; - një kopje të punimit të magistraturës/doktoratës; - certifikatë të shtetësisë;

Konkursi zgjatë 8 ditë pune nga dita e publikimit. Zgjedhja do të realizohet në afatin e parapara në nenin 131 të Ligjit për arsim sipëror (deri në 6 muaj nga publikimi i konkursit). Dokumentet të dorëzohen në arkivin e: 1. Fakulteti filologjik – r. “Zheleznicica” pn, Shtip, tel. 032-550-180; 2. Fakulteti i bujqësisë – r. “Goce Dellçev” nr. 89, Shtip 032 550-600; 3. Akademia muzikore – r. “Cvetan Dimov” pn, Shtip, tel. 032-550-200 Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren parasysh

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, nenit 74 të Statutit të SHFK “Krstë P. Misirkov” Radovish ndërsa në pajtim me nenin 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor si dhe Vendimit për publikim të shpalljes, U. D Drejtori i shkollës publikon

SHPALLJE
Për plotësimin e vendeve të punës në vijim:

1. Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase, me 18 orë mësimore në javë, pagesa prej 16.000,00 denarë;
2. Një mësimdhënës të mësimi klabor për mësimin në gjuhën turke, në SHP f. Koxhalla, me orar të plotë të punës, zëvendësim të mësimdhënësit me marrëdhënie të punës në pushim, pagesa prej 19.917,00 denarë;
3. Një bibliotekist, me orar të plotë të punës, pagesa prej 19.917,00 denarë;
4. Një defektolog, me orar të plotë të punës, pagesa prej 19.917,00 denarë;

Shkolla punon me dy ndërrime edhe atë: ndërrimi i parë prej ora 7,00 deri në ora 13,00 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13,00 deri në ora 19,00.

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e parapara me nenin 77 dhe 80 të Ligjit për arsim fillor. Përveç fletëparaqitjes kandidatët duhet të parashtrojnë: certifikatë – diplomë për arsimin e mbaruar përkatës, certifikatë të shtetësisë.

Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit dhe të pakompletuara sipas shpalljes, nuk do të jenë lëndë shqyrtimi. Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditror. Dokumentet e nevojshme parashtrohen në arkivin e shkollës. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve pas përfundimit të shpalljes.

SHFK “Krstë P. Misirkov” – Radovish, U. D Drejtor, Stojanova Olgica

Në bazë të statutit të “Lëvizjes Besa” si akt më i lartë, në bazë të nenit 10 të statutit, kryetari i partisë politike “Lëvizja Besa” në përputhje me autorizimet që dalin nga neni 45 i statutit, më datë 01.12.2017 solli këtë

VENDIM

Vula me formë të rumbullakët me tekst në gjuhën shqipe dhe maqedonase – “Lëvizja Besa” – Shkup, “Движење Беса” – Скопје, me emblemën (logon) e Lëvizjes dhe vula me formë të drejtkëndëshit me tekst në gjuhën shqipe dhe maqedonase “Lëvizja Besa” – Shkup, “Движење Беса” – Скопје, shpallen për të pavlefshme dhe të njëjtat vendosen jashtë përdorimit nga data 01.12.2017.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Ky vendim të publikohet në Gazetën Zyrtare të RM

P. P “Lëvizja Besa”
Kryetar,
Bilall Kasami

Shkup, 01.12.2017

MUNGESA E SHQIPTARËVE NË KRIJIMTARINË SERBE

Historia e marrëdhënieve serbo-shqiptare është e pazakontë, shkruante të shtunën e përditshmja e Beogradit, "Politika". Me asnjë popull nuk kemi jetuar bashkë më gjatë, e aq pak jemi njohur. Çështje e vërteta letërsia dhe shkencat tona, shkruan ajo, nuk janë marrë shumë as me popujt e tjerë fqinj, transmeton Koha.net pjesë nga një shkrim më i gjatë të kësaj gazete

"Dhe ta them, ty serb, nuk është e vështirë të afrosh me ta, ashtu siç mendon ti; por vetëm njih veten dhe ata, pastaj puno, me zemër dhe vullnet, dhe aty do të gjesh vëllanë dhe shokun, aq të dashur; dhe me fare pak shpenzime, sa vetë do të habitesh sa lehtë do të shkojë. E di, ti serb do të më thuash: kur qenka kështu, pse këtë mësim prej tyre nuk e morën gjermanët ose italianët, ose ndonjë mbretëri tjetër që merret me këtë? Por ta dish se secilës fuqi i vjen më shumë mundim ta bëjë këtë dhe të shoqërohen me ta, sesa ty, or serb! Sepse ti nuk je fuqi, por si një moshatar i tij, prandaj shoqërohu e afrohu me ta... Kurse fuqitë nuk dinë ta bëjnë



këtë, por me hapin e parë të punës së tyre me ta duan të tregojnë forcën e madhësinë, dhe t'i bëjnë fatlumë në krahët e vet, me bukurinë dhe civilizimin e pafund... Puno vëlla serb me shqiptarët dhe bëhesh mik me ta! Trokit në dyert e tyre dhe do të hapen! Puno me besnikëri dhe pa hile! Mos shpresë në ngutësinë tënde as në modestinë e tyre se do të mund t'i mashtosh!" (Mark Milani). Jeta dhe zakonet e shqiptarëve). Të shtunën mbushen dhjetë vjet nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, vazhdon shkrimi në "Politika", transmeton Koha.net. Si bëhet që serbët dhe shqiptarët të mos gjejnë mënyrën për të bashkëpunuar si "moshatarë", por i lanë fuqitë e mëdha t'i bëjnë të lumtura me "bukurinë dhe civilizimin e pafund", siç e kishte thënë me ironi vojvoda e Kuçit (Mark Milani)?

Historia e marrëdhënieve serbo-shqiptare është e pazakontë. Me asnjë popull nuk

kemi jetuar bashkë aq gjatë dhe aq pak jemi njohur. Çështje e vërteta, letërsia dhe shkencat tona nuk janë marrë shumë as me fqinjët tanë të tjerë. Po të mos ishin shkrimtarët nga viset perëndimore nga Matavuli e pastaj Koçiqi, Andriqi, Qopiçi, Selimoviçi e Mirko Kovaç, ne as në traditën tonë thuaja nuk do të kishim figura letrare kroatësh e boshnjakësh. Ndërsa ata janë vëllezër tanë për nga gjuha beshmesh të tjera. Fqinjët tanë nga Panonia janë përshkruar më mirë se shqiptarët (Tishma, Kish, Pekiç) në saj të traditës multikulturale të Vojvodinës. Por mungojnë bullgarët të ngjashëm me ne. Por, as në shkencat çështja është shumë më mirë. Të pakta janë librat që flasin për jugosllavët tanë, e lëre më për fqinjët e tjerë. Thuajse kemi jetuar të vetëm në ishull dhe jo të përzier me të gjithë këta fqinj, shkruan ndër të tjera "Politika" e Beogradit, transmeton Koha.net.

Si asnjëherë më parë, tre shqiptarë në Eurovizion



Si asnjëherë më parë, tre këngëtarë shqiptarë do të shkojnë në kompetitionin Evropian të këngës, Eurovizion.

Eugent Bushpepa do të përfaqësojë Shqipërinë në Lisbonë, pasi triumfoi në festivalin e 56-të të RTSH-së me këngën "Mall". Sipas sondazheve të fundit kënga "Mall", kryeson listën si më e preferuara e fansave me 25 për qind të votave, shkruan gazeta

Shekulli. Ndërkohë, Italia do të përfaqësohet nga këngëtari me origjinë shqiptare Ermal Meta, i cili solli një himn kundër terrorizmit në këngën "S'më keni bërë asgjë".

E treta në listë është një tjetër këngëtare me origjinë nga Fieri, Eleni Foureria, e cila përfaqëson shtetin e Qipros në këtë kompetition. Ajo do të përfaqësohet me këngën "Zjarr".

Prezantohen portretet zyrtare të çiftit Obama

Galeria Kombëtare e Portreteve në Washington ka prezantuar portretet zyrtare të ish-Presidentit Barak Obama dhe bashkëshortes së tij, Michelle Obama.

Obama zgjodhi si autor të portretit të tij piktorin e diplomuar në Universitetin Yale, Kehinde Wiley, i njohur për portretet e gjalla të afrikano-amerikanëve.

"Ju falënderoj të gjithëve që keni ardhur. Unë dhe Michelle jemi shumë mirënjohës për miqtë dhe të afërmit që kemi, si dhe për personelin që ka punuar me mua në Shtëpinë e Bardhë dhe që

kanë zgjedhur të na nderojnë në këtë formë e të na ofrojnë mundësinë të jemi në prani të këtij arti të mrekullueshëm", iu drejtua presidenti të pranishmëve në muze.

Në portret ish-Presidenti Obama është i ulur në karrige mes gjeteve. Autori thotë se përdori elementë botanikë për të simbolizuar rrugëtimin e tij. Ai ka përdorur lule nga shteti Illinois dhe nga Kenia, për të pasqyruar rrënjët e ish-presidentit. Kehinde Wiley është piktori i parë afrikano-amerikan që zgjidhet për të pikturuar një portret zyrtar presidencial.

Michelle Obama zgjodhi artisten nga Baltimora, Amy Sherald, e njohur për punime që stilistikisht përqendrohen tek format dhe kontrastet e ngjyrave, si dhe të frymëzuara nga temat e drejtësisë sociale. Në portret ajo është e veshur me një fustan me forma gjeometrike, e ulur para një sfondi një-ngjyrësh. "Po mendoj tani për ato vajza të vogla afrikano-amerikane, që gjatë viteve do të vijin këtu dhe do të shohin dikë që ngjet me ta në muret e këtij institucioni të madh amerikan", tha Obama./VoA



EFEKTET E NJË NISME KULTURORE Mbi një mijë libra iu dhuruan Preshevës

Nisma "Një Libër më shumë për Preshevën", e ndërmarrë nga një grup studentësh, ka tejkaluar objektivin e saj minimal brenda një harku të shkurtër kohor. Në një kohë që ende nuk është mbushur një muaj nga nisja e fushatës, grupi nismëtar i këtij projekti bëri të ditur se deri më tani janë grumbulluar mbi 1 mijë libra kulturor-artistikë në shqip, çka ishte edhe kufiri i objektivit të vendosur që në fillim të kësaj nisme nga studentët e masterit shkencor "Marrëdhënie me Publikun", në Kolegjin Universitar "Bedër", njofton KosovaLive. Pavarësisht se objektivi fillestar i fushatës, e cila duhet të mbyllet me një aktivitet në Preshevë në fillim të muajit mars, tashmë është tejkaluar, ky sukses na ka ndihmuar të shohim drejt dimensioneve të reja për t'a shtrirë mesazhin e kësaj nisme studentore edhe më shumë, u shpreh drejtuesja e fushatës Arjola Buzi, e cila konfirmoi se falë mbështetjes personale të Zv. Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Shpati Kolgega ka nisur tashmë prezantimi i nismës edhe tek institucionet arsimore në vend, sidomos në Tiranë. Nismës "Një Libër më shumë për Preshevën" i janë bashkuar personazhe të rëndësishme të jetës publike në Shqipëri dhe jashtë trojeve, ndërsa individë, shtëpi botuese dhe biznese kanë ndihmuar grupin e studentëve që të mbledhin një numër të konsiderueshëm librash, mjetesh mësimore dhe shuma monetare, në ndihmë të fëmijëve dhe mësuesve shqiptarë në Luginën e Presheës, teksa bibliotekat e shkollave në këto zona kanë mangësi të theksuara të teksteve shqip.

Me derbin e madh ndërmjet Shkëndijës dhe Vardarit, dhe katër përballjeve tjera, sot (e mërkurë) fillon sezoni pranveror në Ligën e parë futbollistike të Maqedonisë. Me fitore eventuale, kuqezinjtë do ti afroreshin edhe më shumë titullit të dytë në historinë e saj

LIGA E PARË, FILLON SEZONI PRANVEROR

ME FITORE NDAJ VARDARIT, SHKËNDIJA ZGJEDH SHUMË DILEMA



Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 13 shkurt - Lideri aktual, KF Shkëndija gjendet para një mundësie të mirë që me fitore eventuale ndaj konkurrentit të vetëm për titull Vardarit, të rrit epërsinë nga tetë në 11-të dhe ti ofrohet edhe më shumë titullit të dytë në historinë e saj. Do të jetë pra ky derbi i javës së 19-të, ku stadiumi i qytetit në Tetovë pritet të jetë i mbushur, derisa ata më të flaktit "Ballistët" premtajn spektakël. Kuqezinjtë përballjen ndaj rivalit të saj e presin me optimizëm duke thënë se janë të gatshëm për fillimin e sezonit pranveror dhe rrugëtimin e tyre drejt titullit të dytë. "Përgatitjet cilësore dhe epërsia në pikë na jep shpresë për të besuar se titulli do të jetë i Shkëndijës. Fati apo fatkeqësia jonë ishte që ndeshjen e parë ta luajmë me Vardarin dhe ne do dalim të japim më të mirën për të fituar ndeshjen", tha trajneri i kuqezinjve Qatip Osmani. Derisa, për kapitenin Hasani me rëndësi është që brenda grupit të futbollistëve të ruhet qetësia dhe harmonia, pasi kjo skuadër ka dë-

shmuar se pa eufori është e gatshme për rezultate të mëdha. "Favorit nuk kemi qenë vitet e kaluara kur dihen shumë rrethana që na kanë përcjell. Favorit jemi këtë vit dhe ne do dalim ta dëshmojmë këtë në fushë si që e kemi bërë deri tani këtë sezon. Ndeshja e parë është si krejt tjerat dhe ne pa eufori hyjmë të bëjmë punën tonë që është fitorja", shprehet kapiteni Hasani. Ndërkohë, Osmani dhe Hasani kanë potencuar se mbështetja nga publiku do të jetë e rëndësishme kapitale në çdo sfidë pranverore dhe për këtë arsye presin përkrahje që

nga takimi i parë me Vardarin që do të zhvillohet të mërkurën në Tetovë me fillim në orën 14:00.

Ndryshe, në këtë orë dhe në po të njëjtën ditë, në program do të jenë edhe katër përballje tjera. Veçohet përballja në stadiumin "Boris Trajkovski" ku në cilësinë e nikoqirit FC Shkupi do të pret Akademija Pandevin. Një Shkup me shumë ndryshime në afatin kalimtar të janarit, konsiderohet favorit për tre pikët, por për të arritur këtë, lojtarët duhet ta arrijnë në fushën e gjelbër. "Duke filluar nga përgatitjet që zhvilluam në Antalë dhe

me zhvillimin e ndeshjeve kontroluese treguam se jemi maksimalisht të përgatitur dhe shpresoj që në ndeshjen e parë sezonale ndaj Akademija Pandevin të fitojmë tri pikë, pasi të gjithë jemi të përgatitur maksimalisht. Mendoj edhe lojtarët e rinj të cilët janë afruar gjatë afatit kalimtar do të japin maksimumin e tyre, ata janë pritur mjaft mirë nga të gjithë dhe besoj që së bashku të arrijmë synimet që ka klubi këtë sezon", deklaroi Benjamin Shabani.

Ndërkohë, Renova, e cila gjithashtu gjatë afatit kalimtar të janarit

JAVA E 19-TË, TAKOHEN:

SHKUPI - A. PANDEV
SHKËNDIJA - VARDARI
POBEDA - PELISTERI
RABOTNIČKI - RENOVA
SILEKSI-SKOPJE

u përforcua me disa lojtar kualitativ, shpreson ta fillon me këmbë të mbarë sezonin, përkundër faktit se para vetes do të kenë skuadrën cilësore siç është Rabotnički. Në përballjet tjera, Pobeda do të pret Pelisterin, kurse Sileksi në Kratovë do të pret Skopjen.

Nexhipi e sjell Tipuriçin te FC Shkupi

Shkup, 13 shkurt - Afati kalimtar i dimrit në Maqedoni përfundoi të hënën në mbrëmje, ndërsa në ditën e fundit të këtij afati, FC Shkupi arriti që në radhët e saja të sjell mbrojtësin me prejardhje nga Bosnja e Hercegovina Toni Tipuriç. Ndryshe ky transferim u realizua falë agjencisë "N11 Sports Management", e cila udhëhiqet nga ish-futbollisti Armend Nexhipi. Për gazetën KOHA, Nexhipi rrëfen se si është realizuar ky transferim. "Drejtuesit e klubit që moti ishin në kërkim të një mbrojtësi. Unë si drejtues i agjencisë "N11 Sports Management" dhe në bashkëpunim me agjencinë tjetër "SEE Sport Management" e cila udhëhiqet nga ish-futbollisti i njohur i Kroacisë Dado Përsho dhe Dean Jurçiq, ua propozova disa emra, në mesin e të cilëve ishte edhe Toni Tipuriç. Falë CV-së dhe klubeve ku futbollisti boshnjak kishte luajtur, drejtuesit e klubit nga Çairi e zgjodhën pikërisht atë dhe pas disa bisedimeve që i kishim, arritëm që në ditën e fundit të afatit kalimtar të dimrit, të njëjtin ta zyrtarizojmë si futbollist i ri i FC



Armend Nexhipi

"N11 Sports Management" dhe në bashkëpunim me agjencinë tjetër "SEE Sport Management" e cila udhëhiqet nga ish-futbollisti i njohur i Kroacisë Dado Përsho, ua propozova disa emra, në mesin e të cilëve ishte edhe Toni Tipuriç. Falë CV-së dhe klubeve ku futbollisti boshnjak kishte luajtur, drejtuesit e klubit nga Çairi e zgjodhën pikërisht atë dhe pas disa bisedimeve që i kishim, arritëm që në ditën e fundit të afatit kalimtar të dimrit, të njëjtin ta zyrtarizojmë si futbollist i ri i FC Shkupi

Shkupi", shprehet për KOHA, Nexhipi. Ai thotë se është i kënaqur që ky transferim u realizua, derisa zbuloi edhe disa detaje për agjencinë e tij "N11 Sports Management". "Jemi të kënaqur me transferimin e Toni Tipuriç te FC Shkupi, pasi bëhet fjalë për një lojtar kualitativ, i cili ka eksperiencë të madhe. Shpresojmë se ai do të dëshmojë kualitetin që posedon, ndërsa e mira e kësaj është se tani ne posedojmë gjysmën e kartonit të tij. Sa i përket agjencisë "N11 Sports Management", selia qendrore është në Zvicër dhe udhëhiqet nga menaxheri Jeton Kaba, ndërsa kemi selinë tonë në Tiranë dhe Shkup. Ndërkohë, aktualisht menaxhojmë 16 lojtarë nga Maqedonia, Kosova dhe Shqipëria dhe shpresojmë se ky numër do të rritet në të ardhmen edhe më shumë", përfundoi Nexhipi. Cekim, gjatë karrierës së tij profesionale, Armend Nexhipi i cili është vëllai i ish-futbollistit të mirënjohur Nderim Nexhipi, ka luajtur për skuadrat si Slloga Jugomagnat (tani FC Shkupi), Slavia Praga dhe Bohemians.



The United Nations Development Programme partners with people at all levels of society to help build nations that can withstand crisis, and drive and sustain the kind of growth that improves the quality of life for everyone. On the ground in 177 countries and territories, we offer global perspective and local insight to help empower lives and build resilient nations.



VACANCY ANNOUNCEMENT

The Office of the United Nations Development Programme (UNDP) is seeking motivated and creative professionals for the position of Project manager/Project specialist positions of the "Improving local governance" project.

Project manager/Project specialist positions

Under the direct supervision of Programme Officer of the Governance Unit the Project manager/Project specialist will be responsible for the following:

- Lead/support project management to deliver planned results and proper budget expenditure;
- Provide substantive expertise and advice on local government issues, including decentralization;
- Coordinate project activities with other initiatives in governance and across the UNDP program;
- Build constructive partnerships with representatives of the ministries, municipalities, regional bodies, local communities and civil society organizations that are involved in project activities;
- Maintain regular communication with donors and provide top-quality reports as required; and
- Contribute to aligning the project with UN values, including gender equality and human rights.

Required education: University degree in Public or Business Administration, Law, Economics, Social Sciences or other relevant field. A Master's degree is a strong asset.

Required professional experience: A minimum of 6 years of relevant professional experience in development projects, 4 years for candidates with a Master's degree; Demonstrated experience in management of complex projects, programme/project coordination and monitoring and/or provision of advisory services or similar; Demonstrated experience on projects with a focus on improving governance at the local level; Demonstrated experience in liaising and co-operating with government officials, municipal authorities, academic institutions, NGOs and the private sector; Excellent communications, report writing and analytical skills.

Language Requirements: Language proficiency in both written and oral English and Macedonian.

Duty station: Skopje

Interested candidates should submit their applications on-line, through the UNDP Website www.undp.org.mk. The deadline for submission of applications is **26 February 2018**. For further requirements, detailed Terms of Reference please visit UNDP Website www.undp.org.mk Applications received after the closing deadline will not be considered. No telephone calls please. Only short-listed candidates will be contacted.

Zyra e Kombeve të Bashkuara programi për zhvillim (UNDP) publikon pozitën e lartpërmendur.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune të RM ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/2015) dhe nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 103/2008 dhe 33/2010) SHF "Sv. Kliment Ohridski" – Manastir publikon

SHPALLJE

për pranimit të realizuesve në vijim për vitin shkollor 2017/2018:

1. Mësimdhënës të mesimit klasor - 1 realizues për kohë të caktuar dhe orar të plotë të punës si zëvendësues të UD Drejtor – me pagesë fillestare - 20.745,00 – më së voni deri më 31.08.2018;
2. Mësimdhënës të edukatës muzikore - 1 realizues për kohë të caktuar dhe me orar jo të plotë të punës për 10 orë mësimore – me pagesë fillestare - 10.571,00 – më së voni deri më 31.08.2018;
3. Mësimdhënës të projekteve të edukatës muzikore – 1 realizues për kohë të caktuar dhe me orar jo të plotë të punës për 10 orë mësimore – me pagesë fillestare - 10.571,00 – më së voni deri më 31.08.2018;
4. Mësimdhënës të arsimi teknik – 1 realizues për kohë të caktuar dhe me orar jo të plotë të punës për 2 orë mësimore – me pagesë fillestare - 2.090,00 – më së voni deri më 31.08.2018;
5. Mësimdhënës për projekte zgjedhore të arsimi teknik - 1 realizues për kohë të caktuar dhe me orar jo të plotë të punës për 6 orë mësimore – me pagesë fillestare - 6.288,00 – më së voni deri më 31.08.2018;
6. Mësimdhënës për projektet e artit figurativ - 1 realizues për kohë të caktuar dhe me orar jo të plotë të punës për 10 orë mësimore – me pagesë fillestare - 10.571,00 – më së voni deri më 31.08.2018;
7. Mësimdhënës të etikës së religjioneve - 1 realizues për kohë të caktuar dhe me orar jo të plotë të punës për 10 orë mësimore – me pagesë fillestare - 10.571,00 – më së voni deri më 31.08.2018;
8. Mësimdhënës të gjuhës frënge - 1 realizues për kohë të caktuar dhe me orar jo të plotë të punës për 4 orë mësimore – me pagesë fillestare - 4.181,00 – më së voni deri më 31.08.2018;
9. Mësimdhënës të hulumtimit të vendlindjes - 1 realizues për kohë të caktuar dhe me orar jo të plotë të punës për 12 orë mësimore – me pagesë fillestare - 12.593,00 – më së voni deri më 31.08.2018;
10. Mirëmbajtës të higjienës - 2 realizues për kohë të caktuar të punës dhe orar të plotë të punës – me pagesë fillestare 12.678,00 dhe orari i punës 5:00-13:00 ndërrimi i parë dhe prej 12:00 -20:00 ndërrimi i dytë;

Orari i punës së mësimdhënësve është me dy ndërrime prej ora 7.30 ndërrimi i parë dhe prej 13.30 ndërrimi i dytë, ndërsa përfundon me përfundimin e orëve në pajtim me Programin vjetor për punë të shkollës.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Për mësimdhënësit kushtet e parapara me nenin 80, 81 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor;
- Për mirëmbajtësin e higjienës arsim fillor të mbaruar.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit.

Testi për njohje të gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik do të mbahet më datë 23.02.2018 në ora 12 - tel. 047/252-733 Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve duke konsideruar nga dita e përfundimit të shpalljes.

Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen deri në SHF "Sv. Kliment Ohridski" – Manastir, rr. Dimçe Liahçanski" pn.

SHF "Sv. Kliment Ohridski" – Manastir

Në bazë të nenit 22,23 dhe 26 të Ligjit për marrëdhënie pune Gaz. Zyrtare e RM-s me nr, 167/2015 dhe pëlqimit dhe pasqyrës nga MASH nr. 17-279/1 e dt. 31.01.2018, SH F „Gjergj Kastrioti Skënderbeu “ f, Sërbicë , komuna e Kërçovës, publikon :

SHPALLJE PUBLIKE

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në kohë të pacaktuar

1. Një Mirëmbajtës I Higjienës,
2. Një Arkëtarë.

Kandidatët e interesuar duhet ti plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara sipas Ligjit për marrëdhënie pune. dhe Ligji për arsim fillor

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Dokumentet duhet adresuar në SH F" Gjergj Kastrioti Skenderbeu " në f. Sërbicë, Komuna e Kërçovës.

f. Sërbicë,13.02.2018

SH F " Gjergj Kastrioti Skenderbeu"

f. Sërbicë , Komuna e Kërçovës

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 16/10), nenit 80, 82 dhe 84 të Ligjit për arsim fillor të RM (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10,18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17) dhe Pëlqimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me nr. 12-11446/2 të datës 07.12.2017, 12-333/2 të datës 18.01.2018, 12-1043/1 të datës 29.01.2018 dhe Vendimit të drejtorit të SHF "Goce Dellçev" Manastir nr. 02-57 të datës 13.02.2018 prej më datë 13.02.2018 publikon:

SHPALLJE

Për pranimit të punëtorëve për kohë të caktuar deri në fund të vitit shkollor 2017/2018:

A)

1. Një mësimdhënës të gjuhës gjermane me 12 (dymbëdhjetë) orë mësimore, pagesa 12.384,00 den;
 2. Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase me 3 (tre) orë mësimore, pagesa 3.096,00 den;
 3. Një mësimdhënës të gjuhës dhe kulturës vlllehe me 4 (katër) orë mësimore, pagesa 4.128,00 den;
 4. Një mësimdhënës të fizikës me 12 (dymbëdhjetë) orë mësimore, pagesa 12.384,00 den;
 5. Një mësimdhënës të shkencave natyrore me 8 (tetë) orë mësimore, pagesa 8.256,00 den;
 6. Një mësimdhënës të arsimi qytetar me 6 (gjashtë) orë mësimore, pagesa 6.192,00 den;
 7. Një mësimdhënës të etikës së religjioneve me 6 (gjashtë) orë mësimore, pagesa 6.192,00 den;
 8. Një mësimdhënës të biologjisë me 16 (gjashtëmbëdhjetë) orë mësimore, pagesa 16.512,00 den, - deri në kthim të mësimdhënësit nga pushimi i lindjes por jo më vonë se deri më 31.08.2018.
 9. Një mësimdhënës të shkencave natyrore me 4 (katër) orë mësimore, pagesa 4.128,00 den; -- deri në kthim të mësimdhënësit nga pushimi i lindjes por jo më vonë se deri më 31.08.2018.
 10. Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase me 20 (njëzet) orë mësimore, pagesa 20.641,00 den;
 11. Një mësimdhënës të mesimit klasor me 20 (njëzet) orë mësimore, pagesa 20.641,00 - deri në kthim të mësimdhënësit nga pushimi i lindjes por jo më vonë se deri më 31.08.2018.
 12. Një bibliotekist me orar të plotë të punës, pagesa 20.641,00 den; - deri në kthim nga pushimi i lindjes por jo më vonë se deri më 31.08.2018.
- B) Për mesimin në gjuhën shqipe:
1. Një mësimdhënës të gjuhës angleze me 11 (njëmbëdhjetë) orë mësimore, pagesa 11.352,00 den;
 2. Një mësimdhënës të gjuhës gjermane me 16 (gjashtëmbëdhjetë) orë mësimore, pagesa 16.512,00 den;
 3. Një mësimdhënës të matematikës me 20 (njëzet) orë mësimore, pagesa 20.641,00 den;
 4. Një mësimdhënës të fizikës me 8 (tetë) orë mësimore, pagesa 8.256,00 den;
 5. Një mësimdhënës të shkencave natyrore me 4 (katër) orë mësimore, pagesa 4.128,00 den;
 6. Një mësimdhënës të shkencave natyrore me 2 (dy) orë mësimore, pagesa 2.064,00 den;
 7. Një mësimdhënës të historisë me 16 (gjashtëmbëdhjetë) orë mësimore, pagesa 16.512,00 den;
 8. Një mësimdhënës të arsimi qytetar me 4 (katër) orë mësimore, pagesa 4.128,00 den;
- C) Punëtorët administrativ – juridik, profesional dhe ndihmës-teknik:
1. Një psikolog me orar të plotë të punës, pagesa 20.641,00 den;
 2. Një mirëmbajtës të higjienës me orar të plotë të punës, pagesa 12.000,00 den;
 3. Një mirëmbajtës të higjienës me orar të plotë të punës, pagesa 12.000,00 den
- Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligji, kandidatët nën A dhe B duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në pajtim me nenin 80 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 i Ligjit për arsim fillor, kandidatët nën C – pika 1 të kenë të mbaruar fakultetin filozofik (instituti për psikologji), kandidatët nën C – pika 2 dhe 3 të kenë të mbaruar arsimin fillor.
- Kontrollimi i njohurive për gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik dhe të gjuhës shqipe dhe alfabetin e saj më datë 23.02.2018 me fillim në ora 9,00, gjeqësisht ora 10,00.
- Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit, ndërsa zgjedhja do të realizohet më së voni në afat prej 20 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes. Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen në adresën e shkollës.
- Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

SHF "Goce Dellçev" Manastir
Vienska nr. 13

Në bazë të nenit 22, paragrafi (1), pika (1) dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 167/2015), Lajmërimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-1041/1 të datës 29.01.2018 dhe Pëlqimit të Ministrisë së financave nr. 12-11025/7 të datës 25.12.2017, drejtori i SHMNQSH "Zdravko Cvetkovski" – Shkup, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të personelit teknik për kohë të pacaktuar të punës në bazë të financimit të vjetër

PUBLIKOHET, shpallje publike për punësim të kuadrin teknik për kohë të pacaktuar të punës – financim i vjetër për vendet e punës në vijim:

1. Mirëmbajtës të higjienës – 5 (pesë) realizues 40 orë pune me arsim fillor dhe të mesëm të mbaruar, me neto pagesë prej 12.000,00 denarë
2. Punëtor i përgjithshëm mirëmbajtës – 1 (një) realizues 40 orë pune me arsim fillor dhe të mesëm të mbaruar, me neto pagesë prej 12.000,00 denarë

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përcaktuara në dispozitat e Ligjit për marrëdhënie pune dhe Ligjit për arsim të mesëm edhe atë:

-të kenë arsim përkatës për nevojat e vendit të punës;

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrijnë dokumentet në vijim:

-Diplomë ose Certifikatë për arsim përkatës të mbaruar;

- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.

Orari i punës është për ndarë në pesë ditë pune prej ditës së hënë deri ditën e premte, në pajtim me Orarin për vitin shkollor 2017/2018. Orari ditor i punës mbahet me dy ndërrime edhe atë: ndërrimi i parë prej ora 06:30 deri më 14:30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 12:00 deri në ora 20:00.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 30 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje në lidhje me shpalljen.

Dokumentet e nevojshme të parashtrihen deri në SHMNGJ të Qytetit të Shkupit "Zdravko Cvetkovski" – Shkup, bulevardi "Partizanski Odredi" nr. 91, 1000 Shkup, përmes postës rekomanduese ose postës së shpejtë ose në arkivin e shkollës. Dokumentet e pakompletuara, të parregulluara dhe të dorëzuara pas afatit do të refuzohen dhe nuk do të shqyrtohen nga ana e Komisionit.

Kontakt personi për shpalljen publike është Verica Hristovska, kontakt telefoni 02/3062-694 dhe kontakt e-mail adresa kontakt@zdravkocvetkovski.edu.mk

SHMNGJSH "Zdravko Cvetkovski" – Shkup

DREJTOR,
Dragica Kostadinovska

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të LMP (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015) dhe nenit 77, 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08), SHF "Dr. Trifun Panovski" – Manastir, publikon:

SHPALLJE

Për plotësimin e vendeve të punës në vijim

- Një pedagog me orar të plotë të punës, për kohë të caktuar të punës me pagesë bazë prej 18.987 denarë
- Një mësimdhënës të Etikës së religjioneve me 4 orë mësimore, për kohë të caktuar të punës me pagesë bazë prej 4.551 denarë.
- Një mësimdhënës të Shkencave natyrore me 6 orë mësimore, për kohë të caktuar të punës me pagesë bazë prej 6.201 denarë
- Një mirëmbajtës të higjienës me gjysmë orari të punës në shkollën periferike SHP "Dr. Trifun Panovski" f. Dihovë për kohë të pacaktuar të punës me pagesë prej 6.000 denarë.

Orari i punës së pedagogut është prej ora 07 deri në ora 15.

Orari i punës së mirëmbajtësit të higjienës në f. Dihovë është prej ora 07 deri në ora 11.

Orari i punës së mësimdhënësve është me dy ndërrime. Ndërrimi i parë është prej ora 07:30, ndërrimi i dytë është prej ora 13:30 përfundon me përfundimin e orëve në pajtim me Programin vjetor të shkollës.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme për mësimdhënës në pajtim me Ligjin për arsim fillor, pedagogu të ketë të mbaruar arsimin sipëror ndërsa mirëmbajtësi i higjienës të ketë të mbaruar arsimin fillor.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet më së voni në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

Kontrollimi i njohjes së gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik do të realizohet më datë 22.02.2018 në ora 11 në lokalet e shkollës.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen në adresën SHF "Dr. Trifun Panovski", rruga Ohridska nr. 50, Manastir, telefoni 075/263-878

Në bazë të Nenit 22 dhe 23 të Ligji për Marrëdhënie të Punës (Fleta zyrtare e R. M nr. 74/15 Tekst i pastruar) SHFK" Bashkimi" – Gostivar shpall:

SHPALLJE PUBLIKE për plotësimin e vendeve të punës në kohë të pacaktuar

1. Katër Mirëmbajtës të higjienës me kohë të plotë pune 40 orë
- Orari i punës është nga ora 06:00-10:00 dhe 17:00-21:00
Vlera e rrogës themelore është 12.000,00 denarë

Kushtet e veçanta:

- Të ketë të kryer arsimin fillor
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

Dokumentet e nevojshme:

- lutje
- dëftesë (diplomë) në original ose të verifikuar në noter,
- certifikatë e shtetësisë

- vërtetim se nuk është i dënuar jo më i vjetër se 6 muaj

Shpallja zgjat 5 ditë pune nga dita e publikimit. Përzgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të realizohet në afat prej 5 ditë pune nga dita e mbarimit të shpalljes së publikuar.

Lutjet me dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri të SHFK" Bashkimi" – Gostivar, rr. Pançe Poposki nr. 35, personi për kontakt 078 – 356-917

Dokumentet e pa kompletuara nuk do të merren parasysh.

U.D DREJTOR
VLERA FIDANI

KARAMOH, TALENTI QË RIKTHEU INTERIN TE FITORJA PAS DY MUAJSH

Jo vetëm, pasi shënoi edhe gol, një finalizimin që i dhuroi Spaletit suksesin e parë pas dy muajsh. Ishte ai protagonist i "San Siros" në rikthimin e Interit te fitorja në kampionat pas një serie prej gjashtë barazimesh dhe dy humbjesh

Shpejtësi, driblim, dhe aftësi për të ndryshuar ritmin e garës. Në këtë mënyrë u prezantua Karamoh te tifozët në mbërritjen e tij te Interi në fundin e merkatos së verës së shkuar. 19 vjeçari francez me origjinë nga Bregu i Fildishtë në debutimin e tij si titullar në kampionat duket se e mbajti fjalën. Jo vetëm, pasi shënoi edhe gol, një finalizimin që i dhuroi Spaletit suksesin e parë pas dy muajsh. Ishte ai protagonist i "San Siros" në rikthimin e Interit te fitorja në kampionat pas një serie prej gjashtë barazimesh dhe dy humbjesh. Karamoh ishte pikërisht ai që u duhej zikaltërve, shpërthimin e befashëm, shpejtësinë



për të kaluar kundërshtarin, i duhej gjallëria e tij një Interin që po vuan momentin negativ të Borja Valeros dhe Perishiq, apo zhdukja nga radarët e Brozoviç, që tani po bën të flitet më shumë për të për nervozizmin. Karamoh zgjidhi ndeshjen, por për t'u mbajtur shënim në rizgjimin e Interit edhe Rafinja që hyri në fushë 13-të minuta pas nisjes së pjesës së dytë në vend të Brozoviç të vërshtëllë nga tifozët, duke i dhuruar një marsh më shumë lojës së Interit.

Prania e brazilianit ndihet, është ai që gjen Karamoh për golin e 2-1. Interi ka nevojë për intuitën dhe teknikën e tij, ndërsa një notë tjetër pozitive është ajo për Eder, në golin e dytë radhazi si titullar në mungesë të kapitenit Ikardi. Goli i tij është më i shpejti i realizuar nga Interi në Serinë A që nga shkurti i 2007 kur shënonte Adriano pas 43 sekondash. Spaleti e rinis nga kjo fitore garën për të siguruar një vend që e çon në Çampions.

Raiola synon ta transferojë Donnarumman te PSZH-ja

Agjenti i njohur i futbollistëve, Mino Raiola është gati të transferojë portierin e Milanit, Cjanluigji Donnarumman në Paris Sen-Zhermen këtë verë. Portieri i talentuar italian ishte afër largimit nga "San Siro" në verën e vitit të kaluar, por në fund u arrit një marrëveshje dhe u nënshkrua një kontratë e re. Në kontratën e re thuhet se ekziston një marrëveshje që në rast dështimi që Milani të kualifikohet në Ligën e Kampionëve për sezonin e ardhshëm atëherë Donnarumma mund të largohet për një klauzolë të vendosur. Por, e ardhmja e portierit të Milanit mbetet ende e turbullt në mes të kërkesave të Raiolas, i cili kërkon të anulojë kontratën e tij lidhur me pretendimet që u nënshkrua nën detyrim verën e kaluar. Sipas mediumit italian "Calciomercato.com", Raiola është në kontakt të vazhdueshëm me gjigantin francez, PSZH, dhe favorizon dërgimin e Donnarummas në Paris në fund të sezonit. Donnarumma kërkohet gjithashtu nga Bayern Munihi dhe Real



Madridi, por Raiola do të preferonte që klienti i tij i talentuar të shkojë në PSZH. Nga ana e tyre, PSZH janë në treg për një numër 1 të ri, ku drejtori sportiv Antero Henrikue inkurajohet të gjejë një portier të ri që ai të nënshkruhet nga presidenti Nasser Al-Khelaifi për sezonin e ardhshëm. Çmimi i portierit italian në rast largimi nga Rossonerët mendohet të jetë së paku 50 milionë euro.

Brozoviç do të dënohet nga Interi

Interi po kalon në një periudhë jo të mirë të rezultateve dhe nga kjo janë krijuar probleme tjera. Një nga lojtarët që po turbullon ujërat te klubi zikaltër është Marcelo Brozoviç. Kroati në momentin kur u zëvendësua në fitoren ndaj Bolonjës ai duartrokiti tifozët e klubit nga Milano me ironi. Kjo pasi ata paraprkishte e fishkëllyen për sjellje jo të mirë një ndeshje më herët dhe për mos angazhimin në fushë. Sipas "Gazzetta dello Sport", ashtu si trajneri Luçiano Spaleti edhe klubi i Interit nuk iu ka pëlqyer aspak gjesti i mesfushorit. Ata kanë kërkuar që Brozoviç të dënohet dhe t'i kërkojë falje publike tifozëve. Kjo kërkesë ka ardhur nga pronarët e "Suning Group" të cilët dëshirojnë të ndërtojnë një grup të respektueshëm.

Nuk ka asnjë kuptim ta shesim De Gean

Trajneri i Manchester Junajtdit ka përjashtuar shitjen e portierit David De Gea te Real Madridi, duke deklaruar se një marrëveshje e tillë nuk ka asnjë kuptim. Reprerentuesi spanjoll ka qenë prej kohësh i lidhur me një lëvizje te kampionët evropianë dhe spanjollë. Një marrëveshje në gusht të vitit 2015 ishte shumë afër, por dështoi në orën e fundit shkaku i faksit. Megjithatë, fjalët që e lidhin me Realin nuk janë ndalur asnjëherë dhe këtë vit veçse janë shtuar. Trajneri i Junajtdit, Murinjo ka reaguar ndaj këtyre fjalëve duke e përjashtuar

shitjen e De Geas, pasi sipas tij nuk do të kishte sens. "A mendoni se një klub që po përpiqet të tërheqë lojtarët më të mirë është një klub që është i hapur për të shitur lojtarët e tyre më të mirë?", ka thënë Murinjo për "PA Sport" kur u pyet për interesin potencial të Madridit në De Gean. "Kjo nuk ka kuptim. Nëse doni të shkoni në atë nivel, ne duhet të tërheqim lojtarët më të mirë siç kemi bërë me Aleksis, Nemanja Matić, Paul Pogba dhe kështu me radhë, dhe mos lejojmë lojtarët tanë më të mirë të shkojnë", përfundoi portugezi. Marrëveshja aktuale e



De Gea në "Old Trafford" shkon deri në qershor të vitit 2019 me klubin që thuhet se po punon për zgjatjen e kontratës deri në vitin 2023.

LAIMI SHKURT

Arsenali mendon për Enriken

Jo vetëm Çellsit, pasi për Luis Enriken ish trajnerin e Barcelonës interesohet edhe Arsenal. Trajneri asturian i cili ka qëndruar pushim gjatë këtij viti pas tre sezoneve fantastikë me Barcelonën, shikohet nga drejtuesit e Arsenalit si pasuesi ideal i Arsen Venger, i cili edhe pse ka kontratë me topçinjtë e Londrës deri në 2019-ën mund të largohet gjatë kësaj vere nëse skuadra nuk arrin të sigurojë kualifikimin në Ligën e Kampionëve për sezonin e ardhshëm. Pas 22 viteve në stolin e Arsenalit, Venger mund të përshpejtojë largimin e tij nga "Emirates Stadium", për ti hapur dyert spanjollit Luis Enrike, i cili preferohet edhe nga presidenti i Çellsit, Roman Abramoviç.

Alderveireld nuk dëshiron të rinovojë me Totenhemin

Verën e ardhshme te Real Madridi pritet të ketë ndryshime të mëdha në skuadër dhe një prej reparteve që do të ketë prurje të reja është mbrojtja. Drejtuesit e klubit janë hedhur në sulm për Toby Alderveireld, i cili ka kontratë deri në vitin 2019 me Totenhemin dhe nuk ka ndërmend të rinovojë me londinezët. Klubi ka të drejtën e zgjatjes së kontratës edhe për një sezon, të cilën dëshiron ta ushtrojë, por ky fakt nuk do të ndalë Realin e Madridit për të bërë një ofertë prej 40 milionë eurosh në verë që të marrë shërbimet e mbrojtësit belg.

Vatzkes i ofrohet zgjatja e kontratës

Një nga pikat më të forta të Borussia të Dortmundit është Joakim Vatzke, i cili drejton politikën e klubit që prej vitit 2005. Siç shkruajnë mediat gjermane, Shefi Ekzekutiv i verdhezinjve ka kontratë deri në vitin 2019 me klubin, por presidenti Reinhard Rauball ka ndërmend t'ia rinovojë atë për dy sezone të tjera. Vetë Vatzke deklaroi se është i gatshëm të bisedojë me presidentin e klubit, duke konfirmuar kështu edhe dëshirën për të vazhduar punën e tij si numri 1 në menaxhimin e politikave të Borussia të Dortmundit.

Herrera pëlqehet nga Milani

Milani ka një objektiv të ri për merkaton. Sipas mediave italiane, shoqëria kuqezi ka hedhur sytë nga Hektor Herrera i Portës. Mesfushori 28-vjeçar meksikan është vëzhguar nga afër edhe Napoli, por për të së fundmi ka nisur të interesohet edhe Milani, që ka dërguar përfaqësuesit e tij për ta parë nga afër në takimin e Çampionsit ndaj Liverpoolit, e cila zhvillohet sonte. Çmimi i kartonit të Herreras është shumë i lartë, madje në kontratë me Porton ka një klauzolë largimi 40 milionë euro. Gjithsesi, drejtuesit e Milanit, pasi të binden për cilësitë e tij, pritet të bëjnë një ofertë konkurre, që sigurisht do të jetë më e ulët.

LIGA E KAMPIONËVE

REAL-PSZH, PËRBALLJA MES DY PRETENDENTËVE PËR TROFEUN E ÇAMPIONS

Skuadra e Paris Sen-Zhermenit sot (e mërkurë) do të vizitojë Real Madridin në "Santiago Bernabeu" në takimin e parë të vlefshëm për një vend në çerekfinalen e Ligës së kampionëve. Një përballje mes dy prej skuadrave pretendente për fitimin e këtij trofeu

Reali i Madridit ka fituar dy edicionet e fundit të Çampions, por këtë sezon po zhgënjë në La Liga dhe kjo ka vënë në dyshim edhe rrugëtimin e tyre në Evropë. Por, për trajnerin Zinedin Zidan asgjë nuk është e pamundur, madje ai është optimist për kalimin e turit, duke deklaruar se ka një ekip të fortë. "E kam gati formacionin me të cilin do të luajë ndaj PSZH-së. Nuk kam asnjë dyshim", tha Zidan. Krejt ndryshe nga kolegu i tij Unai Emery, që tha se ka shumë dyshime për këtë sfidë. "Të gjithë janë gati për të luajtur të mërkurën në Çampions, por unë nuk do të zbuloj asgjë deri para fillimit të takimit. Të gjithë janë gati për luftë dhe kjo është e rëndësishme, pasi duam të tregojmë se kush jemi, pavarësisht rezultateve jo fort të mira këtë sezon", deklaroi trajneri francez. Në anën tjetër, në sezonin 2012-2013, parisienët u kualifikuan në Ligën e Kampionëve, për herë të parë, pas shtatë sezoneve. Që atëherë, ata gjithmonë kanë shkuar deri në çerekfinale, përveç sezonit të kaluar, kur u rrë-



zuan në raundin e dytë kundër Barcelonës. Nëse Real Madridi luan sezonin në këtë ndeshje, në Francë thuhet se PSZH-ja luan një pjesë të madhe të projektit. Derisa, Neymar, emblema e madhe e klubit, nuk ka frikë nga sfida. "E di që ne kemi potencial për të bërë një edicion të shkëlqyer në Ligën e Kampionëve. Ky kompeticion është shumë i rëndësishëm në historinë e një klubi, edhe për një lojtar. Unë kam ardhur këtu për këtë trofe, për të hyrë në histori, për të bërë më të mirën me PSZH-në. Ne shpresojmë për një lojë të mrekullueshme, Madridi na moti-

von maksimalisht", pohon Neymar. Edhe pse janë të shumtë ata që mendojnë se PSZH është favorite, trajneri Unai Emery ka kujtuar se madrilenët kanë shumë lojtarë që janë vendimtarë në momentet e rëndësishme. "Real Madridi është skuadra më e mirë në botë, për sa i takon trofeve të fituar dhe se kanë lojtarët më të mirë", ka thënë ai në konferencë për shtyp. "Kristiano Ronaldo është një shembull. Lojtarët e mëdhenj i tregojnë vlerat e tyre në ndeshjet e mëdha. Ata kanë lojtarë të tillë, ashtu si ne", tha Emery. Ndryshe, ish-lojtari i Realit dhe tani i PSZH, Angel Di Maria ka paralajmëruar "Los Blancos" duke thënë se Parisi është më

i fortë se një vit më parë. "Jemi më të fortë se sezonin e kaluar", shprehet argentinasi për faqen zyrtare të klubit parisien. "Të duhet më shumë se talent në ndeshje të tilla. Duhet edhe pak fat për të fituar. Reali është një ekip i madh dhe gjithmonë paraqitet mirë në Çampions Ligë.

Ata nuk luajnë për të kontrolluar topin, ndeshjet ndaj Real Madrid janë shumë të vështira për të kontrolluar topin. Çelësi është të luajmë lojën tonë, ashtu siç kemi luajtur gjatë gjithë sezonit. Duhet të jemi të fokusuar në mbrojtje pasi ata mund të të ndëshkojnë në çdo moment. Është një kompeticion komplet ndryshe nga kampionati", deklaroi Di Maria. Ndërkohë, në përballjen tjetër, e cila është nën hije të përballjes në "Bernabeu", Porto do të pret skuadrën e Liverpoolit.



Sidoqoftë, në Paris ka pasiguri. Një sondazh i opinionit nga "Odoxa" për RTL tregon mosbesimin e francezëve te PSZH-ja. Vetëm 36 për qind e shohin ekipin parisien në çerekfinale të Çampionsit. Ky studim, i kryer mes të mërkurës, 7 shkurt, dhe të enjtes, 8 shkurt, me një "mostër" prej 982 personash, që përfaqësonin popullsinë franceze mbi 18 vjeç, përfshinte 371 tifozë të futbollit.

Për ndeshjen në "Bernabeu", 41 për qind e francezëve shohin fitore të Real Madridit, 36 për qind parashikojnë një barazim dhe vetëm 19 për qind vënë bast për triumfin e PSZH-së. Ndër tifozët e futbollit, rezultati i anketës është i ngjashëm: 43 për qind janë për Real Madrid, 31 për qind për barazimin dhe 26 për qind për PSZH-në.



BUFON NUK NDALET

Më 23 mars në Mançester, në miqësoren mes Italisë dhe Argjentinës, në portën e të kaltërve do të jetë sërisht Buffon. Të paktën kjo është ideja e trajnerin të perkohshëm Gigji Di Biagio, i cili ka ndërmend ta grumbullojë 40-vjeçarin për testet që do të zhvillohen në Angli. Vetëm katër ditë pas përplasjes me Messin, italianët do të luajnë kundër përfaqësueses së "Tre Luanëve". Historia e dashurisë mes portierit tashmë legjendar dhe Kombëtares së Italisë duket se nuk mund të mbyllet me

lotët e asaj mbrëmjeje të hidhur, kur u shua shpresa për të marrë pjesë në "Rusi 2018". Buffon është rekordmen sa i përket numrit të pjesëmarrjeve me të kaltrit (174 ndeshje), por i duhet edhe një takim me shiritin e verdhë në krah, për të thyer edhe rekordin e ndeshjeve si kapiten (80). Do të ishte një tjetër arritje e madhe gjatë një karriere të lavdishme. Të paktën në ndeshjet para Botërorit, Buffon, për kënaqësinë e të gjithë tifozëve të Kombëtares Italiane, do të shfaqet sërisht mes shtyllave.



DASHI 21. mars - 20. prill

Do të jetë një ditë plot emocione dhe me shpirtin tuaj binjak do të përjetoni momente të bukura. Parashikimet për një Shën Valentin romantik janë të shkëlqyera! Beqarët do të takojnë njerëz të ndryshëm nga zakonisht, por do të duhet të ndryshojnë sjelljen për të bërë arritje të reja! Mbani impulsivitet brenda vetes dhe nxirri cilësitë tuaja në vend që të grindeni më kot në punë.



DEMI 21. prill - 21. maj

Është një moment i valërave të mëdha për ata që presin një konfirmim nga partneri/ja. Një po ose një jo do të ndryshojë perspektivat tuaja, por shpresa nuk do të zhgënjehet! Beqarët do të jetojnë një ditë të qetë, edhe nëse disa takime mund t'i shqetësojnë ata. Qëllimet tuaja janë të arritshme. Sot do të jeni të drejtëpërdrejtë me kolegët dhe bashkëpunëtorët dhe do t'i ekspozoni në mënyrë të qartë projektet tuaja.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Bricjapi në Venus mund të pengojë të kuptuarit me të dashurin/en tuaj. Ju do të gjeni veten duke diskutuar çështje të ndjeshme që do të shkaktojnë ndryshime të bezdisshme që do të dalin. Yjet favorizojnë takime dhe njohje të reja edhe për ata që janë vetëm. Nëse jeni duke pritur për një përgjigje në punë, do të merrni kënaqësi të bukura. Nëse punoni vetë do të vini re ndryshime pozitive.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Sot ju jeni të butë dhe romantik dhe gjithashtu kërkoni përgjigje nga partneri/ja që duket disi i hutuar. Ëmbëlsia juaj do të kompensojë mangësitë e tij/saj! Dita e Shën Valentinit do të jetë plot me surpriza edhe për zemrat e vetmuara që janë duke u përgatitur për të festuar ... pa një shpirt binjak! Jupiteri shpall oferta shumë të volitshme në horizont.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

ostalgjia e një dashurie intensive plot me gjëra të bukura ngroh zemrat tuaja në çift. Është shumë keq që për ju ndoshta në këtë moment ka shumë pak kohë për këtë ... duhet të kënaqeni me veten. Nga ana tjetër, beqarët do të jenë në gjendje të marrin propozimin e një personi i cili do të gjejë guximin të deklarojë dashurinë në Ditën e Shën Valentinit!



VIJRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Nëse jeni në çift dhe keni në mendje ta mbyllni lidhjen me partnerin/en me një ndërprerje të vogël për disa kohë, përshpejtoni përgatitjet. Dashuria është tashmë në plan të parë dhe për ata që janë vetëm, të cilët do të jetojnë një ditë duke alternuar midis gëzimit dhe melankolisë. Ju jeni të vendosur të vazhdoni rrugën tuaj dhe këmbëngulja në punë ju lejon të mbledhni sukses pas suksesit.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Është një ditë e bukur, plot gëzim dhe surpriza. Ju do të keni qëllim të ngacmoni partnerin/en, por jini të kujdesshëm që të mos lëshoni xhelozinë ndaj tij/saj. Beqarët mund të llogarisin një ditë shumë interesante për ndjenjat, një Venus në një pozitë të favorshme do të shpërndajë takime magjike! Yjet këshillojnë të veprojnë menjëherë dhe të jenë të sigurt për vendimet e tyre në punë.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Një ditë e madhe për të marrë një pauzë për reflektim. Ngjarjet po ndjekin njëra-tjetrën dhe ju po përballeni me një vendim të rëndësishëm. Qartësoni gjithçka me të dashurin/en tuaj. Disa beqarë do të jenë në gjendje të rishikojnë një të njohur të vjetër dhe të bien në dashuri! Merkuri vazhdon të shkaktojë pengesa dhe tensione në bashkëpunimet në punë.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do të jeni të pandalshëm dhe partneri/ja do të luftojë për të vazhduar me ju. Disa ide për këtë ditë të madhe po vinë, por duhet të jeni të sigurt për dashurinë tuaj për partnerin/en. Ata që janë vetëm do të animohen nga një vitalitet i pabesueshëm dhe do të thejnë zemrën e një personi të veçantë. Duhet të bëni një analizë të situatës, së paku në lidhje me çështjet ekonomike.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Sot do të ndani momente të harmonisë së madhe me të dashurin/en tuaj. Yjet rezervojnë erosit dhe pasionin në një nivel të lartë dhe mbi të gjitha, një fantazi të shfrenuar! Beqarët mund të llogarisin ftesa për njohje të reja të cilat premtojnë arritje. Në aspektin profesional, keni nevojë për një angazhim më të madh për të shuar të ardhurat dhe projektet e mira.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Kontrastet dhe diskutimet me të dashurin/en tuaj mund të shkaktohen nga stresi. Mundohuni të zgjidhni problemet së bashku nëse doni që marrëdhënia të ecë siç duhet. Beqarët do të jenë shumë të gatshëm për të takuar njerëz të rinj. Planetët ju shtojnë të kultivoni projekte dhe investime të reja. Pyesni ekspertë përpara se të veproni.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Një ditë lumturie për të gjithë ata që janë në çift. Ata që janë në një lidhje të konsoliduar do shfaqin dëshirën për të filluar jetesën së bashku dhe kjo mund ta forcojë edhe më shumë marrëdhënien. Beqarët do të duhet të luftojnë për të shmangur atraksionet transgresive. Në punë do të keni bashkëpunim dhe dialog të mirë me kolegët.



Mensur Mamuti	MBRETI NË EGJIPTIN E LASHTË	F	SHENJËTARI	N
PARASHIKIMI I FATIT	DËSHMORI QË RA BASHKË ME HEROIN NË FOTO		FHATI I LINDJES SË DËSHMORIT NË FOTO (PODUJËVË)	
L				
QYTET NË HOLANDË				
KOMIKU ANGLEZ, ATKINSON				
INDIUMI			XH INCIZIM ME SKANER	
GRUP NJERËZISH ME GJUHË DHE ZAKONË TË PËRBASHKËTA				
AUSTRIA			KUMANOVA CEREMONI, RITUAL	

KOHA	MËNYRAT, METODAT PËR NËJE BETEJË	KËNG/TARJA IZRELITE, HAZA	KTHESË QYTETI KU RA DËSHMOR PERSONI NË FOTO	K	KËNGËTARJA JONË JAKUPI PËREMËR PRONOR	LOKAL NATE ME VALLËZIM (SH.)
TOPI I VOGËL					LIDHJE LUKUNI, ZOGORI	
DËSHMORI KOSOVAR NË FOTO						
VRASJE, VJEDHJE				ONOMATOPE E GUGATJES E ZOGJËVE EMËR I SHUMË HOTELEVE	MEGABAJT HIDROKARBUR INGOPUR	
TANI				GALIUMI NJËSI PËR REZISTENCË ELEKTRIKE	ENERGJIA IDHULL	AUSTRIA ISH FUTBOLLIST I UELLISIT, MAJKELL
IMPULSI		PUNËTOR QË PUNON NË TORNO "MBRETI" I SHEKSPIRIT				
GJENDJA E MOTIT					THIRRJE NË ISLAM (ARAB.) ZANORE FOINJE	
VRASËSI I KAINIT				ELEMENT KIMIK, NE (SH.) AZOTI		
BIMË BARISHTORE NË VËNJËÇARË						

ZGJIDHJET: FN, FALLI, LARUSH, HAGA, ROAN, IN, XH, FISI, A, KU, K, AZRA, TOPTHI, LINK, AFRIM, ZHITIA, KRIM, GU, MB, TASH, GA, E, A, I, TORNITOR, KLIMA, DAVE, AIN, NEONET, TRËNDËLINË.

Sudoku

shumë i lehtë

4		8		6			7	
	7	3			1			4
					2			
1	8	6						
			3				9	
8		1				3		
			7		5	6		
		5		2				

mesatar

	8	6				3	1	9	
	9					2		8	
1									3
6	5		3		4				
			7		8		5	1	
9									7
	4	8						2	
	1	8	9				3	4	

Shumë i lehtë: 458269173, 973851264, 612437985, 539672418, 186594732, 247318596, 821946357, 394785621, 765123849. Mesatar: 586473192, 397612584, 124589763, 651394278, 872156439, 439728651, 963245817, 745831926, 218967345.



Fëmijët me çrregullim të koncentrit dhe hiperaktivitetit (attention deficit hyperactivity disorder - ADHD) informatat vizuale i përpunojnë ndryshe në krahasim me fëmijët pa çrregullime, tregojnë hulumtimi i ri i shkencëtarëve amerikanë. Duke gjetur modele të ndryshme të aktivitetit në trurin e fëmijëve me ADHD, hulumtuesit shpresojnë që një ditë do të mund të bëjnë testin i cili do ta zbulojë çrregullimin

shumë herët. Si i kanë zbuluar shkencëtarët aktivitetet e ndryshme të trurit të fëmijëve me sindromën ADHD? Fëmijëve të moshës prej 9 deri 15 vjeçare me dhe pa këtë sindromë, hulumtuesit u kanë dhënë një varg testesh në të cilat nga ata kërkohet që të mbajnë mend dhe njohin grupet e caktuara të numrave. Aktiviteti i tyre trunor është skanuar në atë moment, ndërsa incizimet kanë treguar që fëmijët hiperaktiv i përpun

Fëmijët hiperaktivë mendojnë ndryshe

nojnë informatat vizuale në tjetër mënyrë. Mostra e aktivitetit të tyre trunor është më e ndryshme se tek fëmijët që nuk kanë këtë çrregullim. Konkretisht, skaneri ka shënuar aktivitet të reduktuar të neuroneve në fushat e trurit përgjegjëse për perceptim vizual dhe memorien punuese. Shkencëtarët shpresojnë që ky hulumtim do të ndihmojë në zbulimin e hershëm të sindromës ADHD.



Kërpudha që shkakton orgazëm!

Vetitë kuruese të bimëve të caktuara janë të njohura, dhe janë studiuar prej mijëra vitesh, por në këtë fushë duket se ka ende për të zbuluar. Ka qenë kërpudha Dictyophora, ajo që ka tërhequr vëmendjen e shkencëtarëve, sepse sipas këtyre të fundit, nuhatja e kësaj kërpudhe mund të bëjë gratë të kalojnë në orgazëm. Kjo bimë magjike është rreth 1000 vjet e vjetër, rritet në Hawaii dhe është gjetur nga ekipi mjekësor John C Holliday dhe Noah Soule. Përfundimet e tyre ata i botuan në Journal of Medicinal Mushrooms dhe pohojnë se kjo kërpudhë kishte veti afrodisiake. Sipas shkencëtarëve, më shumë se gjysma e femrave që morën pjesë në studim, përjetuan një orgazëm spontane, ndërkohë që nuhasnin këtë kërpudhë. Hipoteza e parashtruar mbështet idenë se enzimat e gjendura tek sporet e kërpudhave, mund të jenë të ngjashme me neurotransmetuesit të njerëzimit që aktivizohen gjatë raportit seksual.

KUJDES! Telefoni në makinë nuk lejohet edhe nëse ndalon në anë të rrugës



Franca është përballur me një numër të lartë vdekjesh në rrugë kohët e fundit, e në përpjekje për të ulur numrin e viktimave, autoritetet u janë vënë pas drejtuesve të mjeteve. Kështu, tashmë jo vetëm që është e jashtëligjshme që të përdorësh telefonin në timon, por edhe nëse e ndalon makinë në anë të rrugës, duke e bllokuar ose jo trafikun. Sipas të përditshmes franceze "Le Figaro", Gjykata e Lartë Franceze vendosi që kushdo që hap krahun për të përdorur telefonin do të përballë me heqje

pikësh nga patentat dhe një gjobë prej 135 euro. Kushdo që dëshiron të përdorë telefonin do të duhet që të parkojë në një vend të posaçëm. Megjithatë nëse personi pëson një aksident apo gjendet në situatë emergjence mund ta përdorë aparatit e tij celular. Franca, një vend me reputacion për dhënien e makinës "si të çmendur" ka prezantuar një sërë ligjesh të reja në përpjekje për të ulur numrin e aksidenteve që kanë parë një rritje të madhe përgjatë 10 vjeçarit të fundit.

Kafja përmirëson mëlçinë e dëmtuar nga alkooli



Një lajm shumë i mirë për njerëzit që duan të konsumojnë kafe. Të gjithë i dimë efektet negative të alkoolit në trup dhe ende shumë prej nesh abuzojmë më shumë se ç'duhet. Kjo është pikërisht arsyeja se pse shumë njerëz preken nga sëmundjet e mëlçisë. Megjithatë, një studim i kryer në Britani të Madhe ka gjetur se dëmtimet e mëlçisë të shkaktuara nga alkooli mund të përmbysen duke pirë dy gota kafe çdo ditë. Studimi që ka analizuar më shumë se 430,000 pjesëmarrës, ka zbuluar se konsumimi i dy kafeve në ditë mund të zvogëlojë cirozën e mëlçisë. Pacientët me cirozë e kanë jetën e tyre në rrezik, sepse është potencialisht fatale. Për më tepër, sëmundja e mëlçisë akoma nuk ka shërim. Por sipas Dr. Oliver Kennedy, profesor në Universitetin e Southampton i cili është gjithashtu autori kryesor i studimit, konsumimi i kafesë ka një rol të rëndësishëm në uljen e rrezikut të zhvillimit të cirozës.

1540 - Perandori Çarls V futet në Gent pa rezistencë ku pastaj ekzekuton rebelët.

1670 - Perandori katolik Leopold I dëbon hebrejtë nga Vjena.

1859 - Oregoni shpallet shteti i 33 i SHBA.

1896 - Theodor Herzl publikon veprën e tij të njohur "Der Judenstaat".

1919 - Fillon lufta sovjetiko-polake.

1945 - Peru, Paraguai, Çile dhe Ekuadori i bashkohen OKB.

1950 - BRSS dhe Kina nënshkruajnë Traktat të Paqes.

1971 - Richard Nixon instalon sistemin të fshehtë të incizimit në Shtëpinë e Bardhë.

1989 - Homeini urdhëron myslimanët për të vranë shkrimtarin e veprës "Vargjet Satanike" Salman Ruzhdi.

Astronauti Gordon Cooper, kur kapsula e tij humbi energjinë elektrike, përdori vetëm një orë dore, njohuri të modeleve të yjeve dhe vlerësime matematikore për të gjetur këndin e duhur për rikthim.



Jeff Bezos, Bill Gates dhe Warren Buffett, tre prej më të pasurve në Amerikë kanë një pasuri të barabartë me atë të 50 për qind të pjesës më të varfër të popullsisë në Amerikë, me rreth 160 milionë njerëz. Vetëm pasuria e Warren Buffett është vlerësuar me 93 miliardë dollarë.



Sipas një mesatareje, muskujt e fokusimit të syrit lëvizin rreth 100.000 herë në ditë. E thënë ndryshe, kjo do të ishte e njëjtë sa të ecnit 50 milje çdo ditë për muskujt e këmbë tuaj.



GRUAJA E MARTUAR

- Burri im i dashur, më duket që më ke dashur më shumë kur kemi kaluar bashkë, para se të martoheshim, - i ankohet gruaja burrit të saj.
- Burri i përgjigjet: E dashur, ti e di mirë që unë nuk i dua gratë e martuara.



Lavdia jonë më e madhe qëndron jo në faktin që nuk dështojmë asnjëherë, por në faktin që ringrihem çdo herë që dështojmë!

(Konfuci)